# Aktivitetet e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë

# Activities of Interreligious Council of Albania

KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË

KNFSH

TIRANA

SHQIPËRI • ALBANIA

# Aktivitetet e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë

# Activities of Interreligious Council of Albania

Botim i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë

A publication of the Interreligious Council of Albania

**EDITOR:**

Dr. Genti Kruja

**DESIGN:**

Bledar Xama

**ISBN:**

978-9928-4638-1-4

Tiranë 2020

# PËRMBAJTJA

NË 30 VJETORIN E LIRISË SË BESIMIT . . . . 5
RRETH KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË . . . . 11
ORGANET DREJTUESE, FUNKSIONIMI DHE KOMPETENCAT E TYRE . . . . 17
Bordi i Presidencës . . . . 19
Sekretari i Përgjithshëm . . . . 30
Bordi Ekzekutiv . . . . 32
Departamenti i Gruas . . . . 34
Departamenti i Rinisë . . . . 35
AKTIVITETE . . . . 37
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë vlerësohet me çmimin "De Mellon për të Drejtat e Njeriut" . . . . 38
Përfaqësues të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë takim me Papa Françeskun . . . . 40
Mbledhjet e Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë . . . . 41
Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv të KNFSH-së . . . . 47
Mblidhet Bordi Ekzekutiv i KNFSH-së . . . . 49
Zhvillohen konsultimet kombëtare të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë të KNFSH-së . . . . 51
Zhvillohen Konsultimet Kombëtare të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë . . . . 52
Rekomandimet e Konsultimeve Kombëtare . . . . 54
Zhvillohen Konsultimet e II Kombëtare të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në KNFSH . . . . 56
Presidenti Meta takim me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë: Situata pas tërmetit…. . . . . 57
KNFSH zhvillon një aktivitet social dhe kulturor me fëmijët jetimë të zonës së tërmetit . . . . 58
Myslimanë e të krishterë lutje, agjërim dhe bamirësi drejtuar Zotit . . . . 59
Nënshkruhet memorandum mirëkuptimi mes Këshillit Ndërfetar dhe CVE-së . . . . 60
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë takim me Kryeministrin lidhur me rihapjen e objekteve të kultit . . . . 63
Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë zhvillojnë Konsultimet e III Kombëtare . . . . 66
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë në ndihmë të qindra familjeve në nevojë . . . . 68
KNFSH pjesë aktive e panelit ndërkombëtar të "Religions for Peace" . . . . 70
Roli i Tolerancës Fetare në parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm . . . . 71

# TABLE OF CONTENTS

ON THE 30TH ANNIVERSARY OF RELIGION FREEDOM . . . . 5
ABOUT THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA (IRCA) . . . . 11
GOVERNING BODIES, THEIR FUNCTIONING AND COMPETENCIES . . . . 17
Council of Presidency . . . . 19
Secretary General . . . . 30
Executive Board . . . . 32
Department of Women . . . . 34
Department of Youth . . . . 35
ACTIVITIES . . . . 37
Interreligious Council of Albania awarded Sergio Vieira De Mello Prize . . . . 39
Representatives of the Interreligious Council of Albania meet with Pope Francis . . . . 40
Meetings of the Presidency of the Interreligious Council of Albania . . . . 41
Meetings of the Executive Board of IRCA . . . . 47
Meeting of IRCA Executive Board . . . . 49
National consultations of the IRCA Department of Women and Department of Youth . . . . 51
National Consultations of the Interreligious Council of Albania . . . . 52
Recommendations of National Consultations . . . . 54
National Consultations of the Department of Women and the Department of Youth of IRCA . . . . 56
President Meta meets with the Interreligious Council of Albania: the Earthquake aftermath… . . . . 57
IRCA organizes a social and cultural activity with orphaned children in earthquake hit areas . . . . 58
Muslims and Christians pray, fast and do charity together . . . . 59
Memorandum of Understanding between the Inter-religious Council and the CVE is signed. . . . . 60
Interreligious Council of Albania meeting with the Prime Minister regarding the reopening of cult objects . . . . 63
The Department of Women and the Department of Youth conduct third National Consultations . . . . 66
Interreligious Council of Albania in help of hundreds of families in need. . . . . 68
IRCA active part of the international panel of "Religions for Peace" . . . . 70
The Role of Religious Tolerance in Preventing Violent Extremism . . . . 71

Departamenti i Gruas në KNFSH takim me Ambasadoren e Suedisë në Tiranë . . . . . . . . . . . . 73
KNFSH realizon dokumentarin "30 vjet liri besimi" . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 75
Zhvillohet tryeza e rrumbullakët "Sfida e trafikimit në Shqipëri
dhe angazhimi i besimeve fetare kundër trafikimit" . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 76

KONFERENCA DHE TAKIME NDËRKOMBËTARE . . . . . . . . . . . . . . . . 77

Zhvillohet aktiviteti dhe konferenca "Feja në shoqëri: Modeli Shqiptar" . . . . . . . . . . . . . . . . . 79
Mbahet në Berlin takimi ndërkombëtar i Këshillave Ndërfetarë të Europës . . . . . . . . . . . . . . 81
Zhvillohet në Bruksel mbledhja vjetore e Këshillave Ndërfetarë të Europës . . . . . . . . . . . . . . 83
KNFSH takim në Varshavë, Poloni . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 84
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë pjesëmarrës në takimin e Brukselit . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 85
Gjermani, KNFSH merr pjesë në Asamblenë e X Botërore "Fetë për Paqen" . . . . . . . . . . . . . . 86
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë pjesëmarrës në Takimin Ndërkombëtar në SHBA. . . . . . . . . . . . 88
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë takim me Departamentin e Shtetit
dhe Aleancën Ndërkombëtare për Lirinë e Besimit. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 89
Departamenti i Gruas në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë takim online
me forumet ndërkombëtare të gruas në botë. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 90

DEKLARATA TË KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË . . . . . . . . . . 91

Tiranë, më 14 nëntor 2013 Deklaratë për shtyp lidhur me armët kimike . . . . . . . . . . . . . . . . . 92
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dënon me forcë krimet e ISIS. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 93
Deklaratë e përbashkët për veprime të koordinuara në luftën kundër dhunës
ndaj gruas dhe dhunës në familje . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 95
Komunitetet fetare, thirrje për qetësi: Dialogoni, jo dhunë . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 98
Krerët e bashkësive fetare apel Gjermanisë dhe Francës për hapjen e negociatave . . . . . . . . . .100
Deklaratë e komuniteteve fetare në Shqipëri
Angazhimi i përbashkët për dialogun ndërfetar. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .102
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë: . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .104
Dënojmë ashpër çdo formë terrori që godet humanizmin. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .104
Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë: Dhimbje dhe lutje për Sri Lankën . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .105
Deklaratë për shtyp lidhur me situatën politike. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .106

INTERVISTA. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .107

Intervistë në gazetën MAPO . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .109
Intervistë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë
Dr. Genti Kruja në Gazetën "SI". . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .114

Department of Women in IRC Albania meeting with the Ambassador of Sweden in Tirana . . . . . 73
IRCA realizes the documentary "30 years of religion freedom" . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 75
Round table "The challenge of trafficking in Albania
and the commitment of religious beliefs". . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 76

CONFERENCES AND INTERNATIONAL MEETINGS . . . . . . . . . . . . . . 77

Conference and activity "Religion in society: the Albanian Model" . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 79
International Meeting of Interreligious Councils of Europe held in Berlin . . . . . . . . . . . . . . . 81
Annual meeting of Interreligious Councils of Europe held in Brussels . . . . . . . . . . . . . . . . . 83
IRCA - meeting in Warsaw, Poland . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 84
Interreligious Council of Albania attends Brussels meeting . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 85
Germany, IRCA participates in the 10th World Assembly of "Religions for Peace" . . . . . . . . . . 86
Interreligious Council of Albania attends an International Meeting in the USA . . . . . . . . . . . . 88
Interreligious Council of Albania, meeting with the Department of State
and International Alliance for Freedom of Belief . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 89
Department of Women of the Interreligious Council of Albania meets online
with international women's forums . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 90

STATEMENTS OF THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA . . . . . . . 91

Tirana, November 14, 2013 Press statement on chemical weapons . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 92
Interreligious Council of Albania strongly condemns ISIS crimes . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 93
Joint statement on coordinated action in the fight against violence
against women and domestic violence . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 95
Religious communities call for calm: Dialogue, not violence . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 98
Leaders of religious communities appeal to Germany and France to open negotiations . . . . . . .100
Statement of religious communities in Albania
Joint commitment to interfaith dialogue . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .102
Interreligious Council of Albania: . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .104
We strongly condemn any form of terrorism against humanity . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .104
Interreligious Council of Albania: Sorrow and prayer for Sri Lanka . . . . . . . . . . . . . . . . . .105
Press statement on the current political situation . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .106

INTERVIEWS . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .107

Interview in MAPO newspaper. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .109
Interview of the Secretary General of the Interreligious Council of Albania,
Dr. Genti Kruja, for the newspaper "SI" . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .114



# Në 30 vjetorin e lirisë së besimit

nga **Dr. Genti Kruja**

***Liria e besimit është e drejtë universale, e cila duhet të mbrohet dhe promovohet nga e gjithë shoqëria dhe faktorët e ndryshëm që kanë ndikim të drejtpërdrejt.***

Shqiptarët prej shekujsh jetojnë në një harmoni dhe bashkëjetesë ndërfetare, e cila përbën tashmë edhe etnotiparin kryesor të kombit tonë. Me themelimin e shtetit shqiptar më 1912, krahas shumë vlerave që i kushtuan rëndësi burrat e shtetit, ku ndër ta ishin dhe klerikë të shquar myslimanë dhe të krishterë, një prej këtyre vlerave ishte edhe***liria***

# On the 30th anniversary of religion freedom

**By Dr. Genti Kruja**

Freedom of belief is a universal right, which must be protected and promoted by the whole society and the various factors that have a direct impact.

Albanians have been living for centuries in an inter-religious harmony and coexistence, which is now the main ethno pattern  of our nation. With the establishment of the Albanian state in 1912, in addition to many values that the personalities of the state paid attention to, including prominent Muslim and Christian clerics, one of these values

***e besimit***, si një nga të drejtat themelore të njeriut në çdo shoqëri demokratike. Ajo ishte pjesë e shoqërisë shqiptare, deri në instalimin e regjimit komunist në vitin 1944.

Me ardhjen në fuqi të komunizmit ky proces mori një kthesë, ashtu siç e kishin paralajmëruar edhe shumë klerikë myslimanë e të krishterë, të cilët ishin në dijeni të luftës së bolshevizmit dhe komunizmit ndaj fesë. Shteti komunist nuk ishte një shtet thjesht laik, por një shtet, që synonte ç'fetarizimin tërësor të shoqërisë dhe shndërrimin e saj në një shoqëri ateiste. Në fazën e parë dhuna e ushtruar ndaj klerit nga regjimi komunist e kufizoi autoritetin e tij në bashkësi dhe shkallë-shkallë e bëri të pamundur ekzistencën e tij. Më vonë, në vitin 1967, fushata për mbylljen e kishave dhe xhamive, e bëri Shqipërinë të vetmin vend në botë pa të drejtat dhe liritë e ushtrimit të besimeve fetare.

## HISTORIA E PËRBASHKËT E PERSEKUTIMIT NË PERIUDHËN TOTALITARE

Predikues të të gjitha besimeve fetare vuajtën fate të përbashkëta: u ndaluan të predikonin në publik, u internuan, ose u burgosën për veprimtari kundër regjimit totalitar, dhjetëra klerikë u ekzekutuan, u vranë, apo vdiqën nëpër burgje. Pasuritë e të gjitha bashkësive fetare u konfiskuan e një pjesë u shkatërruan. Ky proces ka krijuar sensin e një të kaluare të përbashkët, çka mundësoi qëndrime të njëjta ose të ngjashme politike dhe ideologjike në përpjekjet për rigjallërimin e jetës fetare në Shqipëri pas ndryshimeve politike në vend, që filluan më 1990.

Pas ndërhyrjeve të dhunshme të shtetit në organizimin e jetës së komuniteteve fetare, sekuestrimit të pronave, kontrollit mbi buxhetin, ndalimi i literaturës, kufizimi i rreptë dhe kontrolli e mbyllja e shkollave fetare, politika komuniste forcoi një propagandë të ashpër nëpërmjet shtypit, radios, formave të edukimit, kinemasë, pjesëve të leximeve shkollore dhe edukimit me përbuzjen ndaj fesë, si dhe tashmë filloi dhe



was the freedom of religion, as one of the basic human rights in any democratic society. It was part of Albanian society until the installation of the communist regime in 1944.

With the coming in power of communism, this process took a turn, as warned by many Muslim and Christian clergy, who were aware of the struggle of Bolshevism and communism against religion. The communist state was not a merely secular state, but a state that aimed at the complete denationalization of society and its transformation into an atheist society. In the first stage, the violence exercised against the clergy by the communist regime limited its authority in the community and gradually made its existence impossible. Later, in 1967, the campaign to close churches and mosques made Albania the only country in the world without the rights and freedoms to practice its religion.

## THE COMMON HISTORY OF PERSECUTION IN THE TOTALITARIAN PERIOD

Preachers of all faiths suffered common fates: banned from preaching in public, exiled, or imprisoned for activities against the totalitarian regime, dozens of clerics executed, killed, or died in prisons. The assets of all religious communities were confiscated and some destroyed. This process has created a sense of a common past, which enabled the same or similar political and ideological attitudes in the efforts to revive the religious life in Albania after the political changes in the country, which began in 1990.

After violent state interventions in organizing the life of religious communities, seizing property, controlling the budget, banning literature, strictly restricting, controlling and closing religious schools, communist politics intensified a fierce propaganda through the press, radio, forms education, cinema, parts of school readings and education with contempt for religion, as well as the persecution, imprisonment, exile and execution of religious lead-

persekutimi, burgosja, internimi dhe ekzekutimi i prijësve fetarë, gjë e cila kulmoi me ndalimin e fesë me ligj në vitin 1967, ku u mbyllën të gjitha komunitetet fetare, u shkatërruan qindra kisha, xhami dhe teqe, si dhe u hap "Muzeu Ateist", i vetmi në botë.

Ndërkaq nuk duhet të neglizhojmë faktin se ndonëse në propagandën komuniste, veçanërisht pas mbylljes së kishave e xhamive, fetë trajtoheshin të gjitha si të huaja, në popull vazhdonin të qarkullonin besimet fetare.

Për gati 45 vjet regjimi komunist vuri në zbatim me konsekuencë një sistem të sofistikuar e kompleks të indoktrinimit ateist. Diktatura e ateizmit të institucionalizuar mburrej se ishte 'i vetmi vend ateist në botë!' Lufta frontale kundër fesë, asgjësimi i figurave të shquara fetare, persekutimi i vazhdueshëm, ndalimi i riteve fetare, mbyllja e institucioneve fetare, etj., synonte krijimin e një 'feje' të re: 'marksizëm-leninizmin', adhurimin e idhujve të rinj (që nga Marksi deri tek Enver Hoxha) në vend të (respektit ndaj) Jezusit e Muhamedit (a.s.), zëvendësimin e fjalës "Zot" me nocionin abstrakt "Nëna Parti".

Por me gjithë goditjet e rënda që mori feja, ajo nuk u zhduk e nuk u çrrënjos nga presioni që iu bë. Ateizmi i deklaruar mbeti artificial, iluzor, sipërfaqësor dhe vetëm i regjistruar te dosjet shtetërore.

## SHTETI DHE LIRIA E BESIMIT

Sot shteti demokratik bazohet tek arsyeja se liria e personit është themeli i jetës së çdo bashkësie dhe se ruajtja e kësaj lirie duhet të jetë objektivi primar i sistemit demokratik. Laiciteti i shtetit shpreh faktin se në një regjim demokratik ekzistojnë së bashku të gjithë ato komponentë, që nuk cenojnë parimin themelor, lirinë e përbashkët. Bashkëjetesa e besimeve fetare tregon se asnjë prej tyre nuk mbizotëron, por secila përpiqet të marrë pjesë në sintezën e jetës qytetare. Laiciteti i shtetit sot pretendon se është një parim i pluralizmit demokratik, i cili synon të afirmojë se në kufijtë e jetës civile nuk ka asnjë besim, apo ideologji politike, që mund t'i imponohet të tjerëve, si model nëpërmjet forcës, qoftë kjo verbale, fizike, psikologjike ose edhe me presion ekonomik.

Roli i besimit fetar në kuadrin e sistemit demokratik është mjaft pozitiv, sidomos atëherë kur ky raport ushqehet me dialog dhe me bashkëpunim të sinqertë. Duke qenë se liria e besimit pasqyrohet në jetën private dhe publike, shteti, i cili garanton këtë liri me ligj, nuk mund të jetë indiferent ndaj keqpërdorimit të saj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke njohur barazinë e besimeve pohon se tek ne nuk ka asnjë fe zyrtare dhe se shteti është asnjanës dhe garant i lirive fetare. Gjithashtu shteti përjashton çdo diskriminim për arsye bindjesh fetare dhe shprehet:

ers, which culminated in the banning of religion by law in 1967, where they were closed all religious communities, hundreds of churches, mosques and tekkes were destroyed and was opened the Atheist Museum, the only one in the world.

Meanwhile, we should not neglect the fact that although in the communist propaganda, especially after the closure of churches and mosques, religions were all treated as foreign, religious beliefs continued to circulate among the people.

For almost 45 years, the communist regime consistently implemented a sophisticated and complex system of atheist indoctrination. The dictatorship of institutionalized atheism boasted that it was 'the only atheist country in the world', new religion was 'Marxism-Leninism', the worship of new idols (from Marx to Enver Hoxha) instead of (respect for) Jesus and Muhammad, the replacement of the word "God" with the abstract notion "Mother Party".

However, despite the severe blows that religion received, it did not disappear and was not uprooted from the pressure that was put on it. The declared atheism remained artificial, illusory, superficial and only recorded in state files.

## STATE AND RELIGION FREEDOM

Today the democratic state is based on the reason that the freedom of the individual is the foundation of the life of every community and that the preservation of this freedom should be the primary objective of the democratic system. The secularism of the state expresses the fact that in a democratic regime all those components exist together, which do not violate the basic principle, common freedom. The coexistence of religious beliefs shows that none of them prevails, but each tries to participate in the synthesis of civic life. The secularism of the state today claims to be a principle of democratic pluralism, which aims to affirm that at the limits of civil life there is no belief, or political ideology, that can be imposed on others, as a model through force, verbal , physical, psychological or even economic pressure.

The role of religious belief in the framework of the democratic system is quite positive, especially when this relationship is nurtured by dialogue and sincere cooperation. Since freedom of religion is reflected in private and public life, the state, which guarantees this freedom by law, cannot be indifferent to its abuse.

The Constitution of the Republic of Albania, recognizing the equality of religions, states that we have no official religion and that the state is neutral and a guarantor of religious freedoms. The state also excludes any discrimination on the grounds of religious beliefs and states:

"Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve."

Shteti është neutral ndaj besimeve, por jo indiferent, mbasi ai ka për detyrë të mbrojë pluralizmin fetar. Juristët e kanë përkufizuar qëndrimin e drejtë të shtetit si një 'neutralitet aktiv, i cili siguron barazinë kundër çdo tendence për supremaci të ndonjë elementi të shoqërisë.

Sot edhe pse 30 vjet liri besimi, shteti shqiptar nuk i ka kthyer më shumë se 90 % të pronave të komuniteteve fetare, nuk i kompensuar në shumicën e atyre që nuk kthehen dot më fizikisht, edhe pse sot komunitetet fetare luajnë një rol të rëndësishëm në zbutjen e problemeve sociale të shoqërisë shqiptare, duke shërbyer jo vetëm në aspektin shpirtëror, por sidomos në atë edukativ dhe arsimor, me anë të dhjetëra shkollave dhe institucioneve arsimore, duke edukuar mijëra të rinj në këto 30 vite, si qytetarë të denjë të këtij vendi, por edhe si qytetarë të botës, duke u shpërndarë një pjesë prej tyre në vende të ndryshme të botës për arsye studimi, apo punësimi.

Bashkëpunimi i bashkësive fetare dhe ndihmesa e tyre në harmoninë fetare janë të rëndësishme, por kjo nuk do të thotë se harmonia fetare duhet t'u garantohet qytetarëve nga bashkësitë fetare. Është shteti laik garanti kryesor i lirisë së besimit dhe i bashkëjetesës paqësore në një shtet demokratik. Dhe kjo nuk duhet harruar. Shteti na bën të vetëdijshëm, se ne jo vetëm duhettë jemi tolerantë, por edhe se jemi të detyruar të jemi të tillë. Edhe vetë shteti shqiptar u ndërtua në dy themele bazë, pra në mbizotërimin e ndjenjës kombëtare dhe bashkëjetesën e shqiptarëve të besimeve të ndryshme fetare. Nuk ka argument më të thjeshtë për t'u kuptuar për diplomacinë botërore, sesa të kuptojnë realitetin pothuaj unik në botë, të bashkëjetesës së jashtëzakonshme fetare të kombit shqiptar. Harmonia ndërfetare tek shqiptarët është një vlerë me përmasa dhe rëndësi përtej Shqipërisë.

## LIRIA E BESIMIT NË VITET 1990

Në vitin 1990 populli i shumëvuajtur shqiptar ishte i etur për liri besimi dhe ndërgjegjeje. Mijëra besimtarë myslimanë dhe të krishterë të frymëzuar nga dashuria për Zotin dhe malli për t'u lutur e falur të lirë mësynë ato pak objekte kulti të mbetura në këmbë, duke i rënë kambanave, duke realizuar meshën e parë dhe duke falur xhumanë e parë në nëntor 1990. Ky ishte triumfi i besimit ndaj mohimit, ishte triumfi i lirisë ndaj prangave dhe zinxhirëve të një regjimi diktatorial.

"Everyone is free to choose or change their religion or belief, and to manifest it individually or collectively, in public or in private, through worship, education, practice or ritual."

The state is neutral towards religions, but not indifferent, as it has a duty to protect religious pluralism. Lawyers have defined the right attitude of the state as an 'active neutrality', which ensures equality against any tendency to supremacy of any element of society.

Today, although 30 years of freedom of religion, the Albanian state has not returned more than 90% of the property of religious communities, not compensated in most of those who can no longer return physically, although today religious communities play an important role in mitigating the social problems of the Albanian society, serving not only in the spiritual aspect, but especially in the educational one, through dozens of schools and educational institutions, educating thousands of young people in these 30 years, as worthy citizens of this country, but also as citizens of the world, distributing a part of them in different countries of the world for reasons of study or employment.

The cooperation of religious communities and their contribution to religious harmony is important, but this does not mean that religious harmony should be guaranteed to citizens by religious communities. The secular state is the main guarantor of freedom of religion and peaceful coexistence in a democratic state. In addition, this should not be forgotten. The state makes us aware that we not only have to be tolerant, but also that we are obliged to be so. The Albanian state itself was built on two foundations, namely the predominance of national feeling and the coexistence of Albanians of different religious faiths. There is no simpler argument to understand for world diplomacy, than to understand the almost unique reality in the world, of the extraordinary religious coexistence of the Albanian nation. Interreligious harmony among Albanians is a value with dimensions and importance beyond Albania.

## RELIGION FREEDOM IN THE 1990S

In 1990, the long-suffering Albanian people were eager for religion freedom and conscience. Thousands of Muslim and Christian believers inspired by the love of God and the longing to pray freely rushed to the few standing cult objects, rang the bells, performed the first Christian Mass and prayed the first Jumah (Islamic pray ceremony on Friday) in November 1990. This was the triumph of belief in denial; it was the triumph of freedom over the shackles and chains of a dictatorial regime.

Albanians have already killed fear and preceded democratic movements by freeing freedom of religion from slavery.

Tashmë shqiptarët vranë frikën dhe i paraprinë lëvizjeve demokratike duke çliruar lirinë e besimit nga robëria.

Pamjet madhështore të shërbesave të para fetare pas disa dekadash janë dëshmi e një historie të jashtëzakonshme, e cila këtë vit ka dhe jubileun e saj, 30 vjetorin e lirisë së besimit.

Shkodra, qyteti i vlerave të shumta dhe më i persekutuari i regjimit komunist, do t'i printe këtij veprimi të guximshëm për kohën dhe do të sfidonte diktaturën, duke rihapur pas 23 vjetësh objektet e kultit dhe duke zhvilluar dhe ritualet përkatëse, në një kohë që shumë njerëz akoma kishin frikë nga hija e zymtë e busteve të diktatorit.

Përveç rëndësisë së kësaj ngjarjeje, ajo që përbën një vlerë unikale, shembull të bashkëjetesës fetare në qytetin e lashtë, është fakti se në rihapjen e këtyre objekteve, përkatësisht me 11 dhe 16 nëntor 1990, morën pjesë besimtarë të të gjithë feve, që punuan së bashku për të rivënë në funksionim objektet fetare të mbetura nga shkatërrimi ateist i 23 viteve.

Ashtu si në meshën e parë të mbajtur në varrezat e Rrmajit, më 11 nëntor 1990, dhe në ceremoninë fetare të organizuar në Xhaminë e Plumbit më 16 nëntor, merrnin pjesë besimtarë të të gjitha besimeve. Ato ishin shenjat e para se Shqipëria po hapej dhe se komunizmi po rrënohej, ndërsa fjalia e parë e Hafiz Sabriut gjatë ligjëratës para xhamisë i hipur në një tribunë të improvizuar ishte: ***"Të dashur vllazën myslimanë, katolikë e ortodoksë, e mbi të gjitha vllazën shqiptarë".***

Për organizmin e meshës së 11 nëntorit në dosjen 1241, dt. 12.11.1990 shkruhej ndër të tjera:

"Në këtë ceremoni kishte pjesëmarrje të madhe njerëzish nga fshati, qyteti, që shifra e tyre mund të jetë 3-6 mijë vetë të moshave parashkollore, të rinj, e deri te moshat e thyera... Gjithashtu në këtë pjesëmarrje kishte edhe shumë persona të fesë myslimane."

E njëjta gjë ndodhi edhe në përgatitjen e ceremonisë së 16 nëntorit për faljen e xhumasë së parë, ku djem të rinj katolikë ndihmuan bashkëqytetarët e tyre myslimanë në një solidaritet të jashtëzakonshëm.

Në librin e kujtimeve të Dom Simon Jubanit, njëri nga të intervistuarit, Kolë Çekini, kujton e thotë lidhur me meshën:

"Një grup i madh myslimanësh asht vendosë mburojë tek dera e vorreve. Njeni më tregon se, na do të qëndrojmë këtu mbasi po kje se ndodhë gja, na do të përdorim armët që kemi në trup... Ju, rrini të qetë ashtu si jeni me fëmijë e familjet tueja!..Sot jemi ne këtu!"

Ja si e përshkruan vetë Dom Simoni organizimin që bëhej në ato ditë:

The magnificent views of the first religious services after several decades are evidence of an extraordinary history, which this year also has its jubilee, the 30th anniversary of freedom of religion.

Shkoder, the city of many values and the most persecuted by the communist regime, would lead this courageous action of the time and would challenge the dictatorship, reopening after 23 years the cult objects and developing the respective rituals, at a time that many people still feared the gloomy shadow of the dictator's busts.

In addition to the importance of this event, what constitutes a unique value, an example of religious coexistence in the ancient city, is the fact that in the reopening of these facilities, respectively on 11 and 16 November 1990, participated believers of all religions, who worked together to put back into operation the religious buildings left over from the atheist destruction of 23 years.

As in the first mass held in the Rrmaj cemetery, on November 11, 1990 and in the religious ceremony organized in the Lead Mosque on November 16, believers of all faiths participated. Those were the first signs that Albania was opening up and that communism was collapsing, while Hafiz Sabri Koçi's first speech during the lecture in front of the mosque riding on an improvised tribune was "Dear Muslim brother, Catholic and Orthodox, and above all brother Albanians".

For the organization of the mass of November 11 in file 1241, date November 12, 1990 was written among others:

"In this ceremony there was a large participation of people from the village, the city, whose number may be 3-6 thousand people of preschool age, young, and up to old ages... Also in this participation there were many people of Muslim religion."

The same thing happened in the preparation of the November 16 ceremony for the first Friday prayer, where young Catholic boys helped their Muslim fellow citizens in extraordinary solidarity.

In the diary of Dom Simon Jubani, one of the interviewees, Kole Çekini, remembers and says about the mass:

"A large group of Muslims has placed a shield at the door of the graves. Someone tells me that, we will stay here after what happens here, we will use the weapons we have in our body... You, stay calm as you are with your children and your families!.. Today we are here! "

Here is how Dom Simon Jubani himself describes the organization that took place in those days:

“Edhe ma interesant se puna e jeme ishte kantjeri i ndërtimit i të rijve, ku ishin angazhue katolikë, musliman, ortodoks, karpentjerë, bojaxhi, elektreçista, që gjatë asaj jave të paharrueme nuk shkonin as në shtëpiat e veta, po hanin, pinin dhe flenin në kantier për të përshpejtue restaurimin e Kapeles së djegun gjatë epokës komuniste, edhe pse gjoja e ruejtun me ligj.” (Mesha e Parë, fq. 49)

Me 16 nëntor Dom Simoni do t’i bënte dhe një vizitë urimi Hafiz Sabri Koçit në shtëpinë e tij për këtë gëzim të madh të kryerjes së riteve të para pas 23 vitesh ndalimi të plotë.

Me rënien e komunizmit, do të dukeshin edhe pasojat e vërteta të këtij ndryshimi fatal në jetën e bashkësive fetare. Liria e besimit i gjeti besimet në një gjendje tragjike. Besimet fetare filluan të riorganizohen mbi bazat tradicionale, duke pasur si bërthamë ato pak objekte kulti, që i kishin rezistuar shkatërrimit komunist dhe ata pak klerikë, që i kishin rezistuar terrorit komunist. Praktikisht në përpjekjet e para të gjitha besimet u përpoqën të lidhnin fillin e traditës fetare të ndërprerë. Por shumë shpejt grupet e vogla të klerikëve të mbetur u gjendën në rrethana krejt të ndryshme nga ato të 46 viteve më parë. Për më tepër, nevojat për ringritjen e strukturave të jetës shpirtërore sollën një dinamikë të re në jetën e bashkësive, çka i bëri elitat e vjetra klerikale të ndjeheshin të pafuqishme për përcaktimin e rrjedhave dhe zhvillimeve brenda bashkësive të tyre fetare. Në ndihmë të tyre do të vinin shumë fondacione të huaja, të cilët ndihmuan në rithemelimin e institucioneve fetare, rindërtimin e objekteve të kultit, si dhe një numri të konsiderueshëm institucionesh arsimore, qendrave sociale, shëndetësore, azile, jetimore, etj.

Klerikët myslimanë e të krishterë, u bënë fli të besimit të tyre, besnikë deri në fund ndaj Zotit dhe besimtarëve. Ata ishin gjithashtu të brumosur me dashurinë ndaj besimit e atdheut dhe nuk pranuan asnjë kompromis me regjimin, duke i qëndruar besnikë fesë dhe kombit, për të cilët shpirti i tyre mbeti gjithmonë i lirë.

“Even more interesting than our job was the construction site of the young people, where Catholics, Muslims, Orthodox, carpenters, painters, electricians were engaged, who during that unforgettable week did not even go to their homes, eating, drinking and they slept on the construction site to expedite the restoration of the Chapel burned during the communist era, even though they were supposedly preserved by law. ” (First Mass, p. 49)

On November 16, Dom Simoni would pay a congratulatory visit to Hafiz Sabri Koçi at his home for this great joy of performing the first rites after 23 years of complete ban.

With the fall of communism, the real consequences of this fatal change in the lives of religious communities would be seen. Freedom of religion found beliefs in a tragic state. Religious beliefs began to be reorganized on a traditional basis, with at its core the few cult objects that had resisted communist destruction and the few clerics who had resisted communist terror. Practically in the first attempts all faiths tried to tie the thread of the discontinued religious tradition. However, very soon the small groups of the remaining clergy found themselves in circumstances quite different from those of 46 years ago. Moreover, the need to rebuild the structures of spiritual life brought a new dynamic to the life of the communities, which made the old clerical elites feel powerless to determine the flows and developments within their religious communities. Many foreign foundations will come to their aid, which helped in the re-establishment of religious institutions, the reconstruction of places of worship, as well as a considerable number of educational institutions, social centers, health, asylum, orphanages, etc.

Muslim and Christian clerics became victims of their faith, loyal to the end to God and believers. They were also molded with love of faith and homeland and did not accept any compromise with the regime, remaining loyal to the religion and the nation, for whom their soul always remained free.




## RRETH KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË

Këshillit Ndërfetar i Shqipërisë është themeluar më 22 tetor 2007 nga katër krerët e komuniteteve tradicionale fetare në Shqipëri, H. Selim Muça (kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë), Fortlumturia e tij Anastas Janullatos (Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë), Mons. Rrok Mirdita (kreu i Kishës Katolike të Shqipërisë) dhe H. Dede Reshat Bardhi (Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve). Në mbledhjen e Bordit të Presidencës me dt. 22.10.2018 është miratuar dhe anëtarësia me të drejta të plota edhe e Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, duke u bërë komuniteti i pestë fetar në KNFSH.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është regjistruar në Gjykatën e rrethit Tiranë, si një qendër jofitimprurëse, joqeveritare, jopolitike, e pavarur, pa anëtarësi dhe që e ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore.

Ceremonia e themelimit të KNFSH-së u zhvillua në prani të Presidentit të atëhershëm të Republikës Prof. Dr. Bamir Topi, i cili tha se, "Ai (KNFSH) institucionalizon tolerancën fetare në Shqipëri. Kjo është vlera jonë e përbashkët dhe ky është virtyti ynë i rrallë, të

## ABOUT THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA (IRCA)

The Interreligious Council of Albania was established on October 22, 2007 by the four leaders of the traditional religious communities in Albania, Haji Selim Muça (head of the Muslim community of Albania), His Beatitude Anastasios Yannoulatos (Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania), Monsignor Rrok Mirdita (head of the Catholic Church of Albania), and Haji Dede Reshat Bardhi (leader of the Bektashi World Order). At the meeting of the Board of Presidency on October 22, 2018, full membership of the Evangelical Brotherhood of Albania was approved, making it the fifth religious community of IRCA.

The Interreligious Council of Albania is registered in the Tirana District Court as a non-profit, non-governmental, non-political, independent, and non-membership centre that exercises its activity independently of state bodies and interests.

The founding ceremony of the IRCA was organised in the presence of the then president of Albania, Prof Bamir Topi, who said: "It (IRCA) marks the institutionalization of



cilin jo vetëm do ta eksportojmë kudo që të mundemi, por do ta ndajmë me shumë dëshirë me vendet dhe popujt e tjerë anembanë globit. Prandaj edhe jam sot këtu, jo vetëm për të kremtuar hapjen e një Këshilli kaq të nevojshëm e të dobishëm për mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërfetare në vendin tonë, por edhe për t'ju siguruar rreth mbështetjes së palëkundur personale e institucionale gjatë ndërmarrjes suaj kaq të vlefshme e të rëndësishme në shërbim te paqes, mirësisë, bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfetare".

Në aktivitetin promovues të themelimit, klerikë nga të gjitha besimet e kanë vlerësuar Këshillin, si një organizëm, që do të koordinojë veprimtari në shkallë rajonale për problemet e bashkëjetesës mes besimeve fetare.

Gjatë ceremonisë së hapjes (2007) kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim Muça, shprehej se "sjellja mes besimeve nuk është një qëndrim dhe vlerësim konkurence dhe dominimi, por si një marrëdhënie bashkëjetese, në shërbim të shoqërisë".

Ndërsa për kreun e ortodoksëve, Kryepiskopin Anastas Janullatos, "Të gjithë, të krishterë e myslimanë duhet të punojnë për bashkëjetesën, pasi ajo nxit progresin shoqëror. Falja dhe pajtimi nuk mund të jenë produkte të një faktori politik, pasi komunitetet fetare janë të pazëvendësueshme."

interfaith tolerance in Albania. This is our common value and our rare virtue, which we shall not only export wherever we can, but shall gladly share it with other countries and peoples around the world. That is why I am here today, not only to celebrate the opening of a Council so a necessary and useful for the progress of inter-religious relations in our country but also to assure you of my unwavering personal and institutional support for this valuable and significant undertaking in service of peace, well-being, coexistence and interfaith tolerance."

In the Council's promotional activity, clerics from all religious faiths praised the Council as an organ that will coordinate activities on problems of coexistence between religious faiths at regional level.

During the opening ceremony (2007), the head of the Muslim Community of Albania, H. Selim Muça, said that "behaviour towards faiths is not an attitude or assessment of competition or dominance, but a relationship of coexistence in service of society."

For the head of the Orthodox Church Anastasios Yannoulatos, "Everyone, Christians and Muslims, must work for coexistence as it promotes social progress. Forgiveness and reconciliation cannot be products of a political factor as religious communities are irreplaceable."



Gjatë këtyre viteve, krahas pjesëmarrjes në disa konferenca ndërkombëtare, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë shpesh herë ka dalë dhe në deklarata për shtyp për çështje të përbashkëta në interes të shoqërisë dhe në mbrojtje të vlerave universale dhe në kuadër të promovimit të dialogut ndërfetar.

Në takimin e dt. 22.10.2018, drejtuesit më të lartë të komuniteteve fetare të Shqipërisë kanë zhvilluar një mbledhje në Selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku janë marrë disa vendime të rëndësishme, lidhur me mirëfunksionimin dhe disa ndryshime statuore të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

Në këtë mbledhje morën pjesë H. Skender Bruçaj, kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, Fortlumturia e tij Anastas Janullatos, kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Mons. George Frendo, kreu i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, si dhe Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

Gjatë këtij takimi, krahas ndryshimeve statuore, u morën edhe disa vendime lidhur me disa ndryshime në aspektin drejtues institucional të Këshillit Ndërfetar, institucion i cili ka në përbërjen e vet Bordin e Presidencës, Bordin Ekzekutiv dhe sekretarin e përgjithshëm.

During these years, in addition to participation in several international conferences, the Interreligious Council of Albania has often released press statements on common issues in the interest of society and in defence of universal values as well for the promotion of interfaith dialogue.

On October 22, 2018, the top leaders of religious communities in Albania gathered at the headquarters of the Muslim Community of Albania, where important decisions were taken regarding the proper functioning of the Interreligious Council of Albania and some changes in its statute.

The meeting was attended by H. Skënder Bruçaj, head of the Muslim Community of Albania, His Beatitude Anastasios Yannoulatos, Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, Monsignor George Frendo, president of the Catholic Episcopal Conference of Albania, H. Dede Edmond Brahimaj, leader of the Bektashi World Order, and Pastor Ylli Doçi, president of the Evangelical Brotherhood of Albania.

During this meeting, in addition to statutory changes, several decisions were taken with regard to some changes in the institutional governing aspect of the Interreligious Council, which is composed of the Board of Presidency, the Executive Board and the Secretary General.



Organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës së KNFSH-së është Bordi i Presidencës, i cili përbëhet nga Kryetarët e Komuniteteve fetare, pjesëmarrës të Qendrës, ndërsa Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga dy anëtarë për çdo komunitet.

Kryetari i Bordit të Presidencës, ka një mandat një vjeçar dhe krerët e komuniteteve fetare do ta kenë këtë detyrë me rotacion, i cili u përcaktua për 5 vite (2019-2024) gjatë mbledhjes së tetorit 2018, ndërsa sekretar i përgjithshëm u zgjodh Dr. Genti Kruja.

Sipas statutit, në rast ndryshimit të kryetarit të secilit komunitet fetar, kryetari i ri automatikisht është dhe anëtar i Këshillit të Presidencës. Me këtë rast pas zgjedhjeve në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë në mars 2019, kreu i ri i KMSH-së H. Bujar Spahiu është dhe anëtar i Bordit të Presidencës të KNFSH-së, konfirmuar dhe në mbledhjen e KNFSH-së më 16 prill 2019.

Këshillit Ndërfetar i Shqipërisë ka si mision të vetin promovimin e dialogut dhe harmonisë ndërfetare, nëpërmjet projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Më 25 tetor 2018, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është vlerësuar me çmimin "De Mello për të Drejtat e Njeriut" në Krakov, Poloni. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, ky çmim iu akordua pesë udhëheqësve të komuniteteve fetare në Shqipëri, me motivacionin "Për Vëllazërinë Ndërfetare në Shqipëri". Çmimi "De Mellon për të Drejtat e Njeriut", jepet

The highest decision-making body of the IRCA is the Board of Presidency, which consists of the leaders of religious communities, participants of the Centre; meanwhile, the Executive Council consists of two representative members from each community.

The Chairman of the Board of Presidency has a one-year term. Chairmanship of the Board of Presidency rotates among the heads of religious communities, which was determined for a five-year period (2019-2024) in the October 2018 meeting. Secretary General was elected Dr. Genti Kruja.

Under the statute, in the event of change of the chairman of a religious community, the new chairman is automatically a member of the Council of Presidency. After the March 2019 elections in the Muslim Community of Albania, the new head of MCA, H. Bujar Spahiu, is also a member of the Council of Presidency of IRCA, which was confirmed at the IRCA meeting of April 16, 2019.

The mission of the Interreligious Council of Albania is to promote interfaith dialogue and harmony through joint projects and activities.

On October 25, 2018, the Interreligious Council of Albania was awarded the "Sergio Vieira De Mello" prize in Krakow, Poland. In the prize-giving ceremony, the prize was awarded to the five heads of the religious communities in Albania for "Interfaith Brother-

çdo vit për individë, apo personalitete që përfaqësojnë kauza në të mirë të shoqërisë së përbashkët.

KNFSH është anëtar me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare "Religions for Peace" me qendër në Nju Jork, SHBA.

## QËLLIMI

**Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë** është një bashkim vullnetar i komuniteteve fetare, i cili ka si qëllim kryesor:

1. Promovimin e njohurive, vlerave dhe parimeve midis komuniteteve fetare, që kanë të bëjnë me ndërtimin e një shoqërie paqësore dhe të drejtë në Shqipëri.

2. Promovimin e një modeli social, kulturor e profesional për komunitetet fetare në Shqipëri.

3. Integrimi i komuniteteve fetare ne jetën shoqërore, duke diskutuar dhe dhënë opinione për fushat e interesit dhe shqetësimit të përbashkët.

4. Planifikimin dhe zbatimin e programeve veprimi të përbashkëta, të bazuara në angazhime morale të përbashkëta në Shqipëri.

5. Pjesëmarrja dhe përfshirja e komunitetit fetar ne vendim-marrje në çështjet, që kanë lidhje me të drejtat e tyre, duke promovuar respekt për traditat unike dhe ndryshimet në besim dhe veprim.

6. Këto qëllime do të realizohen nëpërmjet programeve, projekteve dhe veprimtarive të tjera, që mbështeten në pjesëmarrjen dhe përfshirjen e anëtarëve të komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri, vendimmarrje dhe implementimin e projekteve, si një hap thelbësor për pjesëmarrje dhe mundësi të barabarta të këtyre komuniteteve në shoqërinë shqiptare.

## FUSHAT E VEPRIMTARISË

Në përputhje me qëllimet e Qendrës, fushat e aktivitetit janë:

1. Identifikimi i parametrave ekzistues të nivelit të kooperimit shoqëror të ndërsjelltë dhe përcaktimi i rrugëve dhe metodave, që çojnë në afrimin dhe zgjidhjen e problemeve që lidhen me të, nëpërmjet organizimit të studimeve, anketimeve, sondazheve, e të tjera.

hood in Albania". The prize "Sergio Vieira De Mello" is awarded annually to individuals or personalities who represent causes for the good of the society.

IRCA is a full member of the international organisation "Religions for Peace" based in New York, USA.

## PURPOSE

**The Interreligious Council of Albania** is a voluntary association of religious communities, whose main purpose is**:**

1. To promote knowledge, values and principles between communities, which are related to building a peaceful and just society in Albania.

2. To promote a social, cultural and professional model for religious communities in Albania.

3. To integrate religious communities in social life discussing and giving opinions on areas of common interest and concern.

4. To plan and implement joint action programs based on common moral commitments in Albania.

5. Participation and involvement of the religious community in the decision-making on issues related to their rights, promoting respect for the unique traditions and differences in belief and action.

6. These goals shall be achieved through programs, projects and other activities, which are based on the participation and involvement of the members of traditional religious communities in Albania, decision-making and implementation of projects as an essential step for participation and equal opportunities for these communities in Albanian society.

## AREAS OF ACTIVITY

In accordance with the goals of the Centre, areas of activity are:

1. Identifying existing parameters of mutual social cooperation and determining ways and methods that lead to the approach and solution of problems related to it through organisation of research studies, surveys, questionnaires, and so on.
2. Investigating and identifying violations of the rights of the individual or religious groups for integration and harmonious interaction in society.

2. Investigimi dhe identifikimi i shkeljeve të të drejtave të individëve, apo grupeve fetare për integrim dhe bashkëveprim harmonik në shoqëri.
3. Përgatitja e strategjive, që do të mundësojnë krijimin e koncepteve bashkëkohore të përparuara në favor të zhvillimit dhe integrimit në shoqëri të individëve dhe grupeve të komuniteteve fetare tradicionale.
4. Dhënia e ndihmës multidisiplinore: psikologjike, sociale, juridike, ekonomike etj., për mbështetjen e individë, grupeve të komuniteteve fetare tradicionale, që vuajnë disfunksionet e shkaktuara nga mungesa e integritetit, integrimit dhe zhvillimit social.
5. Bashkëpunim dhe shkëmbim përvoje me partnerë të sigurtë: organizata, institucione qeveritare dhe joqeveritare, persona privatë dhe juridikë, vendas e të huaj, si dhe me organizma të tillë nga vende të ndryshme të botës, për zhvillimin e projekteve në ndihmë të realizimit të synimeve dhe objektivave.
6. Të realizojë publikime të materialeve ndihmëse, vetëm ose në bashkëpunim me institucionet e tjera, të përcaktuara në këtë statut.
7. Të ndihmojë nëpërmjet trajnimeve, seminareve dhe konferencave, grupet e komuniteteve fetare tradicionale, duke ngritur struktura profesionale, që të zhvillojnë njohuritë e tyre në të gjitha fushat.

Të gjitha veprimet e Qendrës mund të kryhen në bashkëpunim me agjencitë përkatëse shtetërore, organizata ndërkombëtare dhe ndërqeveritare.

3. Preparing strategies that will enable the creation of contemporary advanced concepts in favour of the development and integration into society of the individuals and groups of traditional religious communities.
4. Providing multidisciplinary assistance: psychological, social, judicial, economic, and so on, for the support of individuals and groups of traditional religious communities, who suffer dysfunctions caused by lack of integrity, integration and social development.
5. Cooperating and exchanging experience with reliable partners: organisations, governmental and non-governmental institutions, private and legal persons, local or foreign, as well as with such organizations from different countries of the world, for the implementation of projects to help achieve its goals and objectives.
6. Publishing auxiliary materials, alone or in cooperation with other institutions as defined in the statute.
7. Helping groups of traditional religious communities through trainings, seminars and conferences by establishing professional structures in order to develop their knowledge about all areas.

All actions of the Centre can be carried out in cooperation with relevant state agencies as well as international and intergovernmental organisations.

# Organet drejtuese,
# funksionimi dhe kompetencat e tyre

# Governing bodies,
# their functioning and competencies



## BORDI I PRESIDENCËS
## COUNCIL OF PRESIDENCY

Sipas statutit, organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë është Bordi i Presidencës, i cili përbëhet nga, Kryetarët e Komuniteteve fetare pjesëmarrës të Qendrës. Ai mblidhet jo më pak se dy herë në vit dhe në raste urgjente.

Bordi i Presidencës përcakton Kryetarin e Këshillit të Presidencës çdo vit sipas formulës së rotacionit. Në mbledhjen e tetorit 2018 është përcaktuar rotacioni i mëposhtëm:

- Për vitin 2019, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë
- Për vitin 2020, Kisha Katolike e Shqipërisë
- Për vitin 2021, Kryegjyshata Botërore Bektashiane
- Për vitin 2022, Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë
- Për vitin 2023, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Kreu i çdo komuniteti kryeson Bordin e Presidencës së KNFSH-së në vitin e rotacionit që ka ai komunitet. Kështu për vitin 2019 kryetar i KNFSH-së ishte Fortlumturia e Tij Anastas Janullatos, Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, ndërsa

Under the statute, the highest decision-making body of the Interreligious Council of Albania Centre is the Council of Presidency, which is composed of the leaders of the religious communities, participants of the Centre. It meets no less than twice a year and in case of emergencies.

The Council of Presidency appoints the Chairman of the Board of Presidency on a one-year rotating basis. At the October 2018 meeting, the following rotation was determined:

- For year 2019, the Orthodox Autocephalous Church of Albania
- For year 2020, the Catholic Church of Albania
- For year 2021, the Bektashi Order
- For year 2022, the Evangelical Brotherhood of Albania
- For year 2023, the Muslim Community of Albania

The Council of Presidency is chaired by the head of the community holding the rotating presidency. Thus, for year 2019 chairperson of IRCA was his Beatitude Anastasios

për vitin 2020, Mons. George Frendo, President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë.

Kryetari i Bordit të Presidencës përfaqëson KNFSH në marrëdhënie me të tretët, nënshkruan çdo akt, që del nga mbledhjet e Bordit Presidencial, thërret mbledhjet e Këshillit, dëgjon raporte nga Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi ekzekutiv, si dhe autorizon persona të tjerë për të kryer veprime proceduriale pranë gjykatave, apo organeve të tjera shtetërore.

Bordi i Presidencës zgjedh me votim Sekretarin e Përgjithshëm dhe financierin te propozuar nga Kryetari. Bordi drejton të gjithë veprimtarinë e Këshillit, përcakton drejtimet konkrete te punës, miraton projektet e Këshillit dhe prioritetet e financimeve të projekteve.

## Bordi i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, përbëhet nga krerët e pesë komuniteteve fetare:

1. **H. Bujar Spahiu,** Kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë
2. **Fortlumturia e Tij Anastas Janullatos**, Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë
3. **Mons. George Frendo,** President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë
4. **H. Dede Edmond Brahimaj**, Kryegjysh Botëror i Bektashinjve
5. **Pastor Ylli Doçi**, President i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë

Yannoulatos, Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, while for year 2020, the Board of Presidency is chaired by Monsignor George Frendo, President of the Catholic Episcopal Conference of Albania.

The chairman of the Council of Presidency represents IRCA in relations with third parties, signs every act that comes out of the board's meetings, convenes meetings of the Council, hears reports from the Secretary General and executive staff, and authorizes other persons to perform procedural actions in courts or other state bodies.

The Council of Presidency elects by vote the Secretary General and the financer proposed by the Chairperson. The Board runs all the activities of the Council, determines the concrete directions of work and approves the projects of the Council and project funding priorities.

## The Board of Presidency of the Interfaith Council of Albania is composed of the heads of the five religious communities:

1. **H. Bujar Spahiu,** Chairman of the Muslim Community of Albania
2. **His Beatitude Anastasios Yannoulatos**, Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania
3. **Monsignor George Frendo**, President of the Catholic Episcopal Conference of Albania
4. **H. Dede Edmond Brahimaj**, Head of Bektashi World Order
5. **Pastor Ylli Doçi**, President of the Evangelical Brotherhood of Albania

**Bujar Spahiu** ka lindur më 26 shkurt 1976 në Kukës.

Pasi mbaroi arsimin 8-vjeçar në Shkollën "Lidhja e Prizrenit në Kolesjan, ai u bë pjesë e kontingjentit të parë të studentëve që u nisën nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë drejt Turqisë në vitin 1992.

Kështu më 1996 ai kreu Medresenë Bejkoz në Stamboll, Turqi.

Më pas ai kreu studimet Teologjike universitare dhe pasuniversitare në Universitetin e Ez'herit në Kajro, Egjipt në vitin 2003 në fushën e Tefsirit (interpretimi i Kur'anit).

H. Bujar Spahiu ka një kontribut të gjatë në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ku ka shërbyer si drejtor në Drejtorinë e Arsimit në KMSH nga viti 2006 deri në vitin 2009 dhe nga vitit 2009 deri në vitin 2019 ka ushtruar detyrën e nënkryetarit në këtë institucion.

H. Bujar Spahiu ka marrë pjesë dhe ka përfaqësuar Komunitetin Mysliman në shumë takime të rëndësishme, organizime të ndryshme, konferenca, simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu Spahiu ka qenë i angazhuar në mësimdhënie në universitet dhe medresetë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në fushën e specializimit të tij.

Z. Spahiu është i martuar dhe ka dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë.

**Bujar Spahiu** was born on February 26, 1976 in Kukës.

After completing secondary education in school "Lidhja e Prizrenit" in Kolesjan, he joined the first contingent of students who were sent to study in Turkey in 1992 by the Muslim Community of Albania.

In 1996, he graduated from the Beykoz Madrasah in Istanbul, Turkey.

He completed his undergraduate and postgraduate theological studies at Ezher University in Cairo, Egypt, in 2003 with a degree in Tafsir (interpretation of the Qur'an).

H. Bujar Spahiu has contributed for a long time in the Muslim Community of Albania (MCA), where he served as Director of Education from 2006 to 2009, and as vice-chairman of this institution from 2009 to 2019.

H. Bujar Spahiu has participated and represented the Muslim Community in several important meetings, different organisations, conferences, and national and international symposia.

He has also been engaged in teaching at university and madrasas of the Muslim Community of Albania.

Mr Spahiu is married and has two children, a son and a daughter.



H. Bujar Spahiu



His Beatitude
Anastas Yannoulatos

**Fortlumturia e Tij Anastas Janullatos** - Kryetar i Bordit të Presidencës për periudhën 01.10.2018 deri 31 dhjetor 2019.

Fortlumturia e Tij Anastas Janullatos lindi më 4 nëntor të vitit 1929, në Pire, Greqi. Ai ka qenë profesor i Historisë së Feve (1972-92) dhe Dekan i Fakultetit Teologjik të Universitetit Kombëtar Kapodistrian të Athinës (1983-1986) dhe sot është Profesor Emeritus i po të njëjtit Universitet. Ai është shpallur Doktor Nderi i Teologjisë dhe Filozofisë nga 19 universitete, fakultete ose degë universitare (në Greqi, SHBA, Qipro, Rumani, Gjeorgji, Shqipëri, Itali), Anëtar Korrespondent (1993-2005) dhe Anëtar Nderi (nga viti 2006) i Akademisë së Athinës.

## Studimet Pasuniversitare

Histori e Feve, Etnologji, në Universitetet e Hamburgut dhe të Marburgut në Gjermani, (me bursë pasuniversitare të Institutit "Alexander von Humboldt Stiftung"). Ai studioi gjithashtu edhe fetë e botës, duke kryer udhëtime në vendet ku ato lulëzuan.

Si Kryepiskop i Shqipërisë (1992 deri më sot), në rrethana jashtëzakonisht të vështira, ringriti dhe zhvilloi më tej Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, që për 23 vite ishte e shpërbërë. Bashkë me veprën e rivitalizimit të Kishës Orthodhokse, u realizuan edhe programe inovative në sektorët e shëndetit, kujdesit social, edukimit, zhvillimit rural, kulturës dhe ekologjisë. Njëkohësisht, ai u përpoq për të ndihmuar në zbutjen e shumë tensioneve në Ballkan.

**His Beatitude Anastasios Yannoulatos** - Chairman of the Council of Presidency for the period from October 01, 2018 to December 31, 2019.

His Beatitude Anastasios Yannoulatos was born on November 4, 1929, in Piraeus, Greece. He has been a Professor of History of Religions (1972-92) and Dean of the Faculty of Theology, at the National and Kapodistrian University of Athens (1983-1986). Currently he is Professor Emeritus of the National and Kapodistrian University of Athens. He has been awarded Honorary Doctor of Theology and Philosophy by 19 universities, faculties and university branches (in Greece, the USA, Cyprus, Romania, Georgia, Albania, and Italy), Corresponding Member (1993-2005) and Honorary Member (as of 2006) of the Academy of Athens, Honorary Senator of the European Academy of Sciences and Arts – Salzburg (2019-).

## Postgraduate Studies

History of Religions, Ethnology, at the universities of Hamburg and Marburg, in Germany, (with a postgraduate scholarship from the "Alexander von Humboldt" Foundation). He also studied religions of the world travelling to the places where they flourished.

As Archbishop of Albania (from 1992 to the present), in extremely difficult circumstances, he reconstructed and further developed the Orthodox Autocephalous Church of Albania, which had been disbanded for 23 years. Along with the revitalization of the Orthodox Church, innovative programs were also implemented in the sectors of health, social care, education, rural development, culture and ecology. He has also sought to help ease tensions in the Balkans.

Ai është zgjedhur vazhdimisht në pozicione të shquara në udhëheqjen e organizmave ndërkombëtarë: Moderator i Komitetit për Misionin dhe Ungjillëzimin Botëror (1984-1991) dhe i Konferencës së Misionarizmit dhe Ungjillëzimit Botëror në San Antonio Teksas (1989); anëtar i Këshillit Evropian të Udhëheqësve Fetarë (2003-2010); Zëvendës/president i Konferencës së Kishave Evropiane (2003-2009); President i Këshillit Botëror të Kishave (2006-2013); President Nderi i Konferencës Botërore të Feve për Paqen ("Religions for Peace", 2006 e në vazhdim).

**Është autor i 24 librave** (kërkime për Fetë Afrikane, ese në Teologji dhe në Historinë e Misioneve, predikime etj.), ku përfshihen: "Islami, një vështrim i përgjithshëm" (16 botime), "Historia e Feve-Gjurmë nga kërkimi i Transhendentes", "Globalizmi dhe Orthodhoksia", "Hierapostullim në gjurmët e Krishtit", "Deri në skajet e dheut", "Bashkekzistenca", "Në Shqipëri - Kryq dhe Ngjallje". Ka botuar mbi 200 ese dhe artikuj me tema teologjike e baritore. Studimet dhe artikujt e tij janë përkthyer në 17 gjuhë të huaja.

**Është nderuar me 27 medalje dhe çmime nga shumë Kisha Orthodhokse dhe vende të ndryshme, si: "Kryqi i Madh i Urdhrit të Nderit i Republikës së Greqisë" (1997); çmimi "Athenagora për të Drejtat e Njeriut" (Nju Jork, 2011); çmimi për "Kontributin e shquar për unitetin e popujve orthodhoksë" (Moskë, 2005); dekorata "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" (Tiranë, 2010).**

Kryepiskopi Anastas është njohës i thellë në fushën e Historisë së Feve dhe të dialogut ndërfetar. Kontributi i tij i rëndësishëm në Hierapostullimin e Krishterë, në Teologji dhe në bashkëjetesën paqësore të popujve dhe të komuniteteve fetare është i njohur botërisht.

He has consistently been elected to leading positions in international bodies: Moderator of the Commission on World Mission and Evangelism (1984-1991) and of the Conference on World Mission and Evangelism in San Antonio, Texas (1989); Member of the European Council of Religious Leaders (2003-2010); Vice-president of the Conference of European Churches (2003-2009); President of the World Council of Churches (2006-2013); Honorary President of the World Conference "Religions for Peace" (from 2006 to the present).

He is author of 24 books (research on African Religions, essays on Theology and History of Missions, sermons, etc.), including "Islam - a general overview" (16 editions), "A History of Religions - Footprints of the Quest for the Transcendent", "Globalization and Orthodoxy", "Mission in Christ's Way", "To the End of the Earth ", "Coexistence", "In Albania - Cross and Resurrection". He has published over 200 essays and articles on theological and pastoral topics. His studies and articles have been translated into 17 languages.

He has been honoured with 30 medals and awards from many Orthodox Churches and different countries such as: "The Grand Cross of the Order of Honour of the Hellenic Republic" (1997); "Athenagoras for Human Rights" award (New York, 2011); prize "For outstanding activities in strengthening the unity of Orthodox Christian nations" (Moscow, 2005); "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" decoration (Tirana, 2010); "Klaus-Hemmerle" prize (Aachen, 2020).

Archbishop Anastasios is well-versed in the History of Religions and interfaith dialogue. His significant contribution to Christian witness, theology, and peaceful coexistence between peoples and religious communities is world-renowned.



Mons. George Frendo O.P.

Mons. George Anthony Frendo ka lindur në Maltë, me 4 prill 1946. Pasi kreu shkollën fillore e të mesme, në vitin 1962 hyri në Urdhërin e Predikatorëve (Domenikanë). Në vijim ndoqi studimet në filozofi dhe teologji në *Collegium Philosophico-Theologicum Sancti Thomae Aquinatis* në Rabat, Maltë. Është shuguruar prift më 7 prill 1969.

## STUDIMET DHE MËSIMI

Nga Kolegji i Shën Tomës së Rabat-it, mori gradën e Lektoratit në teologji me tezën *Baptism as the Sacrament of Faith in the Doctrine and Practice of the Church* (Pagëzimi si Sakramenti i Fesë në Doktrinën dhe në Praktikën e Kishës). Vazhdoi studimet në *Pontificia Universitas Sancti Thomae Aquinatis* në Romë, në Fakultetin e së Drejtës Kanonike dhe në 1973 u diplomua si doktor në të Drejtën Kanonike duke mbrojtur tezën, *Indissolubility and Divorce in the Theology of Thirteenth Century Scholastics* (Pazgjidhshmëria e Martesës dhe Divorci në teologjinë e Skolastikëve të shekullit trembëdhjetë).

Me kthimin në Maltë, menjëherë nisi të japë mësimin e Teologjisë Dogmatike në *Collegium Philosophico-Theologicum Sancti Thomae Aquinatis* e domenikanëve; dha mësim gjithashtu në disa kurse të Teologjisë Dogmatike (Sakramentet, Kristologji dhe Eskatologji) në Fakultetin e Teologjisë në Maltë si dhe një kurs mbi ateizmin bashkëkohor në Seminarin e Gozo-s.

Në Shqipëri ka dhënë mësim Teologjinë Trinitare dhe Kristologjinë në Seminarin Ndërdioqezan në Shkodër.

Mons. George Anthony Frendo was born in Malta on April 4, 1946. After graduating from secondary and high school, he joined the Order of Preachers in 1962. He then, studied philosophy and theology in *Collegium Philosophico-Theologicum Sancti Thomae Aquinatis* in Rabat, Malta. He was ordained priest on April 7, 1969.

## STUDIES AND TEACHING

He received the degree Lecturer in Theology from St. Thomas College, in Rabat-it, with his thesis *Baptism as the Sacrament of Faith in the Doctrine and Practice of the Church.* He continued his studies at *Pontificia Universitas Sancti Thomae Aquinatis,* Faculty of Canon Law, in Rome, and in 1973, he received his doctoral degree in Canon Law defending his thesis *Indissolubility and Divorce in the Theology of Thirteenth Century Scholastics.*

Upon his return to Malta, he started teaching Dogmatic Theology *Collegium Philosophico-Theologicum Sancti Thomae Aquinatis* of the Dominicans. He also taught several courses of Dogmatic Theology (Sacraments, Christology and Eschatology) at the Faculty of Theology in Malta, as well as a course on contemporary atheism in the seminar of Gozo.

In Albania, he has taught Theology of Trinity and Christology in the Inter-diocesan seminar in Shkoder.

## ZYRAT NË URDHRIN DOMENIKAN

1974-1979: Mësues i rishtarëve e studentëve
1979-1981: Epror lokal
1981-1989: Famullitar në një famulli domenikane në Maltë
1989-1997: Provincial i domenikanëve në Maltë
1992-1996: President i Konferencës së Eprorëve të Lartë në Maltë

## ZYRAT NË ARKIDIOQEZËN E MALTËS

1974-1980: Defensor Vinculi (Mbrojtës i Lidhjes Martësore) në Tribunalin Kishtar
1980-1989: Gjykatës i Gjykatës Ndërdioqezane të Shkallës së Dytë.

Anëtar i komisionit të krijuar nga Konferenca Ipeshkvore malteze mbi përpunimin e normave plotësuese në vijimin e promulgimit të Kodit të ri të së Drejtës Kanonike.

## ZYRAT KISHTARE NË SHQIPËRI

1997-1999: I ngarkuar nga Konferenca Ipeshkvore shqiptare për përpunimin e normave plotësuese në vijimin e promulgimit të Kodit të ri të së Drejtës Kanonike.
1998-1995: Vikar i Përgjithshëm i Kryedioqezës së Tiranë-Durrësit
1999-2005: President i Konferencës së Eprorëve të Lartë në Shqipëri
2001-2006: Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Evropian për Eprorët e Lartë Rregulltarë
2001- 2006: Vikari Gjyqtar i Gjykatës Ndërdioqezane
Nga 23 shtator 2006: Ipeshkëv ndihmës i Tiranës
Në 2007 u emërua anëtar i Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar
Në maj 2012 u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i Konferences Ipeshkvore
Më 3 dhjetor 2016 u shpall Arqipeshkvi i Arqidioqezes Tiranë-Durrës.
Më 5 shkurt 2018 u zgjodh Presidenti i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë
Prej janarit 2020 deri në fund të vitit 2020 do të kryesojë Presidencën e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

Mons. Frendo është autor i disa librave të natyrës doktrinale dhe shpirtërore. Ai ka përvojën e shumë takimeve ndërkombëtare, si provincial i domenikanëve në Maltë, pastaj si president i Konferencës së Eprorëve të Lartë në Maltë dhe Shqipëri, si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Europian për Eprorët e Lartë Rregulltarë dhe gjithashtu si delegat në emër të Konferencës Ipeshkvore Shqiptare.

## OFFICES IN THE ORDER OF PREACHERS

1974-1979: Master of novices and students
1979-1981: Local superior
1981-1989: Pastor in a Dominican parish in Malta
1989-1997: Provincial Pastor of Dominicans in Malta
1992-1996: President of the Major

## OFFICES OF THE ARCHDIOCESE IN MALTA

1974-1980: Defensor Vinculi (Defender of the Marriage Bond) at the Ecclesiastical Tribunal
1980-1989: Judge at the Inter-diocesan Tribunal of the Appeal

Member of the commission established by the Maltese Episcopal Conference on the elaboration of complimentary norms after the promulgation of the new Code of Canon Law.

## CHURCH OFFICES IN ALBANIA

1997-1999: Charged with the elaboration of complementary norms following the promulgation of the New Code of Canon by the Episcopal Conference of Albania
1998-1995: Vicar General of the Archdiocese of Tirana-Durres
1999-2005: President of the Conference of Major Superiors in Albania
2001-2006: Member of the Council of European Major Religious Superiors
2001- 2006: Judiciary Vicar of the Inter-diocesan Tribunal
As of 23 September 2006: Auxiliary Bishop of Tirana
In 2007, he was appointed member of the Pontifical Council for Interreligious Dialogue
In May 2012, he was elected Secretary General of the Episcopal Conference
On December 3, 2016, he was proclaimed Archbishop of the Archdiocese of Tirana-Durres
On February5, 2018, he was elected President of the Episcopal Conference of Albania
From January 2020 until the end of 2020, he will chair the Presidency of the Interreligious Council of Albania

Mons. Frendo has authored several books of a doctrinal and spiritual nature. He has participated in many meetings as Provincial Pastor of the Dominicans in Malta, as President of the Conference of Religious Major Superiors in Malta and Albania, as member of the General European Council of Religious Major Superiors, and as President of the Episcopal Conference of Albania.



**H. Dede Edmond Brahimaj**

Edmond Brahimaj lindi në Tiranë, më 19 maj 1959, nga një familje me origjinë nga Brataj i Vlorës. Pas mbarimit të shkollës 8 vjeçare, ai vazhdoi studimet në Shkollën e mesme 'Skënderbej' dhe arriti rezultate të larta, që i dhanë të drejtën për të ndjekur studimet ushtarake Universitare në Akademinë e Forcave Tokësore, sot "Skënderbej".

Me ringjalljen e besimit në fund të viteve '90, së bashku me klerikë dhe besimtarë të tjerë bektashinj, mori pjesë në Këshillin Organizativ të Kryegjyshatës Botërore të Bektashinjve. Më 16 maj 1996, ai u shpall me Urdhrin "Dervish" dhe menjëherë u ngarkua me detyrë në Teqenë Bektashiane të Korçës, në teqenë e Turanit.

Më 13 prill 1997, dekretohet me titullin "Baba" dhe emërohet si Nënkryetari i parë nga Haxhi Dede Reshat Bardhi.

Në Mars 2006, ai u emërua në funksionin e gjyshit të Teqesë Bektashi në Maqedoni. Pasi kalimit në amshim të ish-udhëheqësit botëror Bektashi, H. Dede Reshat Bardhi, H. Baba Edmond Brahimaj më 11 qershor 2011 zgjidhet në postin e Drejtuesit të Kryegjyshatës Botërore të Bektashinjve në Tiranë.

Këto vite H. Dede Edmond Brahimaj, ka punuar me përkushtim, duke vazhduar rrugën e Dede Reshat Bardhit, traditës bektashiane, brenda dhe jashtë vendit. H. Dede Edmond Brahimaj ka marrë tituj nderi: "Ambasadori i Paqes", 2004; "Nderi i Qarkut Korçë", 2004; "Qytetar Nderi" i Komunës Zerqan-Bulqizë, 10 qershor 2014; "Qytetar Nderi" i Komunës Martanesh-Bulqizë, 29 Qershor 2014; "Qytetar Nderi" i Komunës Bogovë-Skrapar, 22 Gusht 2014; "Qytetar Nderi "të Bashkisë

Edmond Brahimaj was born in Tirana on May 19, 1959, to a devoted Bektashi family from Brataj, Vlore. Upon completion of secondary education, he continued his studies at high school "Scanderbeg" and achieved high results, which granted him the right to pursue undergraduate military studies at the Academy of Land Forces, today "Scanderbeg".

With the revival of religions in the late 1990s, along with clergy and other Bektashi believers, he participated in the Organizing Council of the Holy See of Bektashi World Headquarters. On May 16, 1996, he was ordained "Dervish" and was immediately appointed to the Bektashi Tekke of Turan, in Korça.

On April 13, 1997, he was ordained "Baba" and was appointed first deputy by Haji Dede Reshat Bardhi.

In March 2006, he was appointed grandfather of the Bektashi Tekke in Macedonia. Following the death of H. Dede Reshat Bardhi, former leader of Bektashi Order, H. Baba Edmond Brahimaj was appointed leader of the Bektashi World Order in June 2011.

During these years, H. Dede Edmond Brahimaj has worked dedicatedly, following the path of Dede Reshat Bardhi and the Bektashi tradition both at home and abroad. H. Dede Edmond Brahimaj has received honorary titles: "Ambassador of Peace ", 2004; "Honour of Korça Region", 2004; "Honorary Citizen" of the Municipality of Zerqan-Bulqizë, June 10, 2014; "Honorary Citizen" of the Municipality of Martanesh-Bulqizë, June 29, 2014; "Honorary Citizen" of Municipality Bogovë-Skrapar, August 22, 2014; "Honorary Citizen" of the Municipality of Frashër, Përmet, May 25, 2014; "Prominent Personality

Frashër-Përmet, 25 maj 2014." Personaliteti i shquar i Labërisë, Shoqata "Labëria", Shkurt 2015; "Qytetar Nderi" i Qarkut Fier, Mars 2015. "Qytetar Nderi i Qarkut Berat, maj 2015.; Urdhri i kalorësisë së Skënderbeut, 7 Shtator 2015 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë; "Dr. Honorus Causa", Misioni i OKB, Shtator 2016; "Komuna e Nderit e Bulqizës", Tetor 2016; "Mirënjohje" nga SH.B.A. Presidenti Obama, Janar 2017; Gold Awards "Peace Icon" Organizata e Kombeve të Bashkuara, "GOD Awards" Tetor 2017; "Qytetar Nderi" i Skraparit, Komuna e Skraparit, Janar 2018; Më 26 qershor 2019 Zëvendës President i Dr. Munr Kazmir Kongresi i Hebrenjve nderoi në shenjë mirënjohjeje H. Dede Edmond Brahimajn dhe Komunitetin Bektashi me Flamurin Amerikan.

of Labëria" awarded by "Labëria" association in June 2015; "Honorary Citizen" of Fier region, March 2015. "Honorary Citizen" of Berat region, May 2015; "Knight of the Order of Scanderbeg", September 7, 2015, awarded by the President of the Republic of Albania; "Dr. Honorus Causa" UN Mission, September 2016; " Honorary Citizen" of the commune of Bulqiza ", October 2016; "Gratitude" by the US President Obama, January 2017; Gold Awards "Peace Icon" United Nations; "G.O.D Awards" October 2017; "Honorary Citizen" of Skrapar, January 2018; On June 26, 2019, vice-president of the US Congress of the Jews, Dr. Munr Kazmir, honoured H. Dede Edmond Brahimaj and the Bektashi Community with the American Flag.



Pastor Ylli Doçi

**Dr. Ylli H. Doçi** pasi mbaroi studimet për skulpturë në Akademinë e Arteve në Tiranë, ndoqi studime të mëtejshme në seminarin e Denverit, SHBA, duke u diplomuar **në vitin 2003** në Master në Filozofinë e Religjionit (Cum Laude).

Dokoratura e tij në Antropologji Sociale u fokusua në marrëdhëniet ndërfetare **në Shqipëri në vijim të një përvoje personale prej më shumë se 2 dekadash në këtë fushë.**

Përveç shkrimeve dhe fjalimeve në aspekte të ndryshme të jetës shoqërore, z. Ylli Doçi ka shërbyer në role të ndryshme udhëheqëse organizative në Shqipëri dhe jashtë saj. Ai është drejtori shqiptar për Fondacionin Ndërkombëtar të Udhëheqësisë dhe nga 2016 është zgjedhur si Presidenti i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, që përfaqëson një komunitet ungjillor ndërdenominacional. Ai është themelues dhe pastor drejtues i kishës "Guri i Themelit" **në Tiranë**, ku edhe banon me gruan e tij Nikki, të cilët kanë dy **fëmijë**, studentë në universitet.

After graduation in 1995 with a masters in sculpture from the Academy of Fine Arts in Tirana, **Dr. Ylli H. Doçi** continued his graduate studies at the Denver Seminary in USA, receiving a Master's degree in the Philosophy of Religion Cum Laude in 2003.

He earned the degree of Doctor of Sciences in Social Anthropology from the European University in Tirana and focused on interreligious relations in Albania following a personal experience of more than two decades in this field.

In addition to writing a book and several academic articles Dr. Doçi frequently speaks on various aspects of social life in various national media platforms. Dr. Ylli Doçi has had various leading roles with Christian organizations in Albania and abroad. He is the Albanian director of the International Leadership Foundation and since 2016 also serves as the President of Evangelical Brotherhood of Albania, representing an interdenominational Evangelical community. He is founder and pastor of the evangelical church "Guri i Themelit" in Tirana, where he lives with his wife Nikki. He has two children, who are university students.





Dr. Genti Kruja

## SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sipas statutit, Sekretari i Përgjithshëm drejton Bordin Ekzekutiv, si dhe ka për detyrë të koordinojë zbatimin e politikave dhe programeve të autorizuara nga Bordi i Presidencës.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë është **Dr. Genti Kruja**, i zgjedhur më 22 tetor 2018 nga Bordi i Presidencës së KNFSH-së.

**Dr. Genti Kruja** ka mbaruar studimet e larta për Sociologji më 2003 në Universitetin Istanbul, Fakulteti i Shkencave Sociale në Stamboll. Në 2007 ka kryer Masterin në Universitetin e Tiranës, dega Sociologji-Filozofi me temë "Dialogu dhe toleranca ndërfetare: ecuri dhe sfida". Në 2015 ka kryer studimet e doktoraturës në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega Filozofi, me temë dialogun ndërkulturor.

Gjatë viteve të fundit, me anë të programeve të ndryshme, ka bërë të mundur bashkëpunimin me disa organizata vendase dhe ndërkombëtare për të organizuar evenimente promovuese të vlerave të dialogut, me të cilat janë organizuar zhvilluar disa simpoziume dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

Genti Kruja është autor i librit "Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar", bashkautor i disa librave dhe editor i më shumë se 50 librave të tjerë.

Nga vitet 2003-2005 ka qenë drejtor i Shtëpisë Botuese "Prizmi" dhe redaktor në gazetën "Drita Islame", organ i KMSH-së.

## SECRETARY GENERAL

Under the statute, the Secretary General chairs the Executive Board and is tasked with coordinating the implementation of policies and programs authorized by the Council of Presidency.

Secretary General of the Interreligious Council of Albania is **Dr. Genti Kruja**, elected on October 22, 2018 by the Council of Presidency of IRCA.

**Dr. Genti Kruja** graduated in Sociology from Istanbul University, Faculty of Social Sciences, in 2003. He earned his master's degree from the university of Tirana in Sociology and Philosophy with a thesis on "Interfaith Dialogue and Tolerance: progress and challenges". In 2015, he completed his doctoral studies at the University of Tirana, Faculty of Social Sciences with a dissertation on intercultural dialogue.

In recent years, he has enabled cooperation with several local and international organisations for organizing promotional events of dialogue such as local and international symposia and conferences.

Genti Kruja is author of the book "Albanians facing challenges of interfaith understanding", co-author of several books, and editor of more than 50 other books.

From 2003-2005, he was director of Publishing House "Prizmi" and editor of the newspaper "Drita Islame", an organ of the Muslim Community of Albania.

In the years 2005-2010, he was Director of Human Resources at the Muslim Community of Albania.

Në vitet 2005-2010 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Në vitet 2010-2016 ka qenë Drejtor i Kulturës dhe i Dialogut Ndërfetar dhe nga viti 2005 deri 2017 anëtar i Kryesisë së KMSH-së.

Në vitet 2014-2017 ka qenë njëkohësisht drejtor i revistës "Drita Islame", si dhe nga viti 2012 ushtron edhe detyrën e kryeredaktorit të revistës shkencore "Zani i Naltë", themeluar më 1923 dhe rithemeluar më 2012 me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë.

Ai është gjithashtu anëtar i Institutit të Sociologjisë.

Duke filluar nga janari i vitit 2017, Dr. Genti Kruja është Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame dhe prej vitit 2013 lektor i Sociologjisë dhe i Sociologjisë së Fesë në Kolegjin Universitar Bedër, si dhe ekspert i jashtëm i profileve: Sociologji, Filozofi, Teologji, Studime Religjioze dhe Dialog Ndërfetar.

In the years 2010-2016, he was Director of Culture and Interfaith Dialogue and from 2005 to 2017 a member of the Presidency of MCA.

In the years 2014-2017, he was also director of the magazine "Drita Islame", and since 2012 he has been the editor-in-chief of journal "Zani i Naltë", initially established in 1923 and re-established in 2012 on the occasion of the 100$^{th}$ anniversary of the Independence of Albania.

He is also member of the Institute of Sociology.

Dr. Genti Kruja has been the Head of the Department of Islamic Sciences since January 2017 and since 2013 lecturer of Sociology and Sociology of Religion at University College Beder, as well as external expert in the fields of: Sociology, Philosophy, Theology, Religious Studies and Interreligious Dialogue.



## BORDI EKZEKUTIV

Bordi Ekzekutiv përbëhet nga 11 anëtarë, nga dy përfaqësues të secilit komunitet fetar dhe Sekretari i Përgjithshëm.

### Bordi Ekzekutiv

1. Propozon buxhetin vjetor të KNFSH-së
2 Propozon plan - buxhetin për periudhën tjetër financiare
3 Harton dhe organizon aktivitetet e KNFSH-së
4. Shqyrton raportet financiare
5. Propozon veprimet strategjike dhe plan-veprimin e KNFSH-së dhe objektivat prioritare
6. Propozon statutin ose ndryshimet e tij
7. Propozon rregulloret e brendshme të KNFSH-së.

Bordi Ekzekutiv mblidhen jo më pak se tre herë në vit dhe në raste të jashtëzakonshme. Ai thirret dhe drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

## EXECUTIVE BOARD

The Executive Board is composed of 11 members, who are two representatives from each religious community and the Secretary General

### The Executive Board:

1. Proposes the annual budget of IRCA
2. Proposes a budget plan for the next financial period
3. Drafts and organizes the activities of IRCA
4. Examines financial reports
5. Proposes strategic actions, the action plan of IRCA and priority objectives
6. Proposes the statute or its amendments
7. Proposes internal regulations of IRCA

The Executive Board meets no less than three times a year and in cases of emergencies. It is convened and chaired by the Secretary General.

## ANËTARËT E BORDIT EKZEKUTIV TË KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË JANË:

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Dr. Genti Kruja

**KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË:**

1. Z. Dorian Demetja
2. Z. Agron Hoxha

**KISHA ORTODOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË:**

1. Hirësi Asti Bakallbashi
2. Z. Thoma Shkira

**KISHA KATOLIKE E SHQIPËRISË:**

1. Don Henry Velmkamp
2. Dom Gjergj Meta

**KRYEGJYSHATA BOTËRORE BEKTASHIANE**

1. Z. Syrja Xhelaj
2. Znj. Sheldiana Jano (Agaraj)

**VËLLAZËRIA UNGJILLORE E SHQIPËRISË:**

1. Z. Ergest Biti
2. Z. Erion Prendi

## MEMBERS OF THE EXECUTIVE BOARD OF THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA ARE:

**SECRETARY GENERAL**

Dr. Genti Kruja

**MUSLIM COMMUNITY OF ALBANIA:**

1. Mr. Dorian Demetja
2. Mr. Agron Hoxha

**ORTHODOX AUTOCEPHALOUS CHURCH OF ALBANIA:**

1. Bishop Asti Bakallbashi
2. Mr. Thoma Shkira

**CATHOLIC CHURCH OF ALBANIA:**

1. Don Henry Velmkamp
2. Bishop Gjergj Meta

**WORLD BEKTASHI ORDER:**

1. Mr. Syrja Xhelaj
2. Mrs. Sheldiana Jano (Agaraj)

**EVANGELICAL BROTHERHOOD OF ALBANIA:**

1. Mr. Ergest Biti
2. Mr. Erion Prendi




## DEPARTAMENTI I GRUAS

1. Departamenti i Gruas në KNFSH përbëhet nga një përfaqësuese grua nga çdo komunitet fetar, anëtar i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, të cilat nominohen nga secili komunitet dhe miratohen në Këshillin e Presidencës.

2. Departamenti i Gruas mblidhet jo më pak se dy herë në vit. Mbledhja drejtohet nga Përgjegjësja e këtij departamenti, detyrë e cila kalon me rotacion një vjeçar nga secila anëtare e këtij departamenti.

3. Rotacioni i marrjes së drejtimit të departamentit të gruas përcaktohet me vendim të brendshëm të Këshillit të Presidencës.

4. Përgjegjësja e Departamentit të gruas raporton me shkrim të paktën një herë në vit para Këshillit të Presidencës për aktivitetet vjetore brenda departamentit.

5. Pas çdo aktiviteti/mbledhje të kryer nga Departamenti i Gruas përgjegjësja e departamentit duhet të informojë me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm për detyrat dhe konkluzionet e nxjerra.

## DEPARTMENT OF WOMEN

1. The Department of Women of IRCA is composed of women representatives of every religious community that is a member of the Interreligious Council of Albania, and they are nominated by the relevant community and approved by the Council of Presidency.

2. The Department of Women meets no less than twice a year. The meeting is chaired by the Head of the Department, a position held by each member on a one-year rotating basis.

3. Rotation of leadership in the Department of Women is determined by an internal decision of the Council of Presidency.

4. The head of the Department of Women reports in writing on the department's annual activities to the Council of Presidency at least once a year.

5. After each activity/meeting of the Department of Women, the head of the department informs in writing the Secretary General of the tasks and conclusions.



## DEPARTAMENTI I RINISË

1. Departamenti i Rinisë në KNFSH përbëhet nga dy përfaqësues të rinj nga çdo komunitet fetar, anëtar i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, të cilët nominohen nga secili komunitet dhe miratohen në Këshillin e Presidencës.

2. Departamenti i Rinisë mblidhet jo më pak se dy herë në vit. Mbledhja drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i KNFSH-së.

3. Një përfaqësues i Departamentit të rinisë raporton me shkrim të paktën një herë në vit para Këshillit të Presidencës për aktivitetet vjetore brenda departamentit.

Të gjithë anëtarët e bordeve dhe departamenteve e ushtrojnë detyrën në mënyrë vullnetare.

## DEPARTMENT OF YOUTH

1. The Department of Youth of IRCA is composed of two young representatives from each religious community, members of the Interreligious Council of Albania, who are nominated by each community and are then approved by the Council of Presidency.

2. The Department of Youth meets no less than twice a year. The meeting is chaired by the Secretary General of IRCA.

3. A representative of the Department of Youth reports in writing on the department’s annual activities to the Council of Presidency at least once a year.

All the board and department members exercise their duty voluntarily.

# AKTIVITETE

# ACTIVITIES

# KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË VLERËSOHET ME ÇMIMIN “DE MELLON PËR TË DREJTAT E NJERIUT”

Më dt. 25 tetor 2018 në Krakov të Polonisë është zhvilluar ceremonia e ndarjes së çmimit “De Mellon për të Drejtat e Njeriut”, ceremoni në të cilën ky çmim iu dha krerëve më të lartë të komuniteteve fetare të vendit tonë, me motivacionin “Për Vëllazëri Ndërfetare në Shqipëri”.

Në emër të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, çmimi u tërhoq nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Skender Bruçaj.

Çmimi “De Mellon për të Drejtat e Njeriut”, jepet çdo vit për individë apo personalitete, që përfaqësojnë kauza në të mirë të shoqërisë së përbashkët.

Më pas, përfaqësuesit e komuniteteve fetare të Shqipërisë zhvilluan një vizitë në kampin famëkeq të Aushvicit, ku vendosën një buqetë me lule në kujtim të viktimave të holokaustit.








# INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA AWARDED SERGIO VIEIRA DE MELLO PRIZE

On October 25, 2018, the award ceremony of "Sergio Vieira De Mello", UN High Commissioner for Human Rights, was held in Krakow, Poland, in which the leaders of our country's religious communities were awarded this prize for "Interfaith Brotherhood in Albania".

The President of the Muslim Community of Albania, H. Skender Bruçaj, received the award on behalf of the Interreligious Council of Albania.

"Sergio Vieira De Mello" UN High Commissioner for Human Rights is an award given annually to individuals or personalities who represent causes for the good of the common society.

Afterwards, representatives of Albanian religious communities paid a visit to the infamous Auschwitz camp, where they placed flowers in memory of the victims of Holocaust.









## PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË TAKIM ME PAPA FRANÇESKUN

Drejtues të komuniteteve fetare nga Shqipëria, si dhe njëkohësisht përfaqësues të Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, sekretari i përgjithshëm i KNFSH-së dhe Komuniteti Arbëresh në Itali, me datë 19 nëntor 2018 zhvilluan një takim me Papa Françeskun në Vatikan.



## REPRESENTATIVES OF THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA MEET WITH POPE FRANCIS

Leaders of religious communities, representatives of the Presidency of the Inter-religious Council of Albania, Secretary General of IRCA and the Arberesh (Albanian) Community in Italy visited Pope Francis on November 19, 2018.



## MBLEDHJET E PRESIDENCËS SË KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË

**1.** Pas disa takimesh dhe mbledhje pune, drejtuesit më të lartë të komuniteteve fetare të Shqipërisë janë mbledhur më dt. 22.10.2018 në Selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku janë marrë disa vendime të rëndësishme, lidhur me mirëfunksionimin dhe disa ndryshime statuore të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, themeluar në vitin 2007 nga komunitetet fetare tradicionale në vend.

Në mbledhjen e zhvilluar, morën pjesë H. Skender Bruçaj, kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, Fortlumturia e tij, Anastas Janullatos, kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Mons. George Frendo, kreu i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, si dhe Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

Gjatë kësaj mbledhje, krahas ndryshimeve statuore, u morën edhe disa vendime lidhur me disa ndryshime në aspektin drejtues institucional të Këshillit Ndërfetar, institucion i cili ka në përbërjen e vet Bordin e Presidencës, Bordin Ekzekutiv dhe Sekretarin e Përgjithshëm.

Organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës së KNFSH-së është Bordi i Presidencës, i cili përbëhet nga Kryetarët e Komuniteteve fetare, pjesëmarrës të Qendrës, ndërsa

## MEETINGS OF THE PRESIDENCY OF THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA

**1.** Senior leaders of religious communities of Albania met on October 22, 2018, where important decisions were taken regarding the proper functioning of the Interreligious Council of Albania and some amendments to its statute. The Interreligious Council of Albania was established in 2007 by the country's traditional religious communities.

The meeting was attended by H. Skender Bruçaj, head of the Muslim Community of Albania, His Beatitude Anastasios Yannoulatos, Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, Monsignor George Frendo, president of the Catholic Episcopal Conference of Albania, H. Dede Edmond Brahimaj, leader of the Bektashi World Order, and Pastor Ylli Doçi, president of the Evangelical Brotherhood of Albania.

During this meeting, in addition to statutory changes, several decisions were taken with regard to some changes in the institutional governing aspect of the Interreligious Council, which is composed of the Board of Presidency, the Executive Board and the Secretary General.

The highest decision-making body of the IRCA is the Council of Presidency, which is made up of the leaders of religious communities, members of the Centre; meanwhile, the Executive Council is composed of two members from each community

Bordi Ekzekutiv përbëhet nga dy anëtarë për çdo komunitet. Në këtë mbledhje u vendos dhe rotacioni i kryetarëve, duke filluar me kreun e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturinë e tij, Anastas Janullatos, i cili u zgjodh kryetar i KNFSH-së për periudhën tetor 2018-dhjetor 2019, Sekretar i Përgjithshëm u zgjodh Dr. Genti Kruja, ndërsa financiere e KNFSH-së znj. Shelda Agaraj.

Në këtë mbledhje u vendos gjithashtu botimi i literaturave të ndryshme, ku do të pasqyrohet veprimtaria ndërfetare në Shqipëri, si dhe takimet periodike sipas statutit të KNFSH-së.

Another decision taken in this meeting was the rotation of the presidency, starting with the Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, Anastasios Yannoulatos, who was elected chairman of the IRCA for the period October 2018 to December 2019. Dr. Genti Kruja was elected Secretary General and Mrs Shelda Agaraj was elected financier of the KNFSH.

In this meeting, a decision was also made about the publication of various articles which will reflect interfaith activity in Albania and the periodic meetings according to the statute of IRCA.





**2.** Bordi i Presidencës së **Këshillit Ndërfetar t**ë Shqipërisë ka mbajtur me dt. 16.04.2019, mbledhjen e radhës dhe të parën për vitin 2019.

Në këtë mbledhje merrnin pjesë krerët e pesë komuniteteve fetare në vend, bashkëdrejtues dhe të KNFSH-së, Kryetari i Këshillit Ndërfetar, Fortlumturia e tij Anastas Janullatos, njëkohësisht dhe kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, Mons. George Frendo, kreu i Konferencës Ipeshkvnore Katolike të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, si dhe Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

Takimi ndërfetar i mbajtur në Qendrën Sinodike të Kishës Ortodokse është hapur nga Fortlumturia e tij Anastas Janullatos, i cili këtë vit ka dhe presidencën e radhës të KNFSH-së, ku ka falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë mbledhje. Ai i ka uruar mirëseardhjen të gjithë të pranishmëve dhe në veçanti kreut të ri të KMSH-së H. Bujar Spahiu, për detyrën e tij pas zgjedhjeve në KMSH, si kryetari i ri i këtij institucioni, si dhe për praninë e tij në këtë takim në cilësinë e anëtarit të Bordit të Presidencës.

Gjithashtu kreu i KNFSH-së, si dhe të gjithë krerët e komuniteteve fetare kanë vlerësuar edhe kontributin e ish-kryetarit të KMSH-së H. Skender Bruçaj në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë dhe në dialogun ndërfetar gjatë drejtimit të tij të KMSH-së.

**2.** The Board of Presidency of the Interreligious Council of Albania held its first periodic meeting for year 2019.

This meeting was attended by leaders of the five religious communities of the country, who are also co-leaders of the IRCA: the Chairperson of the Interreligious Council, His Beatitude Anastasios Yannoulatos, Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, H. Bujar Spahiu, head of the Muslim Community of Albania, Monsignor George Frendo, president of the Catholic Episcopal Conference of Albania, H. Dede Edmond Brahimaj, world leader of the Bektashi Order, and Pastor Ylli Doçi, president of the Evangelical Brotherhood of Albania.

The interfaith meeting held at the headquarters of the Orthodox Autocephalous Church was opened by His Beatitude Anastasios Yannoulatos, who holds this year's presidency of the IRCA. He thanked all the participants for their presence in the meeting. He welcomed everyone, in particular, the new head of the Muslim Community, H. Bujar Spahiu, congratulating him on the new duty as chairman of MCA, after the elections in this institution, and for his presence in the meeting in the capacity of member of the Board of Presidency.

The chairperson of IRCA and the leaders of the religious communities praised the

Më pas mbledhja ka vijuar sipas rendit të ditës, agjendë e cila është bërë e ditur nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar Dr. Genti Kruja, ku është bërë një pasqyrë e punës së KNFSH-së në 6-mujorin e fundit (tetor 2018-prill 2019), siç ishte përfundimi i procedurave zyrtare për regjistrimin e ndryshimeve statuore të KNFSH-së, regjistrimi në organet tatimore, pajisja me NIPT, hapja e llogarisë bankare në emër të Këshillit Ndërfetar, hapja e faqes web (knfsh.al) dhe në rrjetet sociale, etj..

Në vijim financierja e KNFSH-së, znj. Shelda Agaraj ka pasqyruar raportin e plotë financiar të detajuar të Këshillit Ndërfetar gjatë 6-mujorit të fundit.

Anëtarët e Bordit të Presidencës gjatë kësaj mbledhjeje kanë diskutuar për disa problematika shqetësuese për të gjithë komunitetet fetare, siç janë çështja e pronave dhe moskthimi i tyre nga shteti shqiptar, problemi i objekteve të kultit dhe materialeve arkivore të sekuestruara nga regjimi komunist dhe moskalimi i tyre te pronarët e vërtetë, komunitet fetare në Shqipëri, etj.

Në këtë takim është diskutuar edhe rreth konsultimeve, që do të zhvillohen në muajt e ardhshëm për sugjerimet dhe propozimet, që do të dërgojë KNFSH në Asamblenë e X-të Botërore të organizatës ndërkombëtare "Religions for Peace", e cila do të mbahet në gusht 2019 në Gjermani.

Bordi i Presidencës ka miratuar gjithashtu dhe themelimin e Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në KNFSH, propozuar në mbledhjen e fundit nga Bordi Ekzekutiv i KNFSH-së.

Në këtë takim merrnin pjesë gjithashtu dhe Hirësi Asti dhe z. Agron Hoxha, anëtarë të Bordit Ekzekutiv të KNFSH-së.



contribution of the former chairman of MCA, H. Skender Brucaj, to the Interreligious Council of Albania and interfaith dialogue during his leadership of MCA.

Afterwards, the meeting followed the agenda, which was announced by the Secretary General of the Interreligious Council, Dr. Genti Kruja. An overview of the work of IRCA in the last six months was made, such as completion of official procedures for the registration of the amendments to the statute, registration in tax authorities, equipment with a Tax ID number, opening a bank account in the name of the Interreligious Council, as well as opening a website (knfsh.al) and social network accounts.

Then, the IRCA financier, Mrs Shelda Agaraj, presented the Council's detailed financial statement for the last six months.

During this meeting, the members of the Council of Presidency discussed some worrying issues for all religious communities such as the issue of property and its restitution from the Albanian state, the issue of places of worship and archival material seized by the communist regime and their restitution by the Albanian state, religious communities in Albania, etc.

Another issue was the consultations that will take place in the coming months focusing on suggestions and proposals that IRCA will send to the 10th World Assembly of "Religions for Peace", which will be held in August 2019, in Germany.

The Council of Presidency also approved the establishment of the Department of Women and the Department of Youth, proposed in the last meeting by the Executive Board.

This meeting was also attended by His Grace, Bishop Asti and Mr Agron Hoxha, member of the Executive Board.



**3.** Bordi i Presidencës i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë ka mbajtur më 16.01.2020, mbledhjen e radhës dhe të parën për vitin 2020.

Në mbledhjen e zhvilluar, merrnin pjesë krerët e pesë komuniteteve fetare në vend, bashkëdrejtues dhe të KNFSH-së.

Takimi ndërfetar i mbajtur në Qendrën Sinodike të Kishës Ortodokse është hapur nga Fortlumturia e tij Anastas Janullatos, njëkohësisht dhe kreu në detyrë i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, i cili i ka falënderuar të gjithë për angazhimet e përbashkëta për gjatë vitit të kaluar, 2019. Më pas sipas dhe rotacionit të miratuar nga Bordi i Presidencës, ai ia ka dorëzuar detyrën e kreut të KNFSH-së Mons. George Frendo, njëkohësisht dhe Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, i cili do të kryesojë presidencën e KNFSH-së për gjatë vitit 2020.

**3.** The Board of Presidency of The Interreligious Council of Albania held its first meeting for year 2020 on January 16, 2020.

The meeting was attended by leaders of the five religious communities, who are also co-leaders of IRCA.

The interreligious meeting held at the Headquarters of the Orthodox Church was opened by His Beatitude, Anastasios Yannoulatos, chairperson of the Interreligious Council of Albania, who thanked the participants for their joint commitments for year 2019. Pursuant to the rotation approved by the Council of Presidency, he handed over the duties of the chairperson of IRCA to Mons. George Frendo, also president of the Catholic Episcopal Conference of Albania, who will hold the presidency of IRCA for year 2020.

Në vijim mbledhja ka vazhduar sipas rendit të ditës, agjendë e cila është bërë e ditur nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar Dr. Genti Kruja, i cili ka paraqitur raportin një vjeçar të KNFSH-së. Ndër të tjera ai përmendi se, viti 2019 ka shënuar një periudhë me angazhime të shumta.

Kështu në vitin 2019 u nënshkruan dy marrëveshje të rëndësishme, e para me organizatën ndërkombëtare "Religions for Peace", ku falë kësaj marrëveshje Këshilli Ndërfetar ka qenë pjesë e disa takimeve dhe konferencave ndërkombëtare në Gjermani, Belgjikë, Poloni dhe SHBA. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi u mundësua edhe financimi i një projekti, me anë të cilit, u organizuan për herë të parë Konsultat Kombëtare të Këshillit Ndërfetar më 20 dhe 27 qershor 2019, nga të cilat dolën disa rekomandime të rëndësishme, që u dërguan në Asamblenë e X-të Botërore të RfP-së, zhvilluar në gusht të 2019 në Gjermani, ku KNFSH ishte pjesëmarrëse me delegatët e vet.

Një marrëveshje tjetër e lidhur me KNFSH, ishte edhe ajo me CVE, zyrë pranë Kryeministrisë, e cila është e angazhuar me luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm me të cilën janë zhvilluar edhe disa seminare dhe trajnime në këtë fushë.

Një prej vendimeve më të rëndësishme të marra nga Këshilli i Presidencës për gjatë vitit 2019, ka qenë edhe vendimi për themelimin e Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë.

Një tjetër fushë aktiviteti, ka qenë edhe ndjeshmëria e KNFSH-së ndaj situatave delikate në vend, duke dalë me disa deklarata për shtyp.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar gjithashtu dy mbledhje të Këshillit të Presidencës, tre mbledhje të Këshillit Ekzekutiv dhe një mbledhje e Departamentit të Gruas dhe një me Departamentin e Rinisë.

Në vijim të mbledhjes financierja e KNFSH-së, znj. Shelda Agaraj ka pasqyruar raportin e plotë financiar të detajuar të Këshillit Ndërfetar për 8-mujorin e fundit.

Anëtarët e Këshillit të Presidencës gjatë kësaj mbledhjeje kanë diskutuar edhe për disa çështje të rëndësishme lidhur me angazhimet e KNFSH-së në vazhdimësi, si dhe disa ndryshime në statut, përsa i përket mundësisë së botimeve nga ana e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

Then, the meeting followed the agenda, which was announced by the Secretary General of the Interreligious Council, Dr. Genti Kruja, who presented the one-year report of IRCA. Among others, he mentioned that year 2019 marked a period with many commitments.

In 2019, two important agreements were signed. The first one was with the international organisation "Religions for Peace", thanks to which, the Interreligious Council of Albania participated in several international meetings and conferences in Germany, Belgium, Poland and the USA. This cooperation enabled funding of a project, through which the first National Consultations of the Interreligious Council were organised on June 20 and 27, 2019. They came up with some important recommendations which were sent to the 10th World Assembly of "Religions for Peace", held in Germany in August 2019, in which IRCA participated with its delegates.

Another agreement was the one reached with the Coordination Centre for Countering Violent Extremism (CVE), at the Prime Minister's Office, which is engaged in the fight against radicalization and violent extremism. Several seminars and trainings in the area have been organised in cooperation with CVE.

One of the most important decisions taken in year 2019 by the Council of Presidency was the decision to establish the Department of Women and the Department of Youth.

Another area of activity was the sensitivity of IRCA to delicate issues at home, coming up with press releases.

In 2019, two meetings of the Council of Presidency, three meetings of the Executive Board, one meeting of the Department of Women and one meeting of the Department of Youth were convened.

Then, the financer of IRCA, Mrs Shelda Agaraj, presented the detailed financial statement for the last eight months.

During the meeting, the members of the Council of Presidency also discussed several important issues related to the ongoing engagements of IRCA as well as some amendments to the statute regarding publication opportunities by the Interreligious Council of Albania.



## MBLEDHJET E BORDIT EKZEKUTIV TË KNFSH-SË

**1.** Pas konsolidimit dhe riorganizimit të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, është zhvilluar me dt. 27 dhjetor 2018 në ambientet e Selisë së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, mbledhja e parë e Këshillit të ri Ekzekutiv të KNFSH-së.

Në mbledhjen e drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm Dr. Genti Kruja, anëtarët e Këshillit, përfaqësues të komuniteteve fetare në vend janë njohur me zhvillimet e fundit, lidhur me procedurat zyrtare të regjistrimit të ndryshimeve statuore në gjykatë, si dhe kanë diskutuar rreth aktiviteteve të mundshme, që do të zhvillohen gjatë vitit 2019.

**2.** Me dt. 3 prill 2019 është zhvilluar mbledhja e radhës e Bordit Ekzekutiv të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, në ambientet e Universitetit Bedër.

Në mbledhjen e drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm Dr. Genti Kruja, anëtarët e bordit, përfaqësues të komuniteteve fetare në vend janë njohur me zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale të KNFSH-së, si dhe veprimtarinë e zhvilluar gjatë tremujorit të parë të vitit 2019.

Në rendin e ditës së këtij takimi janë bërë disa propozime lidhur me rritjen e aktivizimit të disa sektorëve të rinj në KNFSH, të cilat do t'i përcillen për miratim Bordit të Presidencës në mbledhjen e radhës, që do të zhvillohet ne ditët në vijim.

Një pikë e rëndësishme diskutimi ka qenë dhe hapja e konsultimeve lidhur me pikat që do të fliten në Asamblenë e X-të Botërore të organizatës "Fetë për Paqen" (Religions for Peace), ku do të marrë pjesë edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, anëtar me të drejta të plota në RfP me të drejtë gjithashtu vote, ku do të paraqesë edhe sugjerimet e veta në takimin botëror, i cili do të mbahet në Lindau të Gjermanisë në gusht të 2019.

## MEETINGS OF THE EXECUTIVE BOARD OF IRCA

**1.** After the consolidation and reorganisation of the Interreligious Council of Albania, the first meeting of the Executive Board of IRCA was held on December 27, 2018, at the headquarters of the Orthodox Autocephalous Church of Albania.

The meeting was chaired by the Secretary General, Dr. Genti Kruja, and the board members, representatives of the religious communities in the country, were acquainted with the latest developments regarding the official procedures for registering the statutory amendments in District Court. Possible activities to be organised in 2019 were also discussed.

**2.** The next meeting of the Executive Board of the Interreligious Council of Albania was held on April 3, 2019, at the premises of University College Beder.

In the meeting chaired by the Secretary General, Dr. Genti Kruja, the board members, representatives of the religious communities in the country, were acquainted with the latest developments and the current situation of IRCA as well as the activities organised in the first quarter of 2019.

In the meeting, several suggestions were made regarding increase in the engagement of new IRCA sectors, which will be proposed for approval by the Council of Presidency in the next meeting to be organised in the following days.

An important item of discussion was the start of consultations regarding the items to be discussed in the 10th World Assembly of "Religions for Peace", in which the Interreligious Council of Albania will participate as a full and voting member of "Religions for Peace", and will present its suggestions in this worldwide meeting which will be held in Lindau, Germany, in August 2019.

**3.** Me dt. 5 dhjetor 2019 është zhvilluar mbledhja e radhës e Bordit Ekzekutiv të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, në ambientet e Qendrës Sinodike të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Viti 2019 shënon për KNFSH një vit me angazhime, organizime dhe pjesëmarrje në konferenca të ndryshme ndërkombëtare të zhvilluara në vend dhe jashtë Shqipërisë.

Gjatë këtij viti janë themeluar gjithashtu dy departamente të reja në KNFSH, Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë, të cilët janë përfaqësuar edhe në takimet ndërkombëtare të zhvilluara në Poloni dhe Gjermani.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ka zhvilluar gjithashtu në qershor të këtij viti dhe Konsultimet e Para Kombëtare të të gjitha instancave të tij, Bordit të Presidencës, Bordit Ekzekutiv, Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë.

Rekomandimet e këtyre konsultimeve janë dërguar më pas në Asamblenë e X-të Botërore të Organizatës Ndërkombëtare "Fetë për Paqen" (Religions for Peace), zhvilluar në Lindau të Gjermanisë në gusht të 2019. Në këtë asamble kreu i KNFSH-së dhe njëkohësisht kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë Prof. Dr. Anastas Janullatos është rizgjedhur si President Nderi i "Religions for Peace".

Anëtarët e Bordit Ekzekutiv kanë folur gjithashtu dhe për kontributin, që po japin të gjitha komunitetet fetare në vend në fushatat e ndihmave për të prekurit nga tërmeti i nëntorit 2019, që preku vendin tonë.

**3.** The next meeting of the Executive Board of the Interreligious Council of Albania was held at the headquarters of the Holy Synod of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, on December 5, 2019.

Year 2019 marks a period full of engagements, organisations and participation in various international conferences held in Albania and abroad.

During this year, two new departments were established, the Department of Women and the Department of Youth, which participated in the international meetings organised in Poland and Germany.

In June this year, the Interreligious Council of Albania also organised the first consultations with all its bodies, the Council of Presidency, the Executive board, the Department of Women and the Department of Youth.

Recommendations coming out of these consultations were then sent to the 10$^{th}$ World Assembly of "Religions for Peace", held in Lindau, Germany, in August 2019. The chairperson of IRCA, also head of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, Prof Anastasios Yannoulatos, was re-elected Honorary President of "Religions for Peace".

The Executive Board members also talked about the contribution that all religious communities in the country are making to the relief campaigns for those affected by the November 2019 earthquake that hit our country.

## MBLIDHET ONLINE BORDI EKZEKUTIV I KNFSH-SË

**4.** Bordi Ekzekutiv i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë zhvilloi me dt. 1 prill 2020 një mbledhje online në lidhje me situatën e krijuar për shkak të përhapjes së virusit Covid 19 në vendin tonë.

Anëtarët e Bordit Ekzekutiv diskutuan dhe folën rreth disa projekt-ideve, që mund të implementohen në bashkëpunim dhe me institucione ndërkombëtare me të cilat KNFSH është partnere, për të dhënë kontributin e tyre në fushën humanitare dhe sociale.

Ndërkohë komunitetet fetare vazhdojnë të jenë pranë njerëzve dhe familjeve në nevojë në këtë situatë të vështirë sociale dhe ekonomike, që po kalon shoqëria jonë.

## ONLINE MEETING OF THE EXECUTIVE BOARD OF IRCA

**4.** The Executive Board of the Interreligious Council of Albania convened an online meeting about the situation created due to the spread of Covid 19 in our country.

The members of the Executive Board also discussed some project ideas that can be implemented in cooperation with partner international organisations, in order to ensure their contribution to humanitarian and social areas.

Meanwhile, religious communities continue to stay close to people and families in need in this socially and economically difficult situation our society is going through.





## MBLIDHET BORDI EKZEKUTIV I KNFSH-SË

**5.** Me dt. 23.09.2020 është zhvilluar mbledhja e radhës e Bordit Ekzekutiv të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë. Mbledhja e mbajtur në ambjentet e Arqipeshkvisë Tiranë-Durrës është hapur nga Sekretari i Përgjithshëm i KNFSH-së Dr. Genti Kruja, i cili ka bërë një pasqyrë të aktiviteteve të zhvilluara gjatë këtij viti, ku edhe pse në kushte pandemie dhe një periudhe disa mujore karantinimi KNFSH ka qenë aktiv me takime fizike dhe online të instancave të tij, duke zhvilluar disa projekte humanitare dhe sociale, të ideuara dhe realizuara nga vetë Këshilli Ndërfetar, nëpërmjet Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë me mbështetjen e të gjithë komuniteteve fetare dhe drejtuesve të tyre.

Më pas anëtarët e Bordit Ekzekutiv kanë diskutuar rreth vitit jubile të 30 vjetorit të lirisë së besimit, kur u rihapën objektet e kultit pas mbylljes nga regjimi komunist, ngjarje e cila përkon me nëntorin e këtij viti, ku Këshilli Ndërfetar do të ndërmarrë disa nisma për përkujtimin e këtyre ditëve nëpërmjet organizimit të disa eventeve.

Pas diskutimeve dhe konsultimeve të zhvilluara, mbledhja është përshëndetur dhe nga Kryetari i Këshillit Ndërfetar Mons. George Frendo, njëkohësisht dhe President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, i cili ka vlerësuar punën dhe iniciativat e ndërmarrë nga anëtarët e bordeve të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

## MEETING OF IRCA EXECUTIVE BOARD

**5.** Today, September 23, 2020, was the next meeting of the Executive Board of the Interreligious Council of Albania. The meeting was held at the premises of the Archdiocese of Tirana-Durrës, the meeting was opened by the Secretary General of IRCA, Dr. Genti Kruja, who made a summary of the activities developed during this year, where although in pandemic conditions and a period of several months quarantine IRCA has been active with physical and online meetings of its instances, developing several humanitarian and social projects, conceived and implemented by the Interreligious Council itself, through the Department of Women and the Department of Youth with the support of all religious communities and their leaders.

The members of the Executive Board then discussed about the jubilee year of the 30-th anniversary of freedom of religion, when the cult objects were reopened after the closure by the communist regime, an event which coincides in November this year, where the Interreligious Council will hold several initiatives for commemorate these days through the organization of several events.

After discussions and consultations, the meeting was welcomed by the Chairman of Interreligious Council Mons. George Frendo, at the same time President of the Episcopal Conference of Albania, who appreciated the work and initiatives undertaken by the members of the boards of the Interreligious Council of Albania.



# ZHVILLOHEN KONSULTIMET KOMBËTARE TË DEPARTAMENTIT TË GRUAS DHE DEPARTAMENTIT TË RINISË TË KNFSH-SË

Në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrjen e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë në Asamblenë e X-të Botërore të "Religions for Peace", që do të mbahet në Lindau të Gjermanisë në gusht të këtij viti, janë mbajtur sot në Tiranë, më 20 qershor, konsultimet kombëtare të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë të KNFSH-së.

Në mbledhjen e fundit të Bordit të Presidencës mbajtur në prill 2019 u mor vendimi edhe për themelimin e Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, përfaqësuesit e të cilëve u mblodhën sot në takimin e tyre të parë në një nga sallat e Hotel Plaza në Tiranë.

Pas prezantimit të tyre në emër të pesë komuniteteve fetare, bashkërendues të KNFSH-së, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë Dr. Genti Kruja, ka folur rreth temës së bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri dhe më pas në një seancë plenare ka prezantuar temat e Asamblesë së X-të Botërore të "Religions for Peace" dhe historikun e saj 50 vjeçar, si organizata më e madhe botërore në fushën e paqes dhe dialogut, akredituar nga OKB.

Në seancën e dytë plenare znj. Sheldiana Jano, anëtare e Bordit Ekzekutiv të KNFSH-së ka shpjeguar pesë temat, që do të diskutohen në Asamble dhe më pas përfaqësuesit e Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë, gjatë një workshopi të ndarë në pesë grupe me përfaqësues nga komunitete të ndryshme fetare, kanë diskutuar rreth këtyre temave, duke nxjerrë disa rekomandime dhe sugjerime të rëndësishme, të cilat do të dërgohen në asamble në emër të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

# NATIONAL CONSULTATIONS OF THE IRCA DEPARTMENT OF WOMEN AND DEPARTMENT OF YOUTH

In the framework of preparations for the Interreligious Council of Albania's participation in the 10th World Assembly of "Religions for Peace", which will be held in Lindau Germany, in August this year, national consultations of the Department of Women and the Department of Youth were held in Tirana, on June 20.

In the last meeting of the Council of Presidency, a decision was taken for the establishment of the Department of Women and the Department of Youth, the representatives of which held today their first meeting in one of the halls of Hotel Plaza in Tirana.

After presentation on behalf of the five religious communities, the Secretary General of the Interreligious Council of Albania talked about interfaith coexistence in Albania and then, in a plenary session he presented the topics of the 10th World Assembly of "Religions for Peace" and its 50-year-old history, as the largest international organisation in the field of peace and dialogue, accredited by the UN.

In the second plenary session, Mrs Sheldiana Jano, member of the Executive Board of IRCA, explained the topics that will be discussed in the Assembly. Afterwards, the representatives of the Department of Women and the Department of Youth worked divided into five groups with representatives from various religious communities, coming up with important recommendations and suggestions, which will be sent to the Assembly on behalf of the Interreligious Council of Albania.








## ZHVILLOHEN KONSULTIMET KOMBËTARE TË KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË

Për herë të parë në historinë e vendit tonë, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ka zhvilluar Konsultimet Kombëtare të të gjitha instancave dhe organeve të saj, duke dalë me disa rekomandime të rëndësishme.

Kështu në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrjen e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë në Asamblenë e X-të Botërore të "Religions for Peace", që do të mbahet në Lindau të Gjermanisë në gusht 2019, janë mbajtur në Tiranë, në datat 20 dhe 27 qershor 2019, konsultimet kombëtare të Bordit të Presidencës, Bordit Ekzekutiv, Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë të KNFSH-së.

Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë janë themeluar rishtazi në mbledhjen e fundit të Këshillit të Presidencës mbajtur në prill 2019, përfaqësuesit e të cilëve janë mbledhur për herë të parë me 20 qershor, duke dhënë ide dhe propozime me mjaft vlerë për vendin tonë dhe më gjerë.

Ndërsa në takimin e datës 27 qershor 2019 janë mbledhur për herë të parë të gjithë

## NATIONAL CONSULTATIONS OF THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA

For the first time in the history of our country, the Interreligious Council of Albania held National consultations with all its bodies coming up with important recommendations.

Thus, in the framework of preparations for the participation of the Interreligious Council of Albania in the 10th World Assembly of "Religions for Peace", which will be held in Lindau, Germany, in August 2019, national consultations of the Council of Presidency, the Executive Board, the Department of Women and the Department of Youth were held in Tirana, on June 20 and 27.

The Department of Women and the Department of Youth were established recently, in the last meeting of the Council of Presidency held in April 2019. Their representatives met for the first time on June 20, coming up with valuable ideas and proposals for our country and beyond.

In the June 27, 2019 meeting, all the IRCA boards and departments met for the first time and the rapporteurs of the working groups, who had been working in plenary ses-





bordet dhe departamentet e KNFSH-së, ku relatorët e grupeve të punës, të cilët kanë punuar gjatë dy ditëve në disa seanca plenare dhe workshope, kanë referuar dhe lexuar rekomandimet dhe sugjerimet e dala gjatë takimeve të 20 dhe 27 qershorit.

Në seancën e fundit, moderuar nga Dr. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, kanë folur dhe krerët e komuniteteve fetare, njëkohësisht dhe anëtarë të Këshillit të Presidencës, ku fillimisht fjalën e mori Kryetari i KNFSH-së Prof. Dr. Anastasi, e më pas kanë përshëndetur edhe liderët e tjerë, të cilët kanë vënë theksin në rëndësinë e dialogut ndërfetar, por edhe frymës së dialogut në përgjithësi në këto ditë, ku ka kaq shumë nevojë për modelin e dialogut, si një vlerë e munguar në arenën politike në dobi të paqes sociale.

Rekomandimet dhe sugjerimet e nxjerra gjatë këtyre takimeve të KNFSH-së, do të dërgohen në Asamblenë e X-të Botërore të RfP-së në emër të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë nga një delegacion i këtij institucioni, i cili përfaqësohet dhe me delegatët e vet në asamblenë më të madhe botërore të paqes.

sions and workshops for two days, presented the recommendations and suggestions made in the June 20 and 27 meetings.

Heads of the religious communities, members of the Council of Presidency, addressed the meeting in the last session, which was moderated by Dr. Genti Kruja, Secretary General of the Interreligious Council of Albania. The first to address the meeting was the chairperson of IRCA, Prof Anastasios, to be then followed by the other leaders, who emphasized the importance of interfaith dialogue and the spirit of dialogue in general, pointing out the great need for a model of dialogue, as a missing value in the political arena to the benefit of social peace.

Recommendations and suggestions proposed in these meetings of IRCA will be sent to the 10th World Assembly of "Religions for Peace" on behalf of the Interreligious Council of Albania, which will be represented in the world's largest peace assembly by its delegates.

## REKOMANDIMET E KONSULTIMEVE KOMBËTARE

Inkurajohen komunitetet fetare, që klerikët gjatë predikimeve të jenë të qendërzuar dhe me kahje nga dialogu, toleranca, bashkëjetesa, harmonia, koncepti i paqes, siç fetë e parashikojnë.

Të nxiten udhëheqësit fetarë, shoqëria civile dhe organet shtetërore të organizojnë simpoziume, botime, dalje mediatike, evidentime në mediat sociale të referimit ndaj rasteve të suksesit në parandalimin a ndërmjetësimin e zgjidhjes së konflikteve, me rol edukues e informativ, duke promovuar vlerat morale, fetare si elementë parandalues e transformues të konfliktit, ende pa ndodhur ai, ose pa ezauruar sjelljen e pasojave.

Rekomandohet mbështetja buxhetore a dhënia e granteve nga shteti ndaj institucioneve të tilla si Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, Komiteti Shtetëror për Kultet dhe rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të tyre.

Stimulohen organet legjislative të plotësojnë kuadrin ligjor kundër konflikteve, si dhe organet politikëbërëse të hartojnë dokumente strategjike në terma afatgjatë për parandalimin ose transformimin e konflikteve.

Të adresohet prioriteti tek shoqëria civile për organizimin e trajnimeve, që lidhen me njohjen e rasteve potenciale për konflikt a mënyrat e ndërmjetësimit, organizimin e fushatave ndërgjegjësuese, hartimin e programeve alternative të edukimit pro paqe dhe kundër konfliktit, kryerjen e anketimeve, analizave të të dhënave dhe raportimeve për moslidhjen fe - konflikt, organizimin e aktiviteteve ndërkulturore e ndërfetare për pranimin e konceptit të ekzistencës së tjetrit me karakteristikat e veta, si hap kyç në parandalimin e konfliktit.

Të stimulohet aktivizimi online për dialogun dhe paqen, si elementë suksesi të harmonisë fetare shqiptare dhe si modele për parandalimin a transformimin e konflikteve.

Të inkurajohen organet shtetërore për angazhimin e të rinjve kryesisht në kurse profesionale, punë sezonale, vende të lira pune, rritjen e nivelit të detyrueshëm arsimor në atë të mesëm dhe vendosjen e kurrikulës së edukimit fetar me zgjedhje, që në klasat e hershme.

- Komunitetet fetare duhet të kenë një zë të përbashkët kur dënojnë korrupsionin, për më tepër ato duhet të jenë sa më pranë shoqërisë në shumë aspekte.

## RECOMMENDATIONS OF NATIONAL CONSULTATIONS

Clerics of religious communities should be encouraged to focus on and be guided by dialogue, tolerance, coexistence, the concept of peace and harmony as religions provide.

Religious leaders, civic society organisations and state institutions are encouraged to organize symposia and press statements, to publish, as well as to identify social media reports on success stories in conflict prevention and conflict resolution, promoting moral and religious values as preventive and transformational elements of conflict.

It is recommended that the state provide budget support and grants to institutions such as the Interreligious Council of Albania and the State Committee on Cults and increase their human resource capacities.

Legislative bodies should be stimulated to complete the legal framework on conflict and decision-making bodies should be stimulated to draft long-term strategic documents on prevention or transformation of conflict.

Civic society's priority should be organisation of trainings related to recognition of potential conflict and mediation cases, organization of awareness-raising campaigns, drafting of alternative pro-peace and against-conflict education programs, conduct of surveys, data analysis and reporting on the misconceived relationship between religion and conflict, as well as organization of intercultural and interreligious activities on the acceptance of the existence of the other with his/her characteristics, as key steps in conflict prevention.

Stimulation of online activism for dialogue and peace as elements of success of Albanian religious harmony, and as models for the prevention and transformation of conflicts.

State bodies should be encouraged to engage young people mainly in vocational trainings, seasonal jobs, vacant positions, to extend compulsory education to 12 years, and to establish elective religious curriculum in the elementary school education.

- Religious communities should have a common voice when they condemn corruption. Moreover, they should be closer to the society in many aspects.

• Komunitetet nuk duhet të jenë pjesë e politikës por edhe politika, si pjesë e shoqërisë duhet të marrë vazhdimisht këshilla nga besimet fetare.

• Komunitetet fetare duhet të ruajnë dinjitetin dhe pavarësinë. Është e vetmja mënyrë, që të krijojnë siguri në komunitetin, që operojnë dhe kështu t'i përçojnë komunitetit vlera të pacenuara.

• Popullsia e Shqipërisë në 1 janar 2019, rezulton 2.862.427 banorë, duke pësuar një rënie me 0,3%, krahasuar me 1 janar 2018. Kjo do të thotë që shqiptarët nuk e shikojnë vendin e tyre, si zgjidhje për jetën. Besimet fetare mund të luajnë një rol kyç në rritjen e shpresës dhe besimit tek banorët e vendit. Kjo do të kërkonte investime serioze në fushat e formimit profesional por jo vetëm. Besimet fetare mund të japin kontributin e tyre, duke theksuar dashurinë për Zotin dhe vendin (fenë dhe atdheun).

• Vendi jonë është i bekuar që ka një harmoni fetare për t'u marrë shembull. Komunitetet fetare duhet të marrin në konsideratë brishtësinë e kësaj harmonie.

• Komunitetet fetare për hir të ruajtjes së harmonisë, duhet të krijojnë grupe të përbashkëta dhe të përçojnë këtë harmoni në shkolla.

• Ruajtja e mjedisit dhe ndërgjegjësimi i çdo qytetari për mbrojtjen e tij.

• Krijimi i rrjeteve sociale, i website-ve ose forma të tjera marketingu, ku të promovohen vlerat e përbashkëta morale ndërfetare.

• Përfshirja në media televizive ose të shkruar të rubrikave ndërfetare me tematika paqeje dhe dashurie midis popujve me kultura, tradita, besime, etni të ndryshme. Udhëheqësit fetarë dhe mënyra e drejtimit të tyre janë vërtet vendimtarë për stabilitetin e paqes botërore. Gjithashtu i duhet kushtuar rëndësi e veçantë interpretimeve të ligjeve fetare në frymën për të cilën kanë zbritur dhe të mos lejohet keqpërdorimi tyre. Interpretimi nuk duhet shkëputur nga konteksti dhe nuk mund të dalë jashtë parimeve bazë fetare, siç janë paqja, dashuria, mirësia.

• Krijimi i institucioneve ndërkombëtare ndërfetare në unifikimin dhe shkëmbimin e vlerave dhe parimeve të përbashkëta, për një botë më të mirë, që i shërben të ardhmes të sigurt.

• Shembulli shqiptar i bashkëjetesës duhet reklamuar edhe më shpesh ndërkombëtarisht, si dhe duhet shkëmbim i vlerave më të mira midis shteteve, duke u marrë shembujt më të mirë.

• Botime rreth këtyre vlerave dhe parimeve të përbashkëta, si libra, broshura etj. sepse gjërat që na bashkojnë janë më të forta se ato që na ndajnë!

• Mbështetje më e lartë ekonomike e qeverisë ndaj komuniteteve fetare, rregullimi i statusit ligjor të komuniteteve, kthimi i pronave, etj., në mënyrë që komunitetet të jenë më të konsoliduar dhe të pavarur financiarisht në përmbushjen e detyrës së tyre.

• Religious communities should not be part of politics, but politics, as part of the society, should constantly receive advice from religious leaders.

• Religious communities should preserve their dignity and independence. This is the only way to create security in the community they operate and thus, to convey their pristine values to their community.

• On January 1, 2019, the population of Albania was estimated to be 2.862.427 with a decrease of 0.3%, compared to January 1, 2018. This shows that Albanians do not consider their country a choice for their life. Religious communities can play a key role in raising hopes and trust in the local people. This would require serious investments in vocational training but not only. Religious communities can contribute by emphasizing love for God and the country (religion and homeland).

• Our country is blessed to have a religious harmony which is an example to be followed. However, religious communities should also consider the fragility of this harmony.

• For the sake of sustaining this harmony, religious communities should create joint groups and convey this harmony to schools.

• Preserving the environment and raising citizens' awareness of its protection.

• Creating social networks, websites or other marketing forms, which promote shared interfaith and moral values.

• Involvement in the visual and print media of interfaith rubrics with themes of peace and love among peoples of different cultures, traditions, beliefs, and ethnicities. Religious leaders and the way they lead are truly crucial to the stability of world peace. Particular attention should also be paid to the interpretation of religious laws in the spirit for which they were revealed; their misuse should not be allowed. Interpretation should not be detached from context and should not go beyond basic religious principles, such as peace, love and kindness.

• Establishment of international interreligious organisations for the unification and exchange of shared values and principles, for a better world that serves a secure future.

• The Albanian example of coexistence should be promoted worldwide; there should be an exchange of the best values between countries taking the best examples.

• Publications promoting these common values and principles, such as books, brochures, etc., because the things that unites us are stronger than the things that divide us!

• More governmental economic support for religious communities, regulation of the legal status of religious communities, restitution of their property, etc., so that religious communities are financially more consolidated and independent in performing their duties.





## ZHVILLOHEN KONSULTIMET E II KOMBËTARE TË DEPARTAMENTIT TË GRUAS DHE DEPARTAMENTIT TË RINISË NË KNFSH

Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë kanë zhvilluar më 12 shkurt 2020, Konsultimet e II Kombëtare.

Gjatë këtij takimi morën pjesë përfaqësuesit e pesë komuniteteve fetare në vendin tonë, anëtarë të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë.

Mbledhja ka trajtuar disa tema të rëndësishme, siç është përfshirja aktive e gruas dhe rinisë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare për të shpalosur më shumë vlerat e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri dhe për ta përçuar edhe jashtë saj, si një model të veçantë.

Anëtarët e dy departamenteve të reja të themeluar në 2019 kanë diskutuar dhe hedhur disa ide konkrete për organizime dhe aktivitete të ndryshme ndërfetare, që mund të realizohen gjatë vitit 2020.

Ky tubim vjen pas zhvillimit të Konsultimeve të I Kombëtare, të cilat u mbajtën qershorin e vitit 2019, ku gjatë një workshopi grupet e punës të të dy departamenteve kanë dalë me disa rekomandime të rëndësishme, të cilat më pas u dërguan në Asamblenë e X Botërore të "Religions for Peace", mbajtur në Gjermani gjatë gushtit të 2019.

## NATIONAL CONSULTATIONS OF THE DEPARTMENT OF WOMEN AND THE DEPARTMENT OF YOUTH OF IRCA

The Department of Women and the department of Youth of IRCA held the second National Consultations on February 12, 2020.

The meeting was attended by representatives of the five religious communities in the country, members of the Department of Women and the Department of Youth.

Several important issues were addressed in the meeting, such as the active involvement of women and youth in national and international activities to further unfold the values of interfaith harmony and coexistence in Albania, and to convey them to other countries, as a special model.

Members of the two departments, established in 2019, discussed and came up with concrete ideas for various interfaith activities which can be organised in 2020.

This gathering follows the first National Consultations held in June 2019, where the working groups of both departments came up with important recommendations, which were then sent to the 10th World Assembly of "Religions for Peace", held in Germany in August 2019.



## PRESIDENTI META TAKIM ME KËSHILLIN NDËRFETAR TË SHQIPËRISË: SITUATA PAS TËRMETIT…

Presidenti Ilir Meta ka zhvilluar me dt. 17 dhjetor 2019 një takim me Bordin e Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë. Gjatë këtij takimi, Presidenti i ka kërkuar krerëve të komuniteteve fetare që të verifikojnë të gjitha objektet e kultit pas tërmetit të 26 nëntorit, për të parrë nëse kanë dëmtime.

Presidenti Meta i ka falënderuar drejtuesit e bashkësive fetare për reagimin e tyre të menjëhershëm, duke u gjendur pranë njerëzve në këto momente të vështira dhe ka vlerësuar gjithashtu mbështetjen e tyre të pazëvendësueshme shpirtërore, morale dhe psikologjike.

*"Roli juaj për rimëkëmbjen shpirtërore, rikthimin e shpresës, forcimin e solidaritetit e kurajës në kapërcimin e momenteve më të vështira që ka kaluar dhe kalon populli ynë është shumë i vyer"*, tha Meta.

Ndërsa Kryetarët e bashkësive fetare theksuan se: *"Situata tragjike dhe kjo krizë e rëndë humanitare për të gjithë shoqërinë tonë, duhet të shërbejë si një moment jo vetëm reflektimi por edhe pajtimi për të qëndruar së bashku në ndërtimin e një të ardhme me paqe, shpresë e dashuri, si një fillim i ri që vendi të ringrihet, jo vetëm materialisht, por edhe shpirtërisht dhe psikologjikisht"*.

## PRESIDENT META MEETS WITH THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA: THE EARTHQUAKE AFTERMATH…

President Ilir Meta held a meeting with the Board of Presidency of the Interreligious Council of Albania on December 17, 2019. During the meeting, the President asked the leaders of religious communities to identify the cult buildings damaged in the November 26 earthquake.

President Meta thanked the leaders of religious communities for their immediate response helping people in these difficult moments and appreciated their irreplaceable spiritual, moral and psychological support.

*"Your role in the spiritual recovery, return of hope, strengthening or solidarity and courage in overcoming the most difficult moments our people has been and is going through is very valuable"*, Meta said.

Leaders of religious communities pointed out: *"The tragic situation and this deep humanitarian crisis for our entire society should serve as a moment of reflection and of reconciliation, a moment of staying together in building a future of peace, hope and love, and as a new beginning for the country to be rebuilt not only materially but also spiritually and psychologically."*

# KNFSH ZHVILLON NJË AKTIVITET SOCIAL DHE KULTUROR ME FËMIJËT JETIMË TË ZONËS SË TËRMETIT

Në kuadër të 10 vjetorit të Javës Botërore të Harmonisë Ndërfetare, Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë kanë organizuar më 22 shkurt 2020, një aktivitet socio-kulturor me fëmijët jetimë të një prej zonave kryesore të prekura nga tërmeti i nëntorit 2019 në Shqipëri. Gjatë asaj periudhe mijëra njerëz u prekën ekonomikisht dhe psikologjikisht nga shkatërrimi, që solli tërmeti, ku ata më të prekurit ishin fëmijët jetimë të një prej zonave, e cila kishte nevojë jo vetëm për mbështetje ekonomike, por edhe sociale dhe psikologjike, siç është zona e rrethit të Kurbinit.

Në këtë drejtim, gratë dhe të rinjtë myslimanë dhe të krishterë morën iniciativën për të organizuar një aktivitet social dhe kulturor, ku përveç veprimtarisë festive, fëmijëve iu është shpërndarë dhe libra, dhurata, si dhe një drekë së bashku me drejtues dhe përfaqësues të komuniteteve fetare në Shqipëri.

Ky është aktiviteti i parë në llojin e tij, ku përmes Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, i cili bashkë-kryesohet nga pesë komunitete të ndryshme fetare, të bëhen bashkë të rinj e të reja të të gjitha besimeve, aktivistë të KNFSH-së në një bashkëpunim të tillë ndërfetar, i cili do të vazhdojë të gjejë zbatim në aktivitete të tjera sociale dhe humanitare për fëmijët jetimë.

# IRCA ORGANIZES A SOCIAL AND CULTURAL ACTIVITY WITH ORPHANED CHILDREN IN EARTHQUAKE HIT AREAS

In the framework of the 10th anniversary of the World Interfaith Harmony Week, on February 22, 2020, the Department of Women and the Department of Youth of the Interreligious Council of Albania organised a socio-cultural activity with orphaned children in one of the most affected areas by the November 2019 earthquake that hit Albania. During this period, thousands of people were economically and psychologically affected by the devastation caused by the earthquake, the most affected being orphaned children in Kurbin, an area which needed not only economic but also social and psychological support.

Muslim and Christian young men and women took the initiative to organise a social and cultural event, where in addition to entertaining activities, books, gifts, and lunch were given to the children along with leaders and representatives of Albanian religious communities.

This activity was the first of its kind, which, through the Interreligious Council of Albania, co-chaired by five different religious communities, brought together young men and women of all faiths, activists of IRCA, in such an interfaith organisation, and it will be followed by other social and humanitarian activities for orphaned children.










## MYSLIMANË E TË KRISHTERË LUTJE, AGJËRIM DHE BAMIRËSI DREJTUAR ZOTIT

Komiteti i Lartë i Vëllazërisë Njerëzore (Higher Committee of Human Fraternity), themeluar pas takimit historik të Papa Franceskut me Imamin e Madh, Shejhun e Ez'herit Prof. Dr. Ahmed el Tajjib, të cilët u takuan para një viti në Abu Dhabi me dt. 4 shkurt 2019 për të firmosur Dokumentin mbi Vëllazërinë Njerëzore, i ka propozuar Papa Françeskut, që besimet e ndryshme, më 14 maj, të bashkohen shpirtërisht në një ditë lutjeje, agjërimi, dhe veprave bamirësie, që Zoti ta ndihmojë shoqërinë njerëzore për të kapërcyer pandeminë e koronavirusit.

Papa Françesku dhe Shejhu i Ez'herit Prof. Dr. Ahmed el Tajjib e kanë pranuar me gëzim këtë propozim të këtij komiteti, i cili përfaqëson besimin e Krishterë, Islam dhe Hebre.

Nisur nga ky propozim, kësaj thirrjeje i është bashkangjitur edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, i cili nxiti dhe i bëri thirrje të gjithë besimtarëve myslimanë, të krishterë, e të tjerë në Shqipëri, që me dt. 14 maj t'i drejtoheshin Zotit me lutje, agjërim dhe vepra bamirësie, që Ai, Zoti Krijues, të bekojë, shpëtojë dhe mbrojë popujt e Tij dhe të kthejë me mëshirë shikimin e Tij drejt nesh në këto kohë sprove.

Organizata e Kombeve të Bashkuara ishte e para, qe e mirëpriti dhe iu bashkëngjit kësaj fushate, ndërkohë i janë bashkangjitur dhe dhjetëra shtete e institucione ndërkombëtare, si dhe presidentë e qeveri të shteteve të ndryshme të botës.

## MUSLIMS AND CHRISTIANS PRAY, FAST AND DO CHARITY TOGETHER

The Higher Committee of Human Fraternity, established after Pope Francis' historical meeting with the Grand Imam of Al-Azhar, Prof Ahmed el Tajjib, one year ago, on February 4, 2019 to sign the Document of Human Fraternity, proposed Pope Francis that different faiths unite spiritually on May 14, a day of prayer, fasting and charity so that God helps human society to overcome the Coronavirus pandemic.

Pope Francis and the Sheikh of Al-Azhar, Prof Ahmed el Tajjib, gladly accepted this proposal of the committee, which represents the Christian, Muslim and Jewish faiths.

This call was also joined by the Interreligious Council of Albania, encouraging and calling on all the Muslim and Christian believers as well as believers of other faiths, to turn to God in prayer, fasting and charitable deeds, so that He, the Creator, may bless, save and protect His peoples and mercifully turn His gaze upon us in these times of trials.

The United Nations was the first to welcome and join this campaign; meanwhile, dozens of countries and international institutions as well as presidents and governments of various countries around the world also joined this day.



## NËNSHKRUHET MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MES KËSHILLIT NDËRFETAR DHE CVE-SË

Këshillit Ndërfetar i Shqipërisë, i përfaqësuar nga pesë krerët e komuniteteve fetare në vendin tonë, nënshkroi me dt. 17 maj 2019 një memorandum mirëkuptimi me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE).

Në këtë ceremoni të zhvilluar në zyrat e CVE-së merrnin pjesë përfaqësuesit më të lartë të komuniteteve fetare, respektivisht, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Bujar Spahiu, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Fortlumturia e Tij Anastasi (njëkohësisht kryetar i KNFSH-së), Arqipeshkvi i Tiranës dhe Durrësit, Mons. George Frendo, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, H. Dede Edmond Brahimaj dhe Kreu i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë Pastor Ylli Doçi.

Memorandumi i bashkëpunimit midis Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë (KNFSH) dhe Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE), u firmos nga pesë liderët e lartpërmendur, si dhe nga z. Agron Sojati, drejtor i CVE-së, i cili gjatë prezanti-

## MEMORANDUM OF UNDERSTANDING BETWEEN THE INTER-RELIGIOUS COUNCIL AND THE CVE IS SIGNED

The Inter-religious Council of Albania, represented by five heads of religious communities in our country, signed today on date May, 17, 2019 a Memorandum of Understanding with the Coordination Center against Violent Extremism (CVE).

At this ceremony held at the CVE offices were attended by the highest representatives of the religious communities, respectively, the Head of the Albanian Muslim Community H. Bujar Spahiu, the Archbishop of Tirana, Durres and all Albania His Apostasy Anastasi (at the same time chairman of Albania IRC), the Archbishop of Tirana and Durrës, Mons. George Frendo, Bektashi World leader, H. Dede Edmond Brahimaj and the Head of the Evangelical Brotherhood of Albania Pastor Ylli Doçi.

The Memorandum of Understanding between the Inter-religious Council of Albania (IRCA) and the Center of Coordination against Violent Extremism (CVE) was signed by the five leaders mentioned above, as well as by Mr. Agron Sojati, director of the CVE,





mit të këtij memorandumi, vlerësoi lart punën dhe kontributin e të gjithë komuniteteve fetare gjatë këtyre viteve, jo vetëm për frymën e dialogut dhe harmonisë ndërfetare, por edhe për paqen sociale dhe modelin që ata ofrojnë.

Në emër të Këshillit Ndërfetar, një fjalë përshëndetëse mbajti dhe H. Bujar Spahiu, i cili vuri theksin e bashkëpunimit midis, jo vetëm të institucioneve fetare mes tyre, por edhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore, për parandalimin e çdo forme të radikalizmit dhe ekstremizmit, duke e ruajtur fort vlerën e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit ndërfetar.

Gjatë kësaj ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu dhe zyrtarë të lartë të komuniteteve fetare, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë Dr. Genti Kruja.

## Memorandumi i bashkëpunimit vë theksin në disa pika, si:

• Forcimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve dhe harmonisë ndërfetare, rritjen e bashkëpunimit në interes të paqes, sigurisë dhe bashkëjetesës, angazhimin e përbashkët për të parandaluar e përballuar çdo synim, veprim, apo angazhim që synon të cenojë e rrezikojë paqen e sigurinë e vendit.

during the presentation of this memorandum, highly praised the work and contribution of all religious communities over the years, not only for the spirit of interfaith dialogue and harmony but also for social peace and the model they offer.

In the name of the Inter-Religious Council, a greeting was also delivered by H. Bujar Spahiu, who emphasized the cooperation between not only religious institutions but also cooperation with state institutions for the prevention of any form of radicalism and extremism by firmly preserve the value of interfaith coexistence and understanding.

During this ceremony were present also senior officials of religious communities, as well as the Secretary General of the Interreligious Council of Albania Dr. Genti Kruja.

## The Memorandum of Understanding emphasizes the following points:

• Strengthening and maintaining inter-religious relations and harmony, enhancing cooperation in the interests of peace, security and coexistence, joint commitment to prevent and cope with any goal, action or engagement that seeks to endanger the peace and security of the country.

- Rritjen e frymës së bashkëpunimit midis Komunitetet Fetare në Shqipëri dhe Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

- Mbajtjen në angazhim konstant të vlerave më të mira, që kanë karakterizuar shqiptarët dje, sot e në të ardhmen.

- Ngritja dhe institucionalizimi i bashkëpunimit mes Qendrës CVE e Komuniteteve Fetare në Shqipëri, në raporte bilaterale me çdo komunitet dhe në kuadrin e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë. Fryma e bashkëpunimit do të mbështetet në respektin dhe besimin reciprok mes palëve, në interes të një të ardhmeje më të mirë.

- Monitorimi i teksteve shkollore dhe literaturës që hy në ambientet e vuajtjes së dënimit, për të shmangur informacionet që bien ndesh me të vërtetat fetare, që dëmtojnë klimën e besimit e të mirëkuptimit mes besimtarëve, që nxisin dhunën dhe urrejtjen, kundërshtimin e ligjeve, apo rregullave të bashkëjetesës në komunitet.

- Institucionalizimi i bashkëpunimit mes qeverisjes vendore dhe strukturave vendore të komuniteteve fetare nëpërmjet Qendrës CVE, e cila do të ushtrojë gjithë angazhimin dhe përgjegjësinë e saj për ta bërë të mundur këtë, etj..

- Growing the spirit of cooperation between the Religious Communities in Albania and the Center Against Violent Extremism.

- Keeping in constant commitment to the best values that have characterized Albanians yesterday, today and in the future.

- Establishment and institutionalization of cooperation between CVE Center of Religious Communities in Albania, in bilateral relations with each community and in the framework of the Inter-religious Council of Albania. The spirit of cooperation will be based on mutual respect and trust among the parties, in the interest of a better future.

- Monitoring the school textbooks and literature that goes to prison facilities to avoid information that conflicts with religious truths that undermine the climate of trust and understanding among believers that incite violence and hatred, objection to laws, or rules of coexistence in the community.

- Institutionalization of cooperation between local government and local structures of religious communities through the CVE Center, which will exercise all its commitment and responsibility to enable this, ect.




## KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË TAKIM ME KRYEMINISTRIN LIDHUR ME RIHAPJEN E OBJEKTEVE TË KULTIT

Bordi i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë me kërkesën e tij ka zhvilluar me dt. 7 maj 2020 një mbledhje online me Kryeministrin e Shqipërisë z. Rama, ku është folur për rihapjen e objekteve të kultit, pas mbylljes së tyre për shkak të pandemisë së Covid 19.

Në këtë takim merrni pjesë krerët e pesë komuniteteve fetare, kryetari i Këshillit Ndërfetar Mons. George Frendo (njëkohësisht kreu i Kishës Katolike), kreu i KMSH-së H. Bujar Spahiu, Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Fortlumturia e Tij Anastas, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i VUSH-it Pastor Ylli Doçi, si dhe Sekretari i Përgjithshëm Dr. Genti Kruja.

## INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA MEETING WITH THE PRIME MINISTER REGARDING THE REOPENING OF CULT OBJECTS

The Board of the Presidency of the Interreligious Council of Albania with its request has conducted on May 7, 2020 an online meeting with the Prime Minister of Albania Mr. Rama, where there was talked about  reopening the cult objects, after their closure due to the pandemic COVID 19.

The meeting is attended by the leaders of the five religious communities, the chairman of the Interreligious Council Mons. George Frendo (at the same time the head of the Catholic Church), the head of Muslim Community of Albania H. Bujar Spahiu, the Archbishop of the Orthodox Church His Beatitude Anastas, H. Dede Edmond Brahimaj,

Gjatë këtij takimi fillimisht Kryeministri Rama ka falënderuar komunitetet fetare dhe të gjithë drejtuesit e tyre për bashkëpunimin lidhur me këtë situatë të vështirë, si dhe për sakrificat e ndërmarra në ditë festash të rëndësishme fetare për secilin komunitet, lidhur me pezullimin e përkohshëm të ritualeve në objektet e kultit.

Liderët e pesë komuniteteve fetare kanë shprehur opinionet e tyre, duke vënë theksin në rëndësinë, që i jep feja shëndetit dhe jetës së njeriut, lidhur me masat e marra që në fillim nga ana e tyre. Ndërsa tani, ku për shkak të qëndrueshmërisë dhe uljes së përhapjes së virusit në vendin tonë, si dhe zbutjes së masave nga qeveria shqiptare për rihapjen e aktiviteteve të ndryshme të jetës së përditshme, komunitetet fetare kanë marrë masat për një rihapje graduale të objekteve të kultit, kishave, xhamive dhe teqeve në bashkëpunim me organet kompetente dhe ekspertët e fushës.

"Kërkesa më e madhe që kemi është të kemi vendet e lutjes dhe adhurimit dhe të na jepni drejtimin të kujdesemi për këtë gjë, të mbajmë distancën mes njerëzve. Vendet e adhurimit ofrojnë shpresë dhe gëzim. T'ia japin njerëzve këtë mundësi, e përsëris duke iu përmbajtur udhëzimeve të dhëna deri tani. Komunitetet fetare kanë dhënë shembull të përulësisë dhe jemi gati për të vazhduar me këtë, gjithmonë në bashkëpunim të mirë me shoqërinë dhe në solidaritet me gjithë popullin", - tha Kryepeshkopi Anastas.

"Në kuadër të hapjes graduale që po merret në kushtet e pandemisë kërkuam këtë takim për të diskutuar rreth hapjes graduale të objekteve të kulteve duke respektuar rregullat e distancimit social. Pra, të na lejohet të kryejmë adhurimet në objektet tona të kultit", u shpreh kreu i KMSH-së, H. Bujar Spahiu.

"Ju përgëzoj për masat në radhë të parë, pasi siç e keni thënë edhe ju vetë do të kishim pasoja më të rënda, por unë bashkohem me çfarë u tha më parë se strukturat tona lejojnë respektimin e masave, pra të mos japim dorën e të shmangim kontaktet fizike. Dëshirojmë të hapet më shumë, të kemi leje që të bëhen takime fetare si mesha apo kremtime, duke shmangur çdo rrezik", - shtoi nga ana e tij Mons. Frendo.

the head of Evangelic Brotherhood Pastor Ylli Doçi, and the Secretary General Dr. Genti Kruja.

During this meeting, Prime Minister Rama first thanked the religious communities and all their leaders for the cooperation regarding this difficult situation, as well as for the sacrifices made on the important religious holidays for each community, regarding the temporary suspension of rituals in the facilities in the cult objects.

The leaders of the five religious communities have expressed their opinions, emphasizing the importance that religion gives to human health and life, regarding the measures taken by them from the beginning. Whereas now, due to the stability and reduction of the spread of the virus in our country, as well as the mitigation of measures by the Albanian government for the reopening of various activities of daily life, religious communities have taken measures for a gradual reopening of cult objects, churches, mosques and tekkes in cooperation with the competent bodies and experts in the field.

"The biggest request we have is to have places of prayer and worship and to give us the direction to take care of this, to keep the distance between people. Places of worship offer hope and joy. To give people this opportunity, I repeat, taking the instructions given so far. Religious communities have set an example of humility and we are ready to continue with this, always in good cooperation with society and in solidarity with all the people", said Archbishop Anastas.

"In the framework of the gradual opening that is being taken in the conditions of the pandemic, we requested this meeting to discuss about the gradual opening of cult objects, respecting the rules of social distancing. So, to be allowed to perform worship in our cult objects", said the head of Muslim Community of Albania, H. Bujar Spahiu.

"I congratulate you for the measures in the first place, because as you said you would have more serious consequences, but I agree with what was said before that our structures allow the observance of the measures, so do not give up and to avoid physical contact

“I morëm masat ashtu siç keni udhëzuar ju, as Sulltan Novruzin nuk e festuam. I falënderoj vëllezërit e mi për këtë propozim dhe bashkohem me të”, u shpreh H. Dede Edmond Brahimaj.

Nga ana e tij kryeministri Rama shtoi: “Ajo që keni bërë është fantastike ndihma që keni dhënë është e paçmuar. Keni përcjellë një mesazh shumë të qartë për popullin shqiptar. Sa i përket shqetësimit tuaj, unë bashkohem me ju që në kuadër të masave për lehtësimin e ndërveprimeve dhe jetës së përditshme sociale është e nevojshme të adresojmë edhe situatën aspak të lehtë që kjo luftë ka krijuar mbi komunitetet tuaja dhe të lehtësojmë pengesat e mëdha në ushtrimin e aktiviteteve tuaja.

Kjo është një gjë që duhet bërë në mënyrë graduale. Kjo kërkon një bashkëbisedim me ju se praktikat janë të ndryshme nga komuniteti në komunitet. Ndryshe nga aktivitetet e tjera të biznesit në rastin e komuniteteve fetare duhet bërë bashkarisht. Nga sot apo nesër ju duhet të jeni disponibël për t'u vendosur në kontakt me personat që hartojnë masat lehtësuese, për të pasur një konsultim konkret, se si mund të hartohet një kalendar gradual deri në normalizimin e plotë. Nëse do hartojmë një kalendar të arsyeshëm, besoj që më 18 maj kur do të jetë konfiguruar gjithë projekti i fazës së dytë të mund të japim edhe disa indikacione konkrete për institucionet fetare”.

as much as we can. “We want to be more open, to have permission to hold religious meetings such as masses or celebrations, avoiding any danger”, - added Mons. Frendo.

“We took the measures as you instructed, we did not even celebrate Sultan Novruz. I thank my brothers for this proposal and I join it”, said H. Dede Edmond Brahimaj.

On his part, Prime Minister Rama added: “What you have done is fantastic, the help you have given is invaluable. You have conveyed a very clear message to the Albanian people. As far as your concern, I agree with you that as part of the measures to facilitate interactions and daily social life, it is necessary to address the not at all easy situation that this war has created over your communities and to alleviate the big obstacles in exercising of your activities.

This is something that needs to be done gradually. This requires a conversation with you that practices are different from community to community. In difference of other business activities in the case of religious communities it must be done together. From today or tomorrow you should be available to get in touch with the people who draft the mitigation measures, to have a concrete consultation, on how a gradual calendar can be drafted until full normalization. If we will compile a reasonable calendar, I believe that on May 18, when the whole project of the second phase will be configured, we can give some concrete indications for religious institutions”.




## DEPARTAMENTI I GRUAS DHE DEPARTAMENTI I RINISË ZHVILLOJNË KONSULTIMET E III KOMBËTARE

Me dt. 18 qershor 2020 janë zhvilluar Konsultimet e III Kombëtare të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

Në mbledhjen e drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KNFSH-së Dr. Genti Kruja, mer-rnin pjesë anëtarët e dy departamenteve të Këshillit, të cilët të mbledhur në një situatë të pazakontë, ku gjendet vendi ynë dhe mbarë bota, ajo e përhapjes së virusit Covid 19, ata kanë diskutuar rreth disa problematikave dhe projekteve, që do të aplikohen dhe zbatohen nga Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë.

Mbledhja fillimisht është hapur me një homazh ndaj ish-anëtarit të Departamentit të Rinisë Xhontil Bardhi, i cili humbi jetën tragjikisht para disa ditësh. Kjo ngjarje ka vënë theksin edhe një herë mbi fatkeqësinë e gjakmarrjes në vendin tonë, plagë e cila akoma lëngon dhe kërkon një vëmendje më të madhe nga shteti shqiptar.

## THE DEPARTMENT OF WOMEN AND THE DEPARTMENT OF YOUTH CONDUCT THIRD NATIONAL CONSULTATIONS

On June 18, 2020 were held the third National Consultations of the Department of Women and the Department of Youth of the Interreligious Council of Albania.

In the meeting leaded by the Secretary General of IRCA Dr. Genti Kruja, were attended by members of two departments of the Council, who gathered in an unusual situation, where our country and the world is locked, to avoid the spread of the Covid 19 virus, they discussed about some issues and projects that will applied and implemented by the Department of Women and the Department of Youth.

The meeting was initially opened with a tribute to former Youth Department member Xhontil Bardhi, who tragically lost his life a few days ago. This event has once again emphasized the tragedy of blood feuds in our country, a wound which still suffers and requires bigger attention from the Albanian state.





Më pas mbledhja ka vijuar me diskutimet për organizimin e një projekti humanitar, i cili do të shtrihet në zonën e tërmetit për familjet në nevojë. Ky projekt i cili do të zbatohet në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare "Religions for Peace" vjen në kuadër të situatës së vështirë ekonomike, shkaktuar nga Covid 19 dhe do të zbatohet nga Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë në Këshillin Ndërfetar në bashkëpunim me pesë komunitetet fetare në vend.

Krahas këtij projekti është diskutuar dhe për disa aktivitete të tjera, që do të zhvillohen gjatë një viti në fushën e promovimit të dialogut ndërfetar dhe luftës kundër radikalizmit dhe ekstremizmi të çdo forme dhe lloji.

Tashmë prej më shumë se një viti nga themelimi i këtyre dy departamenteve të reja, këto njësi kanë zhvilluar disa aktivitete dhe takime në kuadër të forcimit të rolit të gruas dhe rinisë në fushën e dialogut ndërfetar.

The meeting then continued with discussions on organizing a humanitarian project, which will be extended to the earthquake area for families in need. This project which will be implemented in cooperation with the International Organization "Religions for Peace" comes in the context of the difficult economic situation, caused by Covid 19 and will be implemented by the Department of Women and the Department of Youth in the Inter Religious Council in cooperation with five religious communities in country.

In addition to this project, several other activities were discussed, which will take place during a year in the field of promoting interfaith dialogue and the fight against radicalism and extremism of any form and type.

Already more than a year since the establishment of these two new departments, these units have held several activities and meetings in the framework of strengthening the role of women and youth in the field of interfaith dialogue.



## KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË NË NDIHMË TË QINDRA FAMILJEVE NË NEVOJË

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë në kuadër të aktiviteteve humanitare, ka iniciuar nismën e gjendjes pranë qindra familjeve në nevojë. Ky projekt ka nisur me ndihmën ndaj 50 familjeve të fëmijëve jetimë të zonës së tërmetit në rrethin e Kurbinit, si dhe shumë familjeve të tjera në gjendje të vështirë ekonomike të zonës së Kurbinit, Durrësit dhe Tiranës, të prekur dhe nga dëmet e tërmetit të nëntorit 2019, si dhe të vënë dhe më shumë në vështirësi për shkak të përhapjes së virusit Covid 19 në vendin tonë.

Ky projekt humanitar vjen si një bashkëpunim i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë me partnerë ndërkombëtarë, siç është organizata më e madhe botërore në fushën e paqes dhe dialogut, akredituar dhe nga OKB, "Religions for Peace" me qendër në New York, SHBA.

## INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA IN HELP OF HUNDREDS OF FAMILIES IN NEED

Interreligious Council of Albania, in the framework of humanitarian activities, has started the initiative to be near of hundreds of families in need. This project has started with the help given to families of orphans in the earthquake zone in the district of Kurbin, as well as many other families in difficult economic situation in the area of Kurbin, Durres and Tirana, affected by the damage of the earthquake happened on November 2019, as well as putting them even more in trouble due to the spread of virus COVID-19 in our country.

This humanitarian project comes as a collaboration of Inter Religious Council of Albania with international partners, such as the world's largest organization in the field of peace and dialogue, accredited by the UN, "Religions for Peace" based in New York, USA.





Projekti i shtrirë në zonat e lartpërmendura dhe në fshatrat e tyre, po zbatohet nga të rinj e të reja myslimanë e të krishterë, anëtarë të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, të cilët njëkohësisht përfaqësojnë edhe pesë komunitetet tradicionale fetare në Shqipëri, të cilët bashkëdrejtojnë edhe Qendrën e Këshillit Ndërfetar.

Nisma është çelur me shpërndarjen e ndihmave për familjet e jetimëve në Laç, aktivitet i zhvilluar nga KNFSH në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të komuniteteve fetare, drejtues të bashkisë Kurbin, shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias.

Më pas vullnetarët e rinisë së KNFSH-së kanë vazhduar me shpërndarjen e pakove ushqimore nëpër shtëpitë dhe familjet në nevojë në Kurbin, Durrës dhe Tiranë.

KNFSH tashmë është në ndjekje të disa projekteve me karakter humanitar, social, kulturor dhe më gjerë në kuadër të bashkëpunimit ndërfetar, duke rritur kapacitetet e aktivizimit të grave dhe të rinjve myslimanë e të krishterë, si fuqi e ndryshimit pozitiv dhe promovimit të dialogut ndërfetar në Shqipëri dhe përtej saj./17.07.2020

Young Muslims and Christians, members of the Department of Women and the Department of Youth in the Inter Religion Council of Albania, who also represent the five traditional religious communities in Albania, who also co-direct the Center of the Interreligious Council, are implementing the project, located in the above-mentioned areas and in their villages.

The initiative was launched with the distribution of aid to the families of orphans in Laç, an activity developed by IRC of Albania in cooperation with the National Association of Orphans of Albania. Representatives of religious communities, leaders of the municipality of Kurbin, civil society and media representatives attended the event.

Afterwards, IRC of Albania youth volunteers continued to distribute food packages to homes and families in need in Kurbin, Durrës and Tirana.

IRC of Albania is already pursuing several of humanitarian, social and cultural, with wider character projects in the framework of interfaith cooperation, increasing the capacity of activating Muslim and Christian women and youth, as a force for positive change and promoting interfaith dialogue in Albania and beyond.






## KNFSH PJESË AKTIVE E PANELIT NDËRKOMBËTAR TË "RELIGIONS FOR PEACE"

Në kuadër të 50-vjetorit të themelimit të Organizatës Ndërkombëtare "Religions for Peace", me dt. 28 korrik 2020 është zhvilluar Takimi i Dytë Ndërkombëtar online me këshillat ndërfetarë nga e gjithë bota, ku është diskutuar rreth disa modeleve dhe rritjes së gjithëpërfshirjes në këshillat ndërfetare.

Paneli i këtij takimi është hapur nga Sekretarja e Përgjithshme e "Religions for Peace" Prof. Azza Karam, e cila më pas ia ka dhënë fjalën panelistëve nga disa kontinente. Ndër panelistët e ftuar për të ndarë eksperiencën e dialogut ndërfetar në Shqipëri ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm i KNFSH-së Dr. Genti Kruja, i cili ka folur për historikun e harmonisë ndërfetare në vendin tonë, bashkëpunimin shumëvjeçar të komuniteteve fetare, aktivitetet akademike në fushën e dialogut, si dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve dhe grave të të gjitha besimeve në disa projekte humanitare, siç ishte ai i fundit, në ndihmë të qindra familjeve në nevojë të zonës së tërmetit mbështetur nga "Religions for Peace".

Në fjalën e mbajtur nga Zv/sekretari i Përgjithshëm z. Kyoichi Sugino, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është paraqitur si një model i një institucioni aktiv, i strukturuar me disa borde, ku të gjitha komunitetet fetare janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë.

Pikërisht për të folur për ketë temë dhe model ka qenë i ftuar edhe Dr, Kruja, i cili ka folur në emër të Drejtorisë Globale të Këshillave Ndërfetarë, duke ndarë me rreth 200 drejtues të institucioneve ndërfetare nga e gjithë bota, disa shembuj konkret të bashkëpunimit dhe dialogut ndërfetar në Shqipëri.




## IRCA ACTIVE PART OF THE INTERNATIONAL PANEL OF "RELIGIONS FOR PEACE"

In the framework of the 50th anniversary of the founding of the International Organization "Religions for Peace", dated On July 28, 2020, the Second International Online Meeting was held with inter Religious councils from around the world, where several models and increasing inclusion in interfaith councils were discussed.

The panel of this meeting was opened by the Secretary General of "Religions for Peace" Prof. Azza Karam, who then gave the floor to panelists from several continents. Among the panelists invited to share the experience of interfaith dialogue in Albania was also the Secretary General of IRCA Dr. Genti Kruja, who spoke about the history of interfaith harmony in our country, the long-term cooperation of religious communities, academic activities in the field of dialogue, as well as the active participation of young people and women of all faiths in several humanitarian projects, such as the latest , to help hundreds of families in need from Earthquake which was supported by Religions for Peace.

In the speech delivered by the Deputy Secretary General, Mr. Kyoichi Sugino, the Interfaith Council of Albania is presented as a model of an active institution, structured with several boards, where all religious communities are equally represented.

Exactly to talk about this topic and model was also invited Dr. Kruja, who spoke on behalf of the Global Directorate of Interreligious Councils, sharing with about 200 leaders of interfaith institutions from around the world, some concrete examples of cooperation and interfaith dialogue in Albania.



## ROLI I TOLERANCËS FETARE NË PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Komiteti Shqiptar i Helsinkit zhvilloi me dt. 8.09.2020 në ambientet e "Hotel Rogner" workshopin me temë: **"Roli i Tolerancës Fetare për parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm"** në kuadër të projektit **"Aktivitete edukative të bazuara në vlera, për të parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm tek të rinjtë në Shqipëri"**.

Në aktivitetin e zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë morën pjesë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, Dr. Genti Kruja, përfaqësuesit e komuniteteve fetare të vendit, si z. Taulant Bica - nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Ylli Doçi - kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, At Grigor Pelushi - përfaqësues i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Motër Ermira Koleci - përfaqësuese e Kishës Katolike të Shqipërisë, znj. Sheldiana Agaraj - përfaqësuese e Kryegjyshatës Bektashiane, znj. Lejdi Dervishi - kreu i Qendrës së Koordinimit Kombëtar Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE), si dhe anëtarë të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në KNFSH.

## THE ROLE OF RELIGIOUS TOLERANCE IN PREVENTING VIOLENT EXTREMISM

The Albanian Helsinki Committee held on September 8, 2020 in the venues of "Rogner Hotel" workshop on the topic: "**The Role of Religious Tolerance for the Prevention of Violent Extremism"** within the project "**Educational activities based on values to prevent Violent Extremism among young people in Albania"**.

The activity developed in cooperation with the Inter Religious Council of Albania was attended by the Secretary General of the Interreligious Council of Albania, Dr. Genti Kruja, representatives of the religious communities of the country, Mr. Taulant Bica - Vice Chairman of the Muslim Community of Albania, Mr. Ylli Doçi - President of the Evangelical Brotherhood of Albania, Father Grigor Pelushi - Representative of the Autocephalous Orthodox Church of Albania, Sister Ermira Koleci - Representative of the Catholic Church of Albania, Mrs. Sheldiana Agaraj - representative of the Bektashi Community, Mrs. Lejdi Dervishi - Head of the National Coordination Center Against Violent Extremism (CVE Center), as well as members of the Department of Women and the Department of Youth in IRC Albania.





Përfaqësuesja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit njëkohësisht edhe moderatorja e këtij workshopi, znj. Miriam Neziri Angoni, gjatë fjalës së saj, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, si dhe vuri theksin mbi rëndësinë e platformave të tilla në përpjekjen e vazhdueshme për të kultivuar më tej mirëkuptimin dhe dialogun e ndërsjelltë në shoqëri dhe sidomos tek të rinjtë.

Në emër të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë z. Kruja foli rreth punës dhe veprimtarisë së KNFSH-së, rolit të institucioneve arsimore dhe akademike të komuniteteve fetare në promovimin e harmonisë ndërfetare dhe angazhimin së fundmi të rinisë dhe grave të komuniteteve fetare në forcimin e kësaj fryme.

Workshopi vijoi më tej me fjalën e përfaqësuesve të komuniteteve fetare, të cilët prekën aspekte të ndryshme të temës në fjalë, duke nxjerrë kështu përfundime të vlefshme në ruajtjen dhe dërgimin më tej të misionit të përbashkët të harmonisë ndërfetare të vendit tonë.

The representative of the Albanian Helsinki Committee also the moderator of this workshop, Mrs. Miriam Neziri Angoni, during her speech, thanked the participants for their participation, and put the emphasis to the importance of such platforms in the ongoing, effort to further cultivate mutual understanding, and dialogue in society and especially among young people.

On behalf of the Interreligious Council of Albania, Mr. Kruja spoke about the work and activity of IRC Albania, the role of educational and academic institutions of religious communities in promoting interfaith harmony and the recent engagement of youth and women of religious communities in strengthening this spirit of collaboration.

The workshop continued with the speech of representatives of religious communities, who touched various aspects of the topic, drawing valuable conclusions in preserving and furthering the common mission of interfaith harmony of our country.

# DEPARTAMENTI I GRUAS NË KNFSH TAKIM ME AMBASADOREN E SUEDISË NË TIRANË

Më datë 8 shator 2020, Departamenti i Gruas në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, organizoi një takim miqësor me Ambasadoren e Ambasadës së Suedisë në Tiranë Shkëlqesinë e Saj znj. Elsa Hastad.

Diskutimi interaktiv, u zhvillua me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave përfaqësuese të komuniteteve tradicionale fetare të Shqipërisë, pjesë aktive e Këshillit Ndërfetar, duke prezantuar secila besimin dhe komunitetin, që përfaqëson dhe rolin e tyre në bashkëpunimin ndërfetar.

Gjatë këtij bashkëbisedimi ambasadorja vlerësoi frymën e bashkëpunimit ndërfetar të tyre dhe i siguroi ato se bashkëpunimi ndërinstitucional i Departamentit të Gruas në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë dhe Ambasadës së Suedisë në Tiranë do të jetë i vazhdueshëm, sidomos në aktivitete me tematika të tilla si, promovimi i të drejtave të grave dhe vajzave, barazisë gjinore në punësim, familje e pagë, si dhe në tematika të tjera, që lidhen me fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri.

Në këtë takim u diskutuan dhe tema të tilla si, diskriminimi i grave të mbuluara, ose të atyre që mbajnë simbole fetare gjatë aplikimit për punësim në sektorin publik dhe jopubik; prania e ulët e grave në lidershipin e administratës, sidomos e atyre që mbajnë veshje fetare; fuqizimi ekonomik i gruas, fushë për të cilën Ambasada Suedeze ofron bashkëpunim me financim iniciativash të reja biznesi nga të rejat dhe gratë; problemet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, etj.

Departamenti i Gruas në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë është themeluar vitin e kaluar nga Bordi i Presidencës në KNFSH dhe po luan një rol aktiv në aktivitete të ndryshme sociale, duke promovuar në forma të ndryshme bashkëpunimin dhe dialogun ndërfetar.



# DEPARTMENT OF WOMEN IN IRC ALBANIA MEETING WITH THE AMBASSADOR OF SWEDEN IN TIRANA

On September 8, 2020, the Department of Women in the Inter Religious Council of Albania, organized a friendly meeting with the Ambassador of the Embassy of Sweden in Tirana Her Excellency Mrs. Elsa Hastad.

The interactive discussion took place with the participation of women and girls representing the traditional religious communities of Albania, an active part of the Inter Religious Council, each of them presenting their faith and community, which represents their role in interfaith cooperation.

During this conversation the ambassador appreciated the spirit of their interfaith cooperation and assured them that the inter-institutional cooperation of the Department of Women in the Inter Religious Council of Albania and the Embassy of Sweden in Tirana will be continuous, especially in activities with topics such as promoting women's and girls' rights, gender equality in employment, family and payment, as well as other topics related to the empowerment of women in society.

In the meeting also they discussed topics such as discrimination against covered woman or those who wear religious symbols when applying for employment in the public and non-public sector; the low presence of women in the leadership of the administration, especially those who wear religious clothes; women's economic empowerment, an area for which the Swedish Embassy offers cooperation by financing new business initiatives by young girls and women; problems of radicalism and violent extremism, etc.

The Department of Women in the Interreligious Council of Albania was established last year by the Board of the Presidency at IRC Albania and is playing an active role in various social activities, promoting in various forms interfaith cooperation and dialogue.






## KNFSH REALIZON DOKUMENTARIN "30 VJET LIRI BESIMI"

Në vitin 1990 populli i shumëvuajtur shqiptar ishte i etur për liri besimi. Mijëra besimtarë myslimanë dhe të krishterë, të frymëzuar nga dashuria për Zotin dhe malli për t'u lutur e falur të lirë, mësynë ato pak objekte kulti të mbetura në këmbë, duke i rënë kambanave, e duke realizuar meshën e parë dhe duke falur xhumanë e parë në nëntor 1990. Ky ishte triumfi i besimit ndaj mohimit, ishte triumfi i lirisë ndaj prangave dhe zinxhirëve të një regjimi diktatorial.

Rihapja e objekteve të kultit në nëntorin e vitit 1990, pas ndalimit 23 vjeçar të besimit, përbën një nga momentet kulmore të historisë së vendit tonë, duke i paraprirë lëvizjes së dhjetorit dhe rrëzimit të bustit të diktatorit pak muaj më vonë.

Këto ngjarje historike vranë frikën dhe u çeli sytë të gjithë shqiptarëve, duke i dhënë shpresë për një të ardhme më të mirë.

Pamjet madhështore të shërbesave të para fetare pas disa dekadash janë kështu dëshmi e një historie të jashtëzakonshme, të cilat u bënë dhe objekti i dokumentarit të parë të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, kushtuar 30 vjetorit të lirisë së besimit në Shqipëri.

## IRCA REALIZES THE DOCUMENTARY "30 YEARS OF RELIGION FREEDOM"

In 1990, the long-suffering Albanian people were eager for freedom of religion. Thousands of Muslim and Christian believers inspired by the love of God and the longing to pray freely, raid the few standing cult objects, ringing the bells, performing the first Mass and praying on first Fridays in November 1990. This was the triumph of belief in denial; it was the triumph of freedom over the shackles and chains of a dictatorial regime.

The reopening of cult objects in November 1990, after a 23-year ban on the faith, is one of the culminating moments in the history of our country, preceding the December movement and the fall of the dictator's bust a few months later.

These historical events killed fear and opened the eyes of all Albanians, giving them hope for a better future.

The magnificent views of the first religious services after several decades are thus evidence of an extraordinary history, which became the subject of the first documentary of the Interreligious Council of Albania, dedicated to the 30 th anniversary of religion freedom in Albania.






## ZHVILLOHET TRYEZA E RRUMBULLAKËT "SFIDA E TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI DHE ANGAZHIMI I BESIMEVE FETARE KUNDËR TRAFIKIMIT"

Me dt. 29.10.2020 është zhvilluar në Tiranë një tryezë e rrumbullakët e titulluar "Sfida e trafikimit në Shqipëri dhe angazhimi i besimeve fetare kundër trafikimit", organizuar nga organizata Caritas në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë.

Paneli i moderuar nga znj. Ariela Mitri është hapur me një fjalë përshëndetëse nga Mons. George Frendo, Kryetar i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë dhe njëkohësisht Kryetar i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë. Më pas kanë referuar Dr. Genti Kruja - Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar dhe Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame në Universitetin Bedër, znj. Mimoza Qyra nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar - Ministria e Brendshme, znj. Alma Tandilli - Drejtoresha e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e fëmijëve, znj. Marjana Meshi - Drejtoreshë e Strehezës për Viktima trafikimi, si dhe Motër Alma Zogu nga Strehëza "Rozalba".

Në këtë panel merrnin pjesë dhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane, si dhe anëtarët e Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, të cilët kanë diskutuar dhe bashkëbiseduar me panelistët rreth temës së kësaj tryeze, duke vënë theksin në bashkëpunimin e të gjithë faktorëve në mbrojtje të viktimave dhe grupeve vulnerabël ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.

## ROUND TABLE "THE CHALLENGE OF TRAFFICKING IN ALBANIA AND THE COMMITMENT OF RELIGIOUS BELIEFS"

On October 29, 2020, a round table was held in Tirana entitled "The challenge of trafficking in Albania and the commitment of religious beliefs against trafficking", organized by Caritas in cooperation with the Ministry of Internal Affairs and the Interreligious Council of Albania.

The panel moderated by Mrs. Ariela Mitri was opened with a greeting from Mons. George Frendo, Chairman of the Interreligious Council of Albania and at the same time Chairman of the Episcopal Conference of Albania. Then referred Dr. Genti Kruja - Secretary General of the Interreligious Council and Head of the Department of Islamic Sciences at Bedër University, Mrs. Mimoza Qyra from the Office of the National Coordinator - Ministry of Interior, Mrs. Alma Tandilli - Director of the State Agency for Child Protection, Mrs. Marjana Meshi - Director of the Shelter for Victims of Trafficking, and Sister Alma Zogu from the Shelter "Rozalba".

This panel was attended by representatives from the US Embassy,as well as members of the Department of Women and the Department of Youth in the Interreligious Council of Albania, who discussed and talked with the panelists about the topic of this roundtable, emphasizing the cooperation of all factors in the protection of victims and vulnerable groups of trafficking of human beings.

# Konferenca dhe takime ndërkombëtare

# Conferences and international meetings



## ZHVILLOHET AKTIVITETI DHE KONFERENCA "FEJA NË SHOQËRI: MODELI SHQIPTAR"

Instituti i Bashkëpunimit për Integrimin dhe Zhvillimin në bashkëpunim me komunitetet fetare, zhvilluan me dt. 6 maj 2019 në ambientet e "Muzeut Historik Kombëtar" aktivitetin me titull: "Feja në shoqëri: Modeli Shqiptar".

Ky eveniment, i cili ka vijuar me aktivitete të tjera ndërmjet komuniteteve fetare në dy ditët në vijim, ka synuar të promovojë dhe kultivojë vlerën e bashkëjetesës në diversitetin e bashkësive fetare shqiptare në harmoni, paqe dhe integritet.

Në takimin e zhvilluar ishin të pranishëm përfaqësuesit më të lartë të komuniteteve fetare të vendit, si Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturia e tij Anastas Janullatos, Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, Arqipeshkvi i Tiranë - Durrës, Mons. George Frendo, përfaqësues i Kryegjyshatës Bektashiane, Kryetari i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, Pastor Ylli Doçi, sekretari i përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar Dr. Genti Kruja, Nunci Apostolik në Tiranë Charles John Brown, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar Dr. Dorian Koçi, dekani i Fakultetit të Shkencave Humane nga Universiteti

## CONFERENCE AND ACTIVITY "RELIGION IN SOCIETY: THE ALBANIAN MODEL"

The Institute for Cooperation and Development in cooperation with religious communities organised the activity "Religion in society: the Albanian Model" at the premises of the National Museum of History, on May 6, 2019.

This event, which was followed by other activities in the next two days, aimed to promote and cultivate the value of coexistence in harmony, peace and integrity among the diverse Albanian religious communities.

The activity was attended by senior representatives of the country's religious communities: the head of the Muslim Community of Albania, H. Bujar Spahiu, Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, His Beatitude Annastasios Yannulatous, the President of the Episcopal Conference of Albania, Archbishop of Tirana - Durres, Mons. George Frendo, the representative of the World Bektashi Order, the President of the Evangelical Brotherhood of Albania, Pastor Ylli Doçi, the Secretary General of the Interreligious Council of Albania, Dr. Genti Kruja, the Apostolic Nuncio in Tirana, Mr Charles John Brown, the director of the National Museum of History, Dr. Dorian Koçi,

Bedër Prof. Asoc. Rahim Ombashi, nënkryetari i Bashkisë Tiranë, si dhe përfaqësues të lartë të institucioneve të ndryshme.

Aktiviteti u hap me fjalët përshëndetëse të organizatorëve, duke filluar me fjalën e Drejtorit Ekzekutiv të ICID Albania, Prof. Assoc. Reis Mulita, për të vijuar më tej me referimin e krerëve të komuniteteve fetare. Aktiviteti u përshëndet gjithashtu dhe nga Kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet znj. Loreta Aliko, drejtori i AQSH-së z. Ardit Bido, si dhe përfaqësues të tjerë nga institucione të ndryshme publike, si Bashkia Tiranë dhe ajo Kurbin.

Aktiviteti vazhdoi më tej me referimin e krerëve të lartpërmendur të cilët prekën dhe njëherë asetin më të çmuar të vendit tonë, harmoninë ndërfetare si një model për t'ia përcjell të gatshëm botës, e parë kjo në këndvështrimet përkatëse të 5 përfaqësueseve fetarë të komuniteteve të ndryshme.

Në fund të aktivitetit pjesëmarrësit vizituan në ambientet e Muzeut Kombëtar ekspozitën e besimeve dhe vlerave ndërfetare të Shqipërisë ndër vite, ku dhe komunitetet fetare kishin standin e tyre me libra dhe sende të vjetra, ruajtur me kujdes gjatë periudhës së komunizmit dhe një ekspozitë të bashkëjetesës ndërfetare.

the Dean of the Faculty of Humanities at University College Beder, Assoc Prof Rahim Ombashi, the Deputy Mayor of Tirana, and senior representatives of various institutions.

The activity was opened with the organisers' welcoming remarks, starting with the Executive Director of ICID Albania, Assoc Prof Reis Mulita, followed by the leaders of religious communities. Speeches were also given by the chairwoman of the State Committee on Cults, Mrs Loreta Aliko, the Director of the General Directorate of Archives, Dr. Ardit Bido, as well as other representatives from various public institutions such as the Municipality of Tirana and of Kurbin.

The activity continued with the aforementioned leaders' speeches, who once more addressed the most precious asset of our country, interfaith harmony, as a model to convey to the world, seen from the relevant perspectives of the five representatives of different religious communities.

At the end of the activity, the participants visited the exhibition of religions and interfaith values of Albania over the years, in which the religious communities had their own stands with books and old items, carefully preserved during the communist period.







## MBAHET NË BERLIN TAKIMI NDËRKOMBËTAR I KËSHILLAVE NDËRFETARË TË EUROPËS

Në kuadër të përgatitjeve për zhvillimin e Asamblesë së X Botërore të organizatës ndërkombëtare "Religions for Peace" (Fetë për Paqen), që mbahet në Lindau të Gjermanisë, është zhvilluar në Berlin në datat 18-19 mars 2019 një takim ndërkombëtar i Këshillave Ndërfetarë të Europës, ku një prej tyre është edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, i përfaqësuar në këtë samit nga Sekretari i Përgjithshëm, Dr. Genti Kruja.

Në takimin e Berlinit, drejtuar nga Dr. Thomas Wipf, President i Këshillit Ndërfetar Evropian të Liderëve Fetarë (ECRL), përfaqësuesit e Këshillave Ndërfetarë të Europës, anëtarë me të drejta të plota në "Religions for Peace", kanë diskutuar ndër të tjera lidhur me aktivitetet e secilit në vendin përkatës në fushën e Dialogut Ndërfetar, ku edhe Dr. Kruja ka bërë një prezantim të harmonisë dhe shembujve të shumtë të bashkëpunimit ndërfetar në Shqipëri, si dhe për veprimtarinë e KNFSH-së gjatë muajve të fundit, institucion, i cili ka qenë aktiv jo vetëm në fushën e dialogut ndërfetar, por edhe në situatat e ndryshme politike dhe shoqërore të vendit tonë, duke dalë para opinionit publik dhe mediave me disa deklarata të përbashkëta.

## INTERNATIONAL MEETING OF INTERRELIGIOUS COUNCILS OF EUROPE HELD IN BERLIN

As part of the preparations for the 10th World Assembly of "Religions for Peace", to be held in Lindau, Germany, an international meeting of the European Interreligious Councils was held in Berlin, on March 18-19, 2019. The Interreligious Council of Albania was represented by its Secretary General, Dr. Genti Kruja.

At the Berlin meeting, chaired by Dr. Thomas Wipf, President of the European Council of Religious Leaders (ECRL), representatives of Interreligious Councils of Europe, full members of "Religions for peace", among other things, discussed each country's activities in the field of Interfaith Dialogue. In this meeting, Dr. Kruja made a presentation of the harmony and numerous examples of interfaith cooperation in Albania, as well as of the recent activities of IRCA, an institution which has been active not only in the field of interfaith dialogues but also in various political and societal situations of the country by giving joint press statements.

During this two-day meeting, consultations were also held about the preparations for the 10th World Assembly, which will be attended by senior religious leaders from





Gjatë këtij takimi dyditor janë zhvilluar gjithashtu konsulta për përgatitjet e Asamblesë së X Botërore, ku do të marrin pjesë personalitete të larta fetare nga 100 shtete të ndryshme të botës, si dhe përfaqësues të organizmave të gruas dhe rinisë, në të cilën do të zhvillohen disa seanca dhe panele shkencore rreth temës kryesore të kësaj asambleje "Kujdesi për të ardhmen tonë të përbashkët", si dhe nëntemave të tjera të përcaktuara për t'u trajtuar në këtë tubim të madh botëror. Gjatë zhvillimit të kësaj asambleje, delegatë nga e gjithë bota do të votojnë gjithashtu dhe për organet drejtuese të "Religions for Peace", të nominuar nga këshillat ndërfetarë kombëtarë, të cilët zgjidhen një herë në pesë vite.

"Religions for Peace" është themeluar në vitin 1970 me qendër në New York dhe është organizata më e madhe botërore, që operon në fushën e paqes dhe dialogut në të gjithë botën, akredituar dhe njohur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).

100 different countries as well as representatives of women's and youth organisations. Several scientific sessions and panels will be held on the Assembly's main theme "Caring for our common future" as well as other subthemes to be addressed in this great world gathering. In the Assembly, delegates from around the world will vote for the "Religions for Peace" governing bodies, who are nominated by local interreligious councils and elected every five years.

Based in New York, "Religions for Peace" was established in 1970 and is the world's largest organisation operating in the area of peace and dialogue, accredited and recognised by the UN.





## ZHVILLOHET NË BRUKSEL MBLEDHJA VJETORE E KËSHILLAVE NDËRFETARË TË EUROPËS

Në datat 29-30 prill 2019 u mbajt në Bruksel mbledhja vjetore e Këshillave Ndërfetarë të Europës.

Në mbledhjen e drejtuar nga Presidenti i Këshillave Ndërfetarë të Europës Dr. Luigi de Salvia marrin pjesë përfaqësues nga këshillat ndërfetarë të 11 shteteve të ndryshme të Europës, ku ndër ta merr pjesë edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë.

Në mbledhjen dy ditore, e cila u zhvillua në Qendrën Ekumenike të Belgjikës, takim i organizuar nga organizata ndërkombëtare "Religions for Peace" nëpërmjet degës së saj në Bruksel (Këshilli Ndërfetar i Belgjikës), u diskutua gjendja aktuale e këshillave ndërfetarë europianë, aktivitetet e tyre, problematikat, si dhe mundësitë për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e dialogut ndërfetar në Europë dhe botë.

Ditën e dytë të punimeve i pranishëm ishte dhe Dr. Vincent Depaigne, Koordinator i Komisionit Evropian për Dialogun midis Komisionit Evropian dhe komuniteteve fetare në Europë, i cili shpjegoi mundësitë e bashkëpunimit në fushën e dialogut ndërfetar. Dr. Kruja, i cili përfaqësonte KNFSH në këtë takim, ka shpjeguar modelin e dialogut ndërfetar në Shqipëri, si dhe aktivitetet e Këshillit Ndërfetar kohët e fundit, si dhe bashkëpunimin midis shkollave teologjike në fushën akademike.

## ANNUAL MEETING OF INTERRELIGIOUS COUNCILS OF EUROPE HELD IN BRUSSELS

The annual meeting of Interreligious Councils of Europe was held in Brussels, on April 29-30, 2019.

The meeting, chaired by the President of the Interreligious Council of Europe, Dr. Luigi de Salvia, was attended by representatives of Interreligious Councils of 11 different European countries, including the Interreligious Council of Albania.

In the two-day meeting, which took place at the Belgian Ecumenical Centre, and which was organised by the international organisation "Religions for Peace" through its Belgian branch (Interreligious Council of Brussels), the current state of European Interreligious Councils, activities, problems and opportunities to increase cooperation and strengthen interfaith dialogue in Europe and in the world were discussed.

The second day was attended by Dr. Vincent Depaigne, Coordinator of the European Commission for Dialogue between the European Commission and religious communities in Europe, who explained opportunities for cooperation in the field of interfaith dialogue. Dr. Kruja, who represented IRCA in this meeting, explained the Albanian model of interfaith dialogue, IRCA's recent activities and the cooperation of theological schools in the academic field.



## KNFSH TAKIM NË VARSHAVË, POLONI

Në datat 25-27 maj 2019 u mbajtën në Varshavë, Poloni, konsultimet parapërgatitore për Asamblenë e X-të Botërore të RfP-së (Religions for Peace), që do të zhvillohet në Lindau të Gjermanisë.

Në këtë takim ndërkombëtar merrnin pjesë përfaqësues nga departamentet e gruas dhe rinisë nga Këshillat Ndërfetarë të Europës.

Në këtë takim ndërkombëtar në emër të Departamentit të Gruas në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë mori pjesë znj. Sheldiana Jano (Agaraj), kurse në emër të Departamentit të Rinisë Geraldo Mehmeti.

## IRCA - MEETING IN WARSAW, POLAND

On May 25-27, 2019, preparatory consultations for the 10th World Assembly of "Religions for Peace", to be held in Lindau, Germany, took place in Warsaw, Poland.

This international meeting was attended by representatives of women's and youth departments of Interreligious Councils of Europe.

The Department of Women at the Interreligious Council of Albania was represented by Mrs Sheldiana Jano (Agaraj), while the Youth Department was represented by Geraldo Mehmeti.



## KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË PJESËMARRËS NË TAKIMIN E BRUKSELIT

Në datat 11-13 qershor 2019 u mbajt në Bruksel, Belgjikë, takimi ndërkombëtar i Këshillit Evropian për Liderët Fetarë (ECRL-European Council of Religious Leaders), ku u zhvilluan konsultimet për Asamblenë e X-të Botërore të "Religions for Peace", e cila do të mbahet në Lindau të Gjermanisë në gusht të 2019.

Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues nga Këshillat Ndërfetarë të Europës, ndërsa në emër të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë ishte i ftuar Sekretari i Përgjithshëm Dr. Genti Kruja, i cili ndau me të pranishmit shembujt e dialogut ndërfetar në Shqipëri dhe aktivitetet e Këshillit Ndërfetar gjatë këtyre kohëve.

## INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA ATTENDS BRUSSELS MEETING

On June 11-13, the international meeting of the European Council of Religious Leaders (ECRL) was held in Brussels, Belgium, where consultations were held in preparation for the 10th World Assembly of "Religions for Peace", which will be held in Lindau, Germany, in August 2019.

This meeting was attended by representatives of European Interreligious Councils, while on behalf of the Interreligious Council of Albania, it was attended by the Secretary General, Dr. Genti Kruja, who shared the example of interfaith dialogue in Albania and the IRCA activities over the years.



## GJERMANI, KNFSH MERR PJESË NË ASAMBLENË E X BOTËRORE "FETË PËR PAQEN"

Në datat 19-23 gusht 2019 është mbajtur në Lindau të Gjermanisë, Asambleja e X Botërore "Fetë për Paqen" me pjesëmarrjen e 900 të ftuarve nga më shumë se 100 shtete të ndryshme të botës.

Asambleja me kryetitullin ***"Të kujdesemi për të ardhmen tonë të përbashkët"*** është hapur në një ceremoni solemne nga Presidenti Federal i Gjermanisë z. Frank-Walter Steinmeier, i cili ka vënë theksin në rëndësinë e dialogut dhe bashkëjetesës ndërfetare në të gjithë botën.

Vendtakimi i përfaqësuesve dhe delegatëve të ardhur nga të gjitha kontinentet për të marrë pjesë në asamble ishte zgjedhur pikërisht ishulli Lindau në liqenin e Kostancës në trekëndëshin kufitar midis Gjermanisë, Austrisë dhe Zvicrës.

Organizata "Religions for Peace" (Fetë për Paqen) është konfederata më e madhe botërore, ku aderojnë këshilla ndërfetarë, komunitete dhe bashkësi fetare nga Amerika e Veriut dhe e Jugut, Europa, Azia dhe Afrika.

Në këtë asamble botërore mori pjesë edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë me delegatët e vet kryesuar nga Dr. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i KNFSH-së.

Gjatë kësaj asambleje delegatë nga e gjithë bota kanë zgjedhur gjithashtu dhe

## GERMANY, IRCA PARTICIPATES IN THE 10TH WORLD ASSEMBLY OF "RELIGIONS FOR PEACE"

On August 19-23, 2019, the 10th World Assembly of "Religions for Peace" took place in Lindau, Germany, with the participation of 900 guests from more than 100 different countries.

The Assembly under the theme "**Caring four our Common Future**" was opened in a solemn ceremony by the Federal President of Germany, Mr Frank-Walter Steinmeier, who emphasized the importance of interfaith dialogue and coexistence worldwide.

Representatives and delegates coming from all the continents to attend the assembly gathered in the town and island of Lindau on lake Constante on the border between Germany, Austria and Switzerland.

"Religions for Peace" is the world's largest confederation, with interreligious councils and religious communities from North and South America, Europe, Asia and Africa.

The Interreligious Council of Albania participated in this assembly with its delegation headed by Dr. Genti Kruja, Secretary General of IRCA.

In the Assembly, delegates from all over the world also elected the new leaders of "Religions for Peace", with Prof Azza being elected Secretary General of "Religions for

drejtuesit e rinj të organizatës "Religions for Peace", ku në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të RfP-së është zgjedhur Prof. Azza Karam, duke pasuar Dr. William F. Vendley, i cili e mbante këtë post prej disa vitesh.

Në përfundim të asamblesë janë zgjedhur gjithashtu dhe Presidentët e Nderit, ku njëri prej figurave të spikatura ka qenë Kryetari i Këshillit Ndërfetar dhe njëkohësisht Kryepeshkopi i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë Prof. Dr. Anastas Janullatos, i cili është rizgjedhur si President Nderi i RfP-së pas zgjedhjes së mëparshme në vitin 2013 gjatë Asamblesë së IX Botërore mbajtur në Vjenë.

Për pesë ditë me radhë, gjatë datave 19-23 gusht 2019 janë mbajtur seanca të shumta rreth pesë nëntemave të trajtuara nga specialistë të fushës.

Kështu përfaqësues të lartë fetarë nga 17 besime të ndryshme janë takuar për një mision paqësor të përbashkët, ruajtjen dhe kujdesin ndaj të ardhmes së njerëzimit, duke shtyrë të gjithë faktorët fetarë, politikë, socialë, ekonomikë dhe kulturorë për të promovuar paqen dhe dialogun.

Që nga themelimi i saj më 1970 në Nju Jork, RfP ka luajtur rolin e ndërmjetësit në një sërë krizash globale të shkaktuara nga konflikti dhe lufta siç janë ai në Bosnje dhe Herzegovinë, Kosovë, Sierra Leone, Liberi, Etiopi, Kenia, Burundi, Somali, Uganda, Ruanda, Republika Demokratike e Kongos, Ugandë, Afrikë e Jugut, Sri Lanka, Tajlandë, Filipine, Myanmar, Irak, Izrael dhe Palestin, Siri, si dhe krizat pas katastrofave natyrore në Haiti, Nepal dhe Japoni.

Shqipëria nëpërmjet Këshillit Ndërfetar ka dorëzuar zyrtarisht dhe rekomandimet e veta në Asamblenë e X Botërore, të cilat kanë dalë nga Konsultimet Kombëtare të mbajtura në datat 20 dhe 27 qershor 2019 në Tiranë me pjesëmarrjen e të gjitha bordeve të KNFSH-së, ku për herë të parë janë përfshirë dhe Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë, krahas Bordit të Presidencës dhe Bordit Ekzekutiv, pasqyruar gjerësisht dhe në media, si një organizim i pari në llojin e vet.

Peace", succeeding Dr. William F. Vendley, who held the post for several years.

At the end of the assembly, Honorary Presidents were also elected, and one of the prominent figures was the Chairman of the Interreligious Council of Albania and Archbishop of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, Prof Annastasios Yannoulatos, who was re-elected Honorary President of "Religions for Peace" following his first election at the 9th World Assembly held in Vienna in 2013.

For five consecutive days, from August 19 to August 23, 2019, numerous sessions took place, focusing on five subtopics addressed by experts in the field.

Thus, senior religious representatives from 17 different religions met for a common peaceful mission, the protection of and care for the future of humanity encouraging all religious, political, social, economic and cultural factors to promote peace and dialogue.

Since its establishment in New York in 1970, Religions for Peace has been a mediator in many global crises caused by conflicts and war such as in Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Sierra Leone, Liberia, Ethiopia, Kenya, Burundi, Somalia, Uganda, Rwanda, the Democratic Republic of Congo, South Africa, Sri Lanka, Thailand, the Philippines, Myanmar, Iraq, Israel and Palestine, and Syria, as well as natural disasters aftermaths in Haiti, Nepal and Japan.

Albania officially submitted its recommendations to 10th World Assembly through the Interreligious Council. These recommendations were proposed in the National Consultations held in Tirana on June 20 and 27, 2019, with the participation of all IRCA boards, including the Department of Women and the Department of Youth, in addition to the Board of Presidency and the Executive Board, an activity widely covered in the media as the first organisation of its kind.









# KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË PJESËMARRËS NË TAKIMIN NDËRKOMBËTAR NË SHBA

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "Partneriteti multifetar dhe shumëpalësh për paqe dhe zhvillim", i mbajtur në Nju Jork në datat 10-13 dhjetor 2019.

Organizata Ndërkombëtare "Fetë për Paqen" me qendër në SHBA, në kuadër të vazhdimit të planeve të dala nga Asambleja e X-të Botërore e saj, mbajtur në Lindau të Gjermanisë në gusht 2019, ka zhvilluar një takim ndërkontinental për të folur dhe diskutuar rreth Planeve Strategjike për 5-vjeçarin e ardhshëm 2020-2025.

Në këtë takim ndërkombëtar ajo mblodhi së bashku 250 burra, gra dhe të rinj nga e gjithë bota, duke përfshirë edhe 50 studiues të dialogut ndërfetar, përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe këshillave ndërfetare nga vende të ndryshme të botës.

Në këtë takim ishte i ftuar edhe Dr. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, i cili gjatë takimeve vuri theksin mbi modelin e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri, rolin që luajnë komunitetet fetare për forcimin dhe promovimin e këtij fryme dhe punën, që po bën Këshilli Ndërfetar në këtë fushë.

# INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA ATTENDS AN INTERNATIONAL MEETING IN THE USA

The Interreligious Council of Albania participated in the international conference "Multi-religious and multi-stakeholder partnership for peace and development", which took place in New York, on December 10-13, 2019.

Further to the conclusions of its 10th World Assembly held in Lindau Germany, in August 2019, the US-based international organisation "Religions for Peace", convened an international meeting to discuss the 2020-2025 Strategic Plan.

This international meeting brought together 250 men, women and young people from all over the world, including 50 researchers in interfaith dialogue, representatives of government institutions and interreligious councils from all around the world.

The meeting was also attended by Dr. Genti Kruja, Secretary General of the Interreligious Council of Albania, who emphasized the Albanian model of religious harmony and coexistence, the role played by religious communities to strengthen and promote this spirit and the work that the Interreligious Council is doing in this area.

# KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË TAKIM ME DEPARTAMENTIN E SHTETIT DHE ALEANCËN NDËRKOMBËTARE PËR LIRINË E BESIMIT

Përfaqësues dhe drejtues nga Këshillat Ndërfetarë të vendeve të ndryshme nga e gjithë bota janë bashkuar me dt. 12 maj në një takim online me Ambasadorin Sam Brownback nga Departamenti i Shtetit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të diskutuar lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, një nga prioritetet strategjike edhe të OKB-së.

Ky takim, i realizuar nga organizata ndërkombëtare "Fetë për Paqen" (Religons for Peace) në bashkëpunim me "Aleancën Ndërkombëtare për Lirinë e Besimit" në SHBA, është zhvilluar për të folur dhe diskutuar për një dialog mbi rolet dhe përgjegjësitë, që udhëheqësit fetarë do të duhet të luajnë për të mbrojtur lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Mes të ftuarve për pjesëmarrje ishte edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KNFSH-së Dr. Genti Kruja.

"Aleanca Ndërkombëtare për Lirinë e Besimit" është një rrjet i vendeve të përkushtuara për të përparuar në lirinë e besimit në të gjithë botën dhe për të luftuar diskriminimin dhe persekutimin bazuar në fe ose besim.

Aleanca është themeluar mbi parimin ndër-kombëtar të lirisë së fesë ose besimit, bazuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit Bazuar në Fe ose Besim (Deklarata e OKB, 1981) dhe dokumente të tjera si, Udhëzimet e BE-së dhe OSBE-së.

Një nga 26 vendet që i janë bashkuar kësaj aleance është edhe Shqipëria, krahas shteteve të tilla si, Austria, Kroacia, Greqia, Izraeli, Kosova, Hollanda, Mbretëria e Bashkuar, etj.




# INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA, MEETING WITH THE DEPARTMENT OF STATE AND INTERNATIONAL ALLIANCE FOR FREEDOM OF BELIEF

Representatives and leaders from Interreligious Councils of different countries from all around the world, joined an online meeting with Ambassador Sam Brownback from the US State Department, to discuss freedom of thought, conscience and religion, one of the UN's strategic priorities.

This meeting, organised by the international organisation "Religions for 'Peace" in cooperation with the "International Alliance for Freedom of Faith", was held to discuss on a dialogue on the roles and responsibilities of religious leaders to protect freedom of thought, conscience and faith.

The Interreligious Council of Albania participated in this event represented by the Secretary General, Dr. Genti Kruja.

"International Alliance for Freedom of Faith" is a network of countries committed to advancing freedom of thought worldwide and to fighting discrimination and persecution based on religious grounds.

The Alliance was established on the internation-al principle of freedom of religion and faith, based on the Universal Declaration of Human Rights, the International Covenant on Civil and Political Rights, the UN Declaration on the Elimination of all Forms of Intolerance and Discrimination based on Religion or Belief (UN Declaration, 1981) and other documents such as UN and OSCE guidelines.

One of the 26 countries that joined this Alliance was Albania along with countries such as Austria, Croatia, Greece, Israel, Kosovo, the Netherlands, the United Kingdom, etc.




## DEPARTAMENTI I GRUAS NË KËSHILLIN NDËRFETAR TË SHQIPËRISË TAKIM ONLINE ME FORUMET NDËRKOMBËTARE TË GRUAS NË BOTË

Drejtues dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare si, "Fetë për Paqen", "Të Drejtat e Njeriut" e Kombeve të Bashkuara dhe "Komiteti për Zhdukjen e Diskriminimit Kundër Grave" (#CEDAW) ndanë me dt. 14 maj 2020 në një takim online, njohuritë dhe praktikat më të mira për një përgjigje ndaj çështjeve gjinore dhe problemet e gruas në të gjithë botën.

Krahas panelisteve nga e gjithë bota, nga Shqipëria merrnin pjesë edhe përfaqësuese të Departamentit të Gruas nga Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, Shelda Agaraj, Lorela Sula, Sonila Rembeci, Jeta Deda, Ravesa Nano, dhe Elona Prroj, të cilat përfaqësojnë njëkohësisht të gjithë komunitetet fetare në vendin tonë.

## DEPARTMENT OF WOMEN OF THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA MEETS ONLINE WITH INTERNATIONAL WOMEN'S FORUMS

Leaders and representatives of various international organisations such as "Religions for peace", "The UN High commissionaire for Human Rights", and the Committee for the Elimination of Discrimination against Women (CEDAW) shared the best knowledge and practices for a response to gender issues and problems of women all over the world, in an online meeting on May 14, 2020.

In addition to representatives from all over the world, the meeting was attended by members of the Department of Women at the Interreligious Council of Albania, Shelda Agaraj, Lorela Sula, Sonila Rembeci, Jeta Deda, Ravesa Nano, and Elona Prroj, who also represented all the religious communities in the country.

# Deklarata të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë

# Statements of the Interreligious Council of Albania

## TIRANË, MË 14 NËNTOR 2013
## DEKLARATË PËR SHTYP LIDHUR ME ARMËT KIMIKE

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, (Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike e Shqipërisë dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane) si dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, jemi duke ndjekur me shumë shqetësim zhvillimet e fundit politike dhe shoqërore, të cilat po marrin një karakter gjithnjë e më popullor, në lidhje me importin dhe shkatërrimin e armëve kimike në Shqipëri. Në lidhje me këtë çështje do të donim t'ju bashkoheshim këtyre shqetësimeve, duke parë rrezikun dhe përmasat që përmban një çështje e tillë.

Vendin tonë Zoti e ka bekuar me shumë pasuri dhe burime natyrore, por ai prej vitesh po vuan nga trajtimi dhe shfrytëzimi i pa kriter që po i bëhet, duke çuar në shkatërrimin e sipërfaqeve të tëra pyjore dhe kullotave si dhe në ndotjen e tokës, ujërave dhe ajrit. Deri më tani është bërë shumë pak për të ndalur këtë katastrofë natyrore, ndërkohë që ndërgjegjësimi qytetar mbi këto çështje lë shumë për të dëshiruar. Kësaj situate të trishtë i shtohet edhe ngjarja tragjike e shpërthimit të fabrikës së demontimit të armatimeve ushtarake në fshatin Gërdec, shumë pranë kryeqytetit të vendit.

Jemi të mendimit se vendi ynë është shumë larg diskutimit dhe për më tepër realizmit të një ndërmarrje të tillë, si ai i depozitimit dhe shkatërrimit të armëve kimike këtu, ku siç duket, jo vetëm që shtetit i mungojnë kapacitetet e nevojshme për një sipërmarrje të tillë, por gjithashtu një gjë e tillë mund të përbënte një precedent shumë të keq në të ardhmen që vendi ynë të kthehej në një "depo" e mbeturinave dhe plehrave të rrezikshme.

Për këto arsye dhe të tjera që janë shprehur këto ditë me të drejtë nga shoqëria civile, i kërkojmë shtetit shqiptar, politikanëve dhe autoriteteve të vendit që të refuzojnë absolutisht, tani e tutje, pranimin e armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre në vendin tonë si dhe të angazhohemi të gjithë së bashku në ndërgjegjësimin dhe ruajtjen e shtëpisë sonë të përbashkët, Shqipërisë.

## TIRANA, NOVEMBER 14, 2013
## PRESS STATEMENT ON CHEMICAL WEAPONS

The Interreligious Council of Albania (the Muslim Community of Albania, the Orthodox Autocephalous Church of Albania, the Catholic Church of Albania and the Bektashi World Order) as well as the Evangelical Brotherhood of Albania are following with great concern the latest political and social developments, which are taking on an increasingly popular character, regarding the import and destruction of chemical weapons in Albania. Seeing the danger and the extent of such an issue, we would like to join the concerns in this regard.

God has blessed our country with many natural riches and resources, but for years, it has been suffering from indiscriminate treatment and exploitation, leading to the destruction of entire forest areas and pastures as well as the pollution of land, water and air. So far, little has been done to stop this natural disaster, while civic awareness of such issues leaves a lot to be desired. This sad situation was added the tragic event of the explosion of the military weapons dismantling factory in Gërdec, a village quite close to the country's capital.

We are of the opinion that our country is far from discussing and, let alone, accomplishing such an enterprise as disposal and destruction of chemical weapons here, where, apparently, not only does the state lack the necessary capacities for such an enterprise, but such an act could also set a precedent for turning our country into a "warehouse" of hazardous waste and garbage.

For these and other reasons articulated by civil society, we call on the Albanian state, politicians and authorities to absolutely refuse, from now on, the acceptance of chemical weapons and their destruction in our country and to engage altogether in raising awareness and preserving our common home, Albania.

# KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË DËNON ME FORCË KRIMET E ISIS

*Bashkësitë fetare në Shqipëri përmes Këshillit Ndërfetar kanë dalë në një deklaratë të përbashkët duke dënuar krimet që po kryhen nga ISIS në Irak. Ndërkohë ata i bëjnë apel Faktorit Ndërkombëtar, që të gjejë zgjidhjet e duhura në mënyrë që të ndalet ky fenomen.*

Gjithashtu shprehim solidaritet me të gjithë ata që vuajnë jo vetëm në Irak, por në të gjitha vatrat e konfliktit në Lindjen e Mesme.

## Deklarata e plotë e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dhe anëtarët e tij, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike e Shqipërisë dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane, mbështetur dhe nga Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, po ndjekin me shqetësim situatën, që po ndodh këto ditë në Lindjen e Mesme, në mënyrë të veçantë përndjekjen kriminale, që terroristët e ISIS në Irak po ushtrojnë ndaj popullsisë lokale të krishterë, madje edhe ndaj myslimanëve dhe minoriteteve të tjera, e në mënyrë mizore përndjekjen dhe dëbimin e detyruar me dhunë të të krishterëve irakenë dhe të irakenëve të feve të tjera prej vendit të tyre. Ne dënojmë me forcë akte të tilla kriminale, që nuk kanë asgjë të përbashkët me parimet themelore të besimeve tona.

Lusim Zotin, i Cili na ka krijuar të gjithëve që t'u kthejë paqen dhe dinjitetin atyre zonave. Në emër të Zotit kërkojmë të ulen armët e të kërkohet paqe dhe bashkëjetesë.

I bëjmë gjithashtu apel Faktorit Ndërkombëtar, që të gjejë zgjidhjet e duhura në mënyrë që të ndalet fenomeni i largimit dhe i shpërnguljes me dhunë të banorëve të Mosulit dhe të rrethinave për shkak të besimit të tyre. Ne besojmë ngultësisht se e drejta e besimit është një e drejtë themelore e njeriut. Ne i gëzohemi kësaj të drejte në Shqipëri dhe një realiteti, që besimet fetare kanë ndërtuar e vazhdojnë të ndërtojnë me shumë mund në vendin tonë. Duam t'u themi të gjithëve se është e mundur të jetojmë

# INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA STRONGLY CONDEMNS ISIS CRIMES

*Religious communities in Albania have released a joint statement, through the Interreligious Council of Albania, condemning the crimes being committed in Iraq by ISIS. Meanwhile, they appeal to the International Factor to find the right solutions in order to stop this phenomenon.*

We also express solidarity with those who suffer not only in Iraq but in all hot spots of conflict in the Middle East.

## Full statement of the Interreligious Council of Albania

The Interreligious Council of Albania and its members, the Muslim Community of Albania, the Orthodox Autocephalous Church of Albania, the Catholic Church of Albania and the Bektashi World Order, supported by the Evangelical Brotherhood of Albania, are following with great concern the situation in the Middle East, in particular, the criminal persecution of the local Christian population by ISIS terrorists, and, even the Muslim and other minorities, as well as the cruel displacement of Iraqi Christians and Iraqis of other religions. We strongly condemn such criminal acts, which have nothing in common with the essential principles of our beliefs.

We pray to God, who created us all, to return peace and dignity to those regions. In the name of God, we call for weapons to be put down and for peace and coexistence to be sought.

We also appeal to the International Factor to find the right solutions in order to stop the phenomenon of forced displacement of the people of Mosul and its environs because of their faiths. We firmly believe that the right to religion is a fundamental human right. We rejoice at this right in Albania, a reality that religious beliefs have built and continue to build with great effort in our country. We want to tell everyone that it is

bashkë, duke ndihmuar njëri-tjetrin e duke respektuar njëri-tjetrin pavarësisht besimit, etnisë apo racës.

Ndërkohë shprehim solidaritetin tonë me të gjithë ata që vuajnë, jo vetëm në Irak, por në të gjitha vatrat e konfliktit në Lindjen e Mesme e u sigurojmë atyre lutjen dhe afërsinë tonë shpirtërore.

**2014**

possible to live together helping each other and respecting each other regardless of religion, ethnicity or race.

In the meantime, we express our solidarity with those who suffer not only in Iraq but in all hot spots of conflict in the Middle East and assure them of our prayer and spiritual closeness.

**2014**



## DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR VEPRIME TË KOORDINUARA NË LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRUAS DHE DHUNËS NË FAMILJE

**MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË,** në cilësinë e autoritetit përgjegjës për koordinimin e veprimeve për barazinë gjinore dhe kundër dhunës ndaj grave e dhunës në familje dhe përfaqësuesit e **KOMUNITETEVE FETARE** në Shqipëri,

- duke njohur dhe pranuar detyrimin e shtetit për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas të gjitha akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi;

- duke besuar dhe vlerësuar bashkëjetesën e tolerancën fetare si një vlerë, jo vetëm historike, por edhe aktuale të shoqërisë sonë dhe si një ndër elementët kyç për t'iu kundërvënë bashkarisht ndaj dhunës,

- duke e trajtuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, si shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, ndaj të cilave të gjithë duhet të reagojnë me përgjegjshmëri, seriozitet e profesionalizëm;

- duke vlerësuar efektivitetin e përpjekjeve të përbashkëta e të mirëkoordinuara, si dhe kontibutin e rëndësishëm të të gjithë aktorëve për një shoqëri në paqe, tolerancë e pa dhunë;

## JOINT STATEMENT ON COORDINATED ACTION IN THE FIGHT AGAINST VIOLENCE AGAINST WOMEN AND DOMESTIC VIOLENCE

**THE MINISTRY OF SOCIAL WELFARE AND YOUTH,** in the capacity of the authority responsible for coordinating actions for gender equality and against violence against women and domestic violence, and representatives of **RELIGIOUS COMMUNITIES** in Albania,

- Recognizing and accepting the obligation of the state to promote and protect fundamental human rights and freedoms, in accordance with all international acts and applicable law;

- Believing and appreciating religious coexistence and tolerance not only as a historical but also as a current value of our society and as one of the key elements to jointly opposing violence;

- Considering violence against women and domestic violence as serious human rights violations, to which everyone must respond responsibly, seriously and professionally;

- Appreciating the effectiveness of joint and well-coordinated efforts, as well as the important contribution of all actors to a society living in peace, tolerance and non-violence;

## BASHKOHEN NJËZËRI DHE ANGAZHOHEN PËR:

- Planifikimin e veprimeve të koordinuara në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje,

- Mbështetjen dhe lehtësimin e veprimeve kombëtare edukuese për rëndësinë e krijimit të familjeve të shëndosha, ku mbizotëron paqja, respekti, dashuria, vlerësimi dhe mundësitë e barabarta për secilën(in) anëtar(e) të saj,

- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe komuniteteve fetare, për të nxitur pjesëmarrjen e sa më shumë të rinjve dhe të rejave besimtarë, në koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve të tilla,

- Organizimin e aktiviteteve të veçanta me komunitetet e besimtarëve Myslimanë, Ortodoksë, Katolikë, Bektashianë e Ungjëllorë, me synim transmetimin e sa më shumë ***mesazheve të përbashkëta*** kundër dhunës ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje,

- Identifikimin e djemve dhe burrave besimtarë, që mbështesin qëllimin e kësaj deklarate dhe angazhohen për të sjellë ndryshim në komunitet,

- Planifikimin e një jave kombëtare (ose një dite në muaj), të lutjeve për viktimat, dëshmitarët dhe autorët e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në kuadër të fushatave të përvitshme të ndërgjegjësimit të publikut, që organizohen për këtë qëllim,

- Organizimin e lëvizjes "Lutja e Burrave", përmes së cilës burrat e përkatësive të ndryshme fetare të mund të mblidhen nëpër xhami, kisha dhe hapësira të tjera fetare, për t'u lutur për t'i dhënë fund dhunës, për të gjetur forca për të ruajtur paqen në familje dhe për të shprehur angazhimin e tyre për sigurinë dhe fuqizimin e grave,

- Nxitjen e liderëve fetarë për të mbështetur dhe promovuar edukimin e besimtarëve në mbarë vendin me vlerat e tolerancës, respektit dhe kundër dhunës e diskriminimit, duke u angazhuar publikisht në fushatën "Ai për Atë" ("HeforShe").

- Harmonizimin e zhvillimit të aktiviteteve të sipërpërmendura (si dhe të aktiviteteve të tjera, që mund të planifikohen në vazhdimësi) me aktivitetet e planifikuara në ditë të shënuara fetare (Bajram, Pashkë, Krishtlindje, Nevruz, etj),

- Vlerësimin e hapave të ndërmarrë dhe forcimin e bashkëpunimit përmes shkëmbimit të eksperiencave në aktivitete të përbashkëta të përvitshme,

- Vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme njerëzore e financiare për t'u përkushtuar maksimalisht në arritjen e qëllimeve të kësaj deklarate,

- Shkëmbimin e informacionit mbi shërbimet e ngritura, apo që mund të ngrihen nga komunitetet fetare në mbështetje të grave dhe vajzave, apo individëve në nevojë, dhe aplikimin e standarteve të duhura në ofrimin e këtyre shërbimeve.

## UNITE AND ARE COMMITTED TO:

- Planning coordinated actions in the fight against violence against women and domestic violence,

- Supporting and facilitating national educational activities for the importance of creating healthy families, in which peace, respect, love, appreciation and equal opportunities for each member prevail,

- Organizing joint activities between the Ministry of Social Welfare and Youth and religious communities, to encourage the participation of as many young men and women believers in the organization and implementation of such activities,

- Organizing special activities with the communities of Muslim, Orthodox, Catholic, Bektashi and Evangelical believers, with the aim of communicating common messages against violence against women and girls and domestic violence,

- Identifying believing boys and men who support the purpose of this statement and are committed to bringing about change in the community,

- Planning a national week (or one day a month) of prayers for victims, witnesses and perpetrators of violence against women and domestic violence, as part of the annual public awareness campaigns organized for this purpose,

- Organizing "Men's Prayer" movement, through which men of different religious affiliations can gather in mosques, churches and other religious spaces to pray for an end to violence, to find the strength to maintain peace in the family and to express their commitment to women's safety and empowerment,

- Encouraging religious leaders to support and promote the education of believers throughout the country with the values of tolerance, respect, and against violence and discrimination, by publicly engaging in the "HeforShe" campaign,

- Harmonizing the organization of the above-mentioned activities (as well as other activities that can be further planned) with activities planned for religious holidays (Eid, Easter, Christmas, Nevruz, etc.),

- Evaluating the steps already taken and strengthening cooperation through exchange of experience in joint annual activities,

- Providing the necessary human and financial resources to be highly committed to achieving the goals of this statement,

- Exchanging information on services already established or that can be established by religious communities in support of women and girls or people in need, and applying appropriate standards in the provision of these services.

Ne besojmë dhe promovojmë vlerat e një familjeje të shëndoshë, ku nëna, bija, motra, bashkëshortja respektohen dhe nuk dhunohen, ku fëmijët rriten me dashuri dhe përkushtim, ku të moshuarit, apo të sëmurët ndjehen të rrethuar me mbështetje e kujdes, ku përcillet mirënjohje, pranim, harmoni, vlerësim, tolerancë, dinjitet e barazi!

Prandaj, të bindur se veprimet kundër dhunës në familje janë rruga drejt paqes në shoqëri, ne angazhohemi të bëjmë realitet përpjekjet tona të përbashkëta TANI!

**Tiranë, 25 Nëntor 2015**

**H. SKENDER BRUÇAJ,**
**Kryetari i Komunitetit Mysliman**

**FORTLUMTURIA E TIJ ANASTAS JANULLATOS,**
**Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë**

**MONS. RROK MIRDITA,**
**Arqipeshkv i Arqipeshkvisë Tiranë-Durrës**

**H. DEDE EDMOND BRAHIMAJ,**
**Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve**

**Z. BLENDI KLOSI,**
**Ministër i MMSR**

We believe in and promote the values of a healthy family, in which the mother, the daughter, the sister and the wife are respected and not raped, in which children are brought up with love and devotion, in which the elderly or the sick feel surrounded by support and care, in which gratitude, acceptance, harmony, appreciation, tolerance, dignity and equality are conveyed.

Therefore, convinced that action against violence against women and domestic violence is the path towards peace in society, we are committed to accomplishing our joint efforts NOW!

**Tirana, November 25, 2015**

**H. SKENDER BRUÇAJ,**
**Muslim Community of Albania**

**HIS BEATITUDE ANASTASIOS YANNULATOUS,**
**Archbishop of Tirana, Durres and all Albania**

**MONS. RROK MIRDITA,**
**Archbishop of the Archdiocese of Tirana-Durres**

**H. DEDE EDMOND BRAHIMAJ,**
**Bektashi World Leader**

**MR. BLENDI KLOSI,**
**Minister of Social Welfare and Youth**

## KOMUNITETET FETARE, THIRRJE PËR QETËSI: DIALOGONI, JO DHUNË

Ne, Komunitetet Fetare në Shqipëri, Komuniteti Mysliman, Kisha Ortodokse Autoqefale, Kisha Katolike, Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve dhe Vëllazëria Ungjillore, në përputhje me natyrën e veprimtarisë tonë shpirtërore, ndiejmë përgjegjësinë shpirtërore dhe morale, që kemi për besimtarët tanë, por edhe për shoqërinë shqiptare në përgjithësi.

Me anë të kësaj deklarate të përbashkët, duke u nisur edhe nga situatat e fundit të krijuara, ashtu sikurse edhe në ndonjë rast në të kaluarën, dëshirojmë t'i drejtohemi klasës politike dhe të gjithë atyre që kanë përgjegjësi institucionale për të mirën e vendit.

Nuk është detyra jonë të gjejmë apo të tregojmë zgjidhje konkrete për situatën e krijuar. Ajo është punë e politikës, e cila ka fushën e saj të veprimit dhe është e mandatuar nga populli për këtë gjë.

Falënderojmë Zotin për shumë punë të mira që janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen, si edhe për seriozitetin e shumë njerëzve, që punojnë pa u lodhur edhe pse shpesh të panjohur, në zbatim të ligjit e për të mirën e shoqërisë.

Por gjithashtu, ne jemi të shqetësuar për klimën e krijuar në vend e në mënyrë të veçantë:

• për mungesën e dialogut politik dhe të vullnetit për dialog për zgjidhjen e ngërçeve, sidomos për çështjen e zgjedhjeve, që janë një instrument i domosdoshëm për mirëqenien shoqërore të shqiptarëve;

• për retorikën e dhunshme dhe përçmuese, që përcillet nëpërmjet kanaleve të informimit publik dhe në rrjetet sociale nga ana e atyre që mbajnë poste apo kanë pozicione publike dhe të rëndësishme në jetën e vendit;

• për dukuritë e korrupsionit dhe të prodhimit të lëndëve narkotike, që dëmtojnë sot dhe në të ardhmen jetën e qytetarëve dhe mirëqenien e tyre;

Të gjitha këto që u thanë më sipër mund të rrezikojnë stabilitetin e vendit, që për ne është një e mirë e madhe për të gjithë shoqërinë e për çdo njeri dhe që duhet ta ruajmë

## RELIGIOUS COMMUNITIES CALL FOR CALM: DIALOGUE, NOT VIOLENCE

We, the religious communities in Albania, the Muslim Community, The Orthodox Autocephalous Church, the Catholic Church, the Bektashi World Headquarters and the Evangelical Brotherhood, in accordance with the spiritual nature of our activity, feel the moral and spiritual responsibility we have for our believers and for the Albanian society in general.

Through this statement, based on the situation created lately, as in any case in the past, we would like to address the political class and everyone who has institutional responsibility for the good of the country.

It is not our duty to find or show concrete solutions to the created situation. It is the duty of politics and its field of action; it has been mandated to do this by the people.

We thank God for the good work that has been done and continues to be done, as well as for the seriousness of many people, who work tirelessly, although very often they remain unknown, in accordance with the law for the good of society.

However, we are also concerned about the climate created in the country and in particular:

• about the lack of dialogue and the willingness to dialogue on the resolution of stalemates, in particular the issue of elections, which are a necessary instrument for the social welfare of Albanians;

• about the violent and contemptuous rhetoric which is transmitted through public information channels and social networks by those who hold public posts or important positions in the life of the country;

• about the phenomena of corruption and production of narcotics, which harm the lives of citizens and their well-being in the present and in the future;

All of the above can jeopardize the country's stability, which for us is a great good for the whole society and for every individual and which we must preserve at all costs.

me çdo kusht. Prandaj, ne ftojmë me ngulm dhe me forcë të gjithë faktorët politikë në Shqipëri, nga ana e opozitës dhe e qeverisë, parti të vogla e të mëdha:

• për ndërtimin e urave dhe jo të mureve. Duhet një dialog i sinqertë, i bërë në shumë nivele, duke përfshirë sa më shumë aktorë dhe faktorë. Keni përgjegjësi përpara popullit dhe duhet të mendoni për të qysh nga dita, që keni marrë përsipër të hyni në politikë. E mira e popullit është synimi juaj madhor.

• për uljen e toneve të retorikës së dhunshme dhe përçmuese ndaj kundërshtarit politik. Kjo vetëm nxeh gjakrat dhe nxit veprime të dhunshme.

• për garantimin e një procesi parazgjedhor dhe zgjedhor transparent dhe gjithëpërfshirës. Në mënyrë të veçantë e sidomos u bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të mos bien pre e tundimit të shitblerjes së votës, apo të votimit nën kërcënim për vendin e punës, që është buka e fëmijëve. Gjithashtu, u bëjmë thirrje të gjitha institucioneve, që kanë përgjegjësi për zgjedhjet, që të luftojnë të gjithë dukurinë e shitblerjes së votës dhe kërcënimit për vendin e punës.

• për krijimin e kushteve, që ligji dhe e drejta të sundojë në jetën shoqërore të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Po ashtu bëjmë thirrje që çdo nismë qytetare dhe politike për të shprehur mendimin dhe dëshirat të shërbejë për të mirën e përbashkët dhe të shmangë çdo lloj dhune ndaj njerëzve, objekteve dhe institucioneve.

Të bindur se me anë të kësaj deklarate po japim një kontribut për mbarëvajtjen e vendit, ne do të vazhdojmë të lutemi për të ardhmen dhe mirëqenien e vendit tonë.

**12/05/2017**

Therefore, we strongly and firmly call on all the political factors in Albania, on the side of the opposition and the government, large and small parties:

• To build bridges not walls. This takes a sincere dialogue, on many levels, including as many actors and factors as possible. You are responsible to the people and have to think about this on the very first day you decide to go into politics. The good of the people is your major goal.

• To reduce the tones of violent and contemptuous rhetoric towards the political opponent. This only increases tensions and promotes violent action.

• To guarantee a transparent and all-inclusive pre-election and election process. In particular, we call on all citizens not to fall prey to the temptation of buying and selling their votes or of voting under the threat of losing their job, which is their children's daily bread. We also call on all the institutions responsible for elections to fight all the phenomena of vote-buying and threatening with job loss.

• To create conditions for the rule of law in the social life of Albanians and Albania. We also call on every civic or political initiative to express their views and wishes, to serve the common good and to avoid any kind of violence against people, objects or institutions.

Convinced that through this statement we are making a contribution to the well-being of the country, we will continue to pray for the future and well-being of our country.

**12/05/2017**



## KRERËT E BASHKËSIVE FETARE APEL GJERMANISË DHE FRANCËS PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE

Në një letër të përbashkët drejtuar Kancelares gjermane Angela Merkel dhe Presidentit francez Emmanuel Macron, krerët e bashkësive fetare në Shqipëri, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skender Bruçaj, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë Anastasi, Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës Ipeshkvnore Katolike dhe Arqipeshkëv i Rrëshenit, Dom Gjergj Meta, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj dhe Presidenti i Vëllazërisë Ungjillore, Pastor Ylli Doçi, bëjnë apel për një vendim pozitiv për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

Letra iu dorëzua Ministrit Ditmir Bushati me dt. 18 qershor 2018 nga drejtuesit e këtyre komuniteteve, në një takim në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

"Në këtë moment të një rëndësie të madhe, dëshirojmë të theksojmë edhe një herë atë që kemi shprehur kohët e fundit në deklaratën tonë të përbashkët të datës 21 prill 2018: ne shqiptarët jemi pjesë e Evropës. Ne jemi pjesë e një historie që shtrihet në origjinën e Evropës. Është një histori, që ka rrënjë mijëra vjeçare. Rrënjë të përbashkëta kulturore dhe sociale na lidhin. Jemi të bindur se rruga drejt Bashkimit Evropian përfaqëson dëshirën e kahershme të njerëzve tanë, si edhe vlerat e një shoqërie të lirë ku çdokush

## LEADERS OF RELIGIOUS COMMUNITIES APPEAL TO GERMANY AND FRANCE TO OPEN NEGOTIATIONS

In a joint letter to German Chancellor Angela Merkel and French President Emmanuel Macron, heads of religious communities of Albania, head of the Muslim Community of Albania, H. Skender Bruçaj, Archbishop of Tirana, Durres and all Albania, Anastasios Yannulatous, the Secretary General of the Catholic Episcopal Conference of Albania and Archbishop of Rrëshen, Dom Gjergj Meta, the Bektashi World Leader, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, and the President of the Evangelical Brotherhood, Pastor Ylli Doçi, appeal for a positive decision on opening of accession talks on Albania's EU membership.

The letter was delivered to Minister Ditmir Bushati on June 18, 2018 by the leaders of these communities, in a meeting at the Ministry of Europe and Foreign Affairs.

"At this moment of great historical significance, we wish to once again underscore what we recently articulated in our joint statement of April 21, 2018: we, Albanians, are part of Europe. We are part of a history that stretches back to the origins of Europe. It is a history that goes back thousands of years. Our common cultural and social roots bind us together. We believe that our path to the European Union represents the long-standing desire of our people and the values of a free society where everyone can exercise their rights, among which the right to freedom of religion and belief is essential. We are grateful

mund të ushtrojë të drejtat e tij e ndër to, e drejta e lirisë dhe e besimit fetar është thelbësore. Ne i jemi mirënjohës Zotit për faktin se historia e popullit shqiptar ka treguar një jetëgjatësi të qëndrueshme të vlerës së respektit për dallimin fetar, duke jetuar së bashku në harmoni si një familje.

Rruga drejt Bashkimit Evropian është veçanërisht kritike për rininë tonë. Të rinjtë shqiptarë renditen mes euro-entuziastëve më të fuqishëm, e megjithatë ata ndjehen më të frustruar, sepse edhe pse jetojnë pranë shokëve të tyre evropianë, janë të përjashtuar nga të njëjtat mundësi. Ju bëjmë thirrje të pranoni dëshirën e sinqertë të të gjithë shqiptarëve dhe të na mbështesni në angazhimin tonë të pakthyeshëm për një Shqipëri, si pjesë e Evropës.

Me lutje të zjarrtë, ne riafirmojmë angazhimin tonë për të mbetur mbështetës të palëkundur të vlerave evropiane të një shoqërie me liri, drejtësi dhe prosperitet për të gjithë", thuhet ndër të tjera në letrën që u hartua dhe u nënshkrua nga drejtuesit e bashkësive fetare.

"Ju keni dhënë shembullin më kuptimplotë që ne jemi evropianë dhe tani është momenti i duhur për secilin prej nesh të ndjekim shembullim tuaj" - u shpreh Ministri Bushati.

to God that the history of the Albanian people has revealed a consistent longevity of the value of respect for religious difference living together in harmony as one family.

The road to the European Union is particularly critical for our youth. Albanian young people are among the most Euro-enthusiastic, and yet they are also among the most frustrated as although they live in close proximity to their European peers, they are excluded from the same opportunities. We call upon you to recognise the earnest desire of all Albanians and to support us in our irreversible commitment to an Albania, as part of Europe.

With fervent prayer we reaffirm our commitment to remain steadfast supporters of European values of a society with freedom, prosperity and justice for all." reads the letter drafted and signed by the leaders of religious communities.

"You have given the most meaningful example that we are Europeans and now it is the right time for each of us follow this example" – Minister Bushati stated.

## DEKLARATË E KOMUNITETEVE FETARE ANGAZHIMI I PËRBASHKËT PËR DIALOGUN NDËRFETAR

Ne, **Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike e Shqipërisë, Komuniteti Bektashian** dhe **Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë** jemi krenarë për historinë e bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare në Shqipëri ndër shekuj.

Mirëkuptimi dhe bashkëjetesa fetare brenda kombit tonë ka krijuar ndër vite një mozaik të bukur të diversitetit. Ne jemi të bindur se ky mozaik nuk duhet konsideruar i mirëqenë dhe angazhohemi të kujdesemi për të, duke mbajtur të bashkuar pjesët e tij, me qëllim që të ruajmë dhe të prezantojmë me dinjitet këtë pasuri të kombit tonë brenda dhe jashtë vendit.

Ne jemi të vetëdijshëm dhe pranojmë se komunitetet tona fetare, kanë identitetin e tyre dhe se secili mbetet besnik ndaj parimeve të besimit të tij. Por megjithatë dallimet tona fetare nuk na pengojnë për t'u angazhuar në respektin e ndërsjellë, bashkëpunimin në fushat sociale dhe në dialogun aktiv midis komuniteteve tona dhe mbarë shoqërisë me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave morale, etike dhe kulturore.

Ne vlerësojmë komunikimin, si mjet për t'u njohur më nga afër me njëri-tjetrin, për ndërtimin e respektit të ndërsjelltë, si dhe për shmangien e paragjykimeve. Për këtë arsye ne angazhohemi për sa më poshtë:

- ***Të zhvillojmë dialogun e jetës**, duke inkurajuar anëtarët e komuniteteve tona, por edhe shoqërinë në përgjithësi të jetojnë në paqe dhe në fqinjësi të mirë, duke ndarë gëzimin dhe trishtimin, sfidat dhe shpresat me njëri-tjetrin.*

- ***Të zhvillojmë veprimtari të përbashkëta për të mirën e shoqërisë,** duke u angazhuar në iniciativa, sipërmarrje dhe projekte për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe nëpërmjet këtyre angazhimeve në të njëjtën kohë të ushqejmë harmoninë, tolerancën, bashkëjetesën, drejtësinë dhe paqen në komunitetet tona.*

- ***Të ndërtojmë platformën e dialogut teologjik ne nivel akademik,** duke u njohur me*

## STATEMENT OF RELIGIOUS COMMUNITIES JOINT COMMITMENT TO INTERFAITH DIALOGUE

We, **The Muslim Community of Albania**, **the Orthodox Autocephalous Church of Albania, the Catholic Church of Albania, the Bektashi World Headquarters and the Evangelical Brotherhood of Albania** are proud of the history of interfaith coexistence and harmony in Albania over centuries.

Religious understanding and coexistence within our nation has over the years created a beautiful mosaic of diversity. We believe that this mosaic should not be taken for granted and we are committed to taking care of it, by keeping its parts together in order to preserve and present with dignity this asset of our nation at home and abroad.

We are aware and accept that our religious communities have their own identities and everyone remains faithful to the principles of his/her faith. However, our religious differences do not prevent us from engaging in mutual respect, cooperation in social areas and active dialogue between communities and society as a whole in order to preserve and promote moral, ethical and cultural values.

We value communication as a means of getting to know one another better, building mutual respect and avoiding prejudice. For this reason, we are committed to the following:

- ***To developing a dialogue of life**, encouraging members of our communities and the society in general, to live in peace and good neighbourliness, sharing the joy and sadness, challenges and hopes with one another.*

- ***To organising joint activities for the good of society,** engaging in initiatives, undertakings and projects for the enhancement of the quality of life and the progress of Albanian society and through these commitments to also nurture harmony, tolerance, justice and peace in our communities.*

- ***To building a platform of theological dialogue at the academic level,** getting acquainted with one another's spiritual values, the mutual history and common points in order to promote a spirit of dialogue and brotherhood within our communities avoiding everything that may incite interfaith hatred or misunderstandings.*

- ***To developing joint educational strategies** to promote and nurture the young genera-*

*vlerat shpirtërore të njëri-tjetrit, historinë e ndërsjelltë dhe pikat e përbashkëta, me qëllim promovimin e frymës së dialogut dhe asaj vëllazërore brenda komuniteteve tona, duke shmangur çdo gjë, që mund të nxisë urrejtje dhe keqkuptime ndërfetare.*

• ***Të zhvillojmë strategji të të përbashkëta arsimore dhe edukative*** për të promovuar dhe ushqyer brezit të ri vlerat e bashkëjetesës dhe dialogur *ndërfetar, për të parandaluar çdo formë manipulimi dhe instrumentalizimi të fesë në shërbim të interesave jofetare.*

• ***Të promovojmë në arenën ndërkombëtare,*** *me të gjitha mënyrat, vlerën e bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare në Shqipëri, si një model i domosdoshëm për mbarë shoqërinë botërore, e cila në mënyrë të vazhdueshme përballet me sfidat e intolerancës dhe formave të ndryshme të konflikteve.*

Me dëshirën tonë të mirë dhe shpresën, që Zoti do të na japë energjinë dhe qëndrueshmërinë për të vazhduar në rrugën tonë të bashkëjetesës, harmonisë, tolerancës dhe dialogut, ne përfaqësuesit e komuniteteve fetare shqiptare nënshkruajmë sot (03.05.2018) deklaratën e mësipërme.

**Komuniteti Mysliman i Shqipërisë**
**H. SKENDER BRUÇAJ**

**Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë**
**FORTLUMTURI ANASTAS JANULLATOS**

**Kisha Katolike e Shqipërisë - Konferenca Ipeshkvnore**
**MONS. GEORGE FRENDO**

**Kryegjyshata Botërore Bektashiane**
**H. DEDE EDMOND BRAHIMAJ**

**Vllazëria Ungjillore e Shqipërisë**
**PASTOR YLLI DOÇI**

**3 Maj 2018**

*tion values of coexistence and to prevent any form of manipulation and instrumentalization of religion in the service of non-religious interests.*

• ***To promoting in the international arena,*** *by all means, the value of interfaith coexistence and harmony as a necessary model for the whole world society, which constantly faces the challenges of intolerance and various forms of conflict.*

With our good will and hope that God will give us the energy and perseverance to continue on our path of coexistence, harmony, tolerance and dialogue, we, representatives of Albanian religious communities, sign today (03.05.2018) this statement.

**Muslim Community of Albania**
**H. SKENDER BRUÇAJ**

**Orthodox Autocephalous Church of Albania**
**HIS BEATITUDE, ANASTASIOS YANNULATOUS**

**Catholic Church of Albania - Episcopal Conference**
**MONS. GEORGE FRENDO**

**The Bektashi World Headquarters**
**H. DEDE EDMOND BRAHIMAJ**

**Evangelical Brotherhood of Albania**
**PASTOR YLLI DOÇI**

**May 3, 2018**

## KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË: DËNOJMË ASHPËR ÇDO FORMË TERRORI QË GODET HUMANIZMIN

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dënon me indinjatën më të thellë sulmin e fundit terrorist të ndodhur në qytetin Christchurch të Zelandës së Re, ku humbën jetën 49 besimtarë myslimanë, që po kryenin faljen në xhami dhe ku mbi 50 të tjerë mbeten të lënduar.

Ky akt barbar ndaj njerëzve të pafajshëm, tregon edhe një herë se terrori nuk ka fe, komb, ngjyrë e atdhe, por me mizorinë e tij godet këdo, kudo qoftë, jo vetëm në zona lufte e konflikti, por edhe aty ku mbizotëron paqja dhe mirëqenia, sepse terrori ka vetëm një qëllim, mbjelljen e urrejtjes dhe frikës ndaj tjetrit.

Ne dënojmë edhe një herë me forcë akte të tilla kriminale, që kanë lënduar çdo zemër humane kudo qoftë.

Lusim Zotin gjithashtu që paqja, harmonia, bashkëjetesa e mirëkuptimi të mbizotërojë kudo në botë. Zoti mos i dhëntë mundësi askujt të dalë mbi humanizmin, jetën që e jep veç Zoti dhe vlerat universale, aq të nevojshme në botën e sotme.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, shpreh gjithashtu solidaritet të plotë me të gjithë ata që vuajnë sot në luftëra dhe konflikte në vende të ndryshme të botës, duke iu ofruar atyre lutjet dhe afërsinë shpirtërore.

KNFSH i dërgon ngushëllimet më të sinqerta Zelandës së Re, familjarëve të viktimave dhe komunitetit të tyre, si dhe i uron shërim sa më të shpejtë të plagosurve gjatë këtij sulmi në Zelandën e Re.

Zoti e ndihmoftë dhe e udhëzoftë njerëzimin kah e mira! Amin!

**15 mars 2019**

## INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA: WE STRONGLY CONDEMN ANY FORM OF TERRORISM AGAINST HUMANITY

The Interreligious Council of Albania condemns the latest terrorist attack in the New Zealand town of Christchurch, in which 49 Muslims were killed during the prayer and 50 others were seriously injured.

This barbaric act against innocent people once again shows that terrorism has no religion, nation, colour or homeland, but its cruelty strikes everyone, everywhere, not only in areas of war and conflict but also where peace and welfare prevail, because terror has only one purpose, to plant hatred and fear of the other.

We once again strongly condemn such criminal acts that have hurt every human heart wherever it is.

We pray that peace, harmony, coexistence and understanding prevail everywhere in the world. May God not allow anyone to triumph over humanity, the life that God alone gives or the universal values, which are so necessary in today's world!

The Interreligious Council of Albania also expresses its full solidarity with all those who today suffer in wars and conflicts in different countries, offering prayers and spiritual closeness.

IRCA sends the most sincere condolences to New Zealand and families of victims and their community, and wishes a speedy recovery to everyone injured in this terror act in New Zealand.

May God help and guide mankind to the good! Amen!

**March 15, 2019**

## KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË: DHIMBJE DHE LUTJE PËR SRI LANKËN

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, shpreh dhimbjen e thellë për qindra viktima, që humbën jetën në disa akte terroriste të ndodhura në Sri Lanka në ditën e Pashkëve.

Ne si institucion, në emër të pesë komuniteteve fetare në Shqipëri (Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike e Shqipërisë, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë) edhe një herë dënojmë ashpër çdo formë terrori, dhune dhe ekstremizmi, si dhe bashkojmë lutjet tona me mbarë botën, e sidomos me besimtarët e çdo besimi, që lutet për paqe e bashkëjetesë pa dallim feje, ngjyre dhe race.

Në këto momente dhimbjeje, shprehim ngushëllimet më të sinqerta për familjarët e viktimave dhe lusim Zotin t'i japë shërim të plagosurve dhe të lënduarve.

Këto akte që s'njohin vend, fe apo komb, i bien alarmit, që bota ka domosdoshmërish nevojë emergjente për politika ndërkombëtare, që ofrojnë zgjidhje për plagët globale, që bota vuan sot, siç janë luftërat, terrori, konfliktet, injoranca, varfëria, kriza sociale dhe humanitare, të cilat janë shkas vuajtjesh pa fund e shtrirë deri në disa breza.

Zoti e ndihmoftë dhe e udhëzoftë botën, e sidomos ata që kanë në dorë përgjegjësinë e drejtimit të fateve të kombeve dhe popujve!

Amen! Amin!

**23 pril 2019**

## INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA: SORROW AND PRAYER FOR SRI LANKA

The Interreligious Council of Albania expresses its deep sorrow for hundreds of people who lost their lives in the terrorist acts that took place in Sri Lanka on the Easter day.

We, as an institution, on behalf of the five religious communities in Albania, (the Muslim Community of Albania, the Orthodox Autocephalous Church of Albania, the Catholic Church of Albania, the Bektashi World Order, and the Evangelical Brotherhood of Albania), once again strongly condemn all forms of terror, violence and extremism, and unite our prayers with the whole world, and especially with the believers of every faith, who pray for peace and coexistence, regardless of religion, colour or race.

In these moments of sadness, we express our most sincere condolences to the victims' families and pray God to heal the wounded and injured.

These acts, which have no country, religion or nation, sound the alarm that the world is in urgent need of international policies that offer healing solutions to worldwide wounds such as wars, terrorism, conflicts, ignorance, and poverty, as well as social and humanitarian crises, which have been the cause for endless suffering for generations.

May God help and guide the world, and especially those who are responsible for the fate of peoples and nations.

Amen! Amin!

**April 23, 2019**

# DEKLARATË PËR SHTYP LIDHUR ME SITUATËN POLITIKE

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike e Shqipërisë, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë), po ndjekin me shqetësim situatën politike në vendin tonë, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në aspektin social, ekonomik dhe në të ardhmen e rinisë sonë, duke krijuar një gjendje të pasigurtë dhe duke cenuar shpresën e një populli të vuajtur, por vital e të fortë përballë sprovave me të cilat është përballur historikisht.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë i bën thirrje politikës shqiptare për dialog dhe vetëpërmbajtje, si dhe për zgjidhje të konfliktualitetit të tejzgjatur, i cili po thellon dhe më shumë varfërinë e shqiptareve, ikjen e tyre, dobësimin e institucioneve demokratike në vendin tonë, si dhe po dëmton rëndë imazhin e Shqipërisë përpara botës.

Ne të gjithë së bashku, duhet të këmbëngulim fort te virtyti i shpresës, që po plagoset dita ditës, duke i bërë thirrje të gjithë faktorit politik të lërë mënjanë dhunën verbale apo fizike, përçmimin e kundërshtarit politik, e të gjejnë medoemos zgjidhje në dobi të të gjithë shoqërisë shqiptare, të atyre nënave dhe baballarëve fisnikë, që ushqyen brezat me dashurinë e shenjtë për këtë tokë, e sidomos të rinisë sonë, e cila meriton një vend me një të ardhme shpresëplotë.

Lusim Zotin për më shumë dashuri, mirëkuptim e bashkëpunim.
Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe popullin tonë.
Me respekt,

**Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë**

**Komuniteti Mysliman i Shqipërisë**
**H. SKENDER BRUÇAJ**

**Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë**
**FORTLUMTURI ANASTAS JANULLATOS**

**Kisha Katolike e Shqipërisë - Konferenca Ipeshkvnore**
**MONS. GEORGE FRENDO**

**Kryegjyshata Botërore Bektashiane**
**H. DEDE EDMOND BRAHIMAJ**

**Vllazëria Ungjillore e Shqipërisë**
**PASTOR YLLI DOÇI**

**Tiranë, 27 shkurt 2019**

# PRESS STATEMENT ON THE CURRENT POLITICAL SITUATION

The Interreligious Council of Albania (the Muslim Community of Albania, the Orthodox Autocephalous Church of Albania, the Catholic Church of Albania, the Bektashi World Order, and the Evangelical Brotherhood of Albania) are following with concern the current political situation in the country, which directly affects social and economic aspects and the future of our youth, creating an insecure situation and undermining the hopes of a suffering but strong and vital people in face of the trials it has historically encountered.

The Interreligious Council of Albania call upon Albanian politics to dialogue and self-restrain and to resolve the protracted conflict, which is further deepening Albanians' poverty, their flight from the country and the weakening of the country's democratic institutions, and is seriously damaging the image of Albania in the world.

All of us together must firmly insist on the virtue of hope, which is being wounded day by day, calling upon all political factors to leave aside verbal and physical violence and contempt for the political opponent and to find solutions to the benefit of the entire Albanian society, to the benefit of noble mothers and fathers who have nurtured generations with the sacred love for this land, and in particular, to the benefit of our youth, who deserve a country with e hopeful future.

We pray to God for more love, understanding and cooperation.
May God bless Albania and our people!
Sincerely,

**Interreligious Council of Albania**

**Muslim Community of Albania**
**H. SKENDER BRUÇAJ**

**Orthodox Autocephalous Church of Albania**
**HIS BEATITUDE, ANASTASIOS YANNULATOUS**

**Catholic Church of Albania - Episcopal Conference**
**MONS. GEORGE FRENDO**

**The Bektashi World Headquarters**
**H. DEDE EDMOND BRAHIMAJ**

**Evangelical Brotherhood of Albania**
**PASTOR YLLI DOÇI**

**Tirana, February 27, 2019**

Intervista

Interviews

# INTERVISTË NË GAZETËN MAPO

*Prej disa kohësh, sa herë Shqipëria është në ditë të vështira, opinioni publik ushqehet me një deklaratë dhe qëndrim të ndryshëm nga aktorët e tjerë. Është një kumt i veçantë, që kërkon vetëpërmbajtje, dialog, urtësi, maturi. Ky mesazh paqeje, është nga ana tjetër i fortë dhe i njëmendët. Thirrjet vijnë kur ka ngjarje të rënda kriminale, kur ka krizë të fortë politike, apo së fundmi, kur nga Holanda erdhi lajmi se Parlamenti atje ka kërkuar rivendosjen e vizave me Shqipërinë. Janë 5 komunitetet fetare në vend, që janë mbledhur në një Këshill. Gjuha e tyre kontraston shumë me arsenalin luftarak të politikës dhe medias. Po ndoshta, pikërisht për këtë, ia vlen të dëgjohet. Po si lindi ky Këshill, ku janë mbledhur myslimanët, katolikët, ortodoksët, bektashinjtë dhe së fundmi edhe protestantët? Si funksionon, dhe misioni që liderët shpirtërorë i kanë vënë vetes. Kërkesa e tyre e vazhdueshme ndaj politikës për dialog dhe ulje në tryezë. A dëgjohet zëri i tyre nga partitë? Në një intervistë për gazetën MAPO me dt. 19 prill 2019, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar, Dr. Genti Kruja, shpjegon gjithçka.*

## Si lindi ideja e krijimit të Këshillit Ndërfetar?

Bashkëpunimi ndërfetar te shqiptarët është një traditë disa shekullore. Për këtë kemi dëshmi dhe dokumente të shumta, madje në arkivat tona kemi dhe foto, që nga

# INTERVIEW IN MAPO NEWSPAPER

*For some time now, whenever Albania is in difficult days, public opinion is fed with statements and attitudes quite different from other actors. It is a special message that requires self-control, dialogue, wisdom and prudence. This message of peace is also strong and genuine. The calls come when there are serious criminal acts, when there are severe political crises, or when, as recently, there is the news of the Dutch parliament requesting restoration of visa requirements for Albania. Five religious communities in the country have established a Council. Their language sharply contrasts with the militant vocabulary of politics and the media. Perhaps that is why it is worth listening to. But how was this Council born; a Council which gathers Muslims, Orthodox, Catholics, Bektashis and, more recently, Protestants? How does it operate and what is the mission that religious leaders have set themselves? Their constant demands for a policy of dialogue and sitting around the table. Is their voice heard by parties? The Secretary General of the Interreligious Council of Albania, Dr. Genti Kruja, explains everything in an interview with Mapo newspaper on April 19, 2019.*

## How did the idea of establishing an Interreligious Council come about?

Interfaith cooperation among Albanians is a centuries-old tradition. There are a lot of documents evidence

koha e pavarësisë dhe deri në ditët tona, ku prijësit fetarë gjenden bashkë, jo vetëm në festa e urime, por edhe në momente historike të kombit shqiptar. Kështu që, kjo traditë bashkëpunimi kishte ardhur koha që të zyrtarizohej nëpërmjet një këshilli ndërfetar, i cili u bë realitet në 2007, por ceremonia e themelimit u zhvillua më 22 tetor 2009 në prani të Presidentit të Republikës dhe të ftuarve të shumtë nga bota.

Këshilli Ndërfetar u themelua nga katër krerët e komuniteteve tradicionale fetare në Shqipëri, H. Selim Muça, Fortlumturia e tij Anastas Janullatos, Mons. Rrok Mirdita dhe H. Dede Reshat Bardhi, si dhe është regjistruar në Gjykatën e rrethit Tiranë. Në mbledhjen e Këshillit të Presidencës me dt. 22.10.2018 është miratuar dhe anëtarësia me të drejta të plota edhe e Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, duke u bërë komuniteti i pestë fetar në KNFSH.

### - A doni te jepni një mesazh për shoqërinë dhe politikën, qoftë dhe vetëm me këtë lloj bashkëpunimi, me këtë organizëm?

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë shpesh herë në deklaratat e tij të përbashkëta ka dhënë mesazhe të qarta në dobi të shoqërisë, si dhe mesazhe drejtuar politikës shqiptare, apo faktorit ndërkombëtar, duke u bërë një shembull i bashkëpunimit për të mirën e përbashkët edhe pse ne përbëhemi nga pesë komunitete të ndryshme fetare.

### - Ju keni mbajtur qëndrime të forta publike, lidhur me klimën e ashpër politike, apo dhe me ngjarje te tjera, si ato që lidhen me krimin, apo me integrimin dhe hapjen e negociatave me BE-në. Sa mendoni se dëgjohet zëri juaj, a merrni reagime për shqetësimet që ngrini?

Duke qenë se Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë përfaqëson zërin e pesë komuniteteve fetare në vendin tonë, deklaratat e publikuara dhe firmosur nga pesë liderët fetarë janë deklarata të përbashkëta, të mirëmenduara dhe të konsultuara bashkërisht në çdo mesazh që jipet, prandaj dhe pesha e atyre fjalëve është e madhe dhe zë vend kur thuhet, duke pasur një jehonë të madhe, jo vetëm në media, por edhe në instancat zyrtare shtetërore dhe sidomos në trupin diplomatik, të akredituar në vendin tonë. Do të ndalem vetëm në dy rastet e deklaratave gjatë vitit 2018, *"Deklarata e besimeve fetare në Shqipëri me rastin e rekomandimit për hapjen e negociatave me BE-në"*, drejtuar Presidentit Makron dhe Kancelares Merkel, si dhe *"Deklarata e komuniteteve fetare në Shqipëri"*, lidhur me

and for this; moreover, in our archives, there are photos dating to the time of independence and to the present, which show religious leaders together not only in celebrations and feasts, but also in historical moments for the Albanian nation. Therefore, the time had come for this tradition of cooperation to be formalized through an interfaith council, which became a reality in 2007. However, the opening ceremony took place on October 22, 2009, in the presence of the President of the Republic and many guests from around the world.

The Interreligious Council was established by the four leaders of religious communities in Albania, H. Selim Muça, His Beatitude, Anastasios Yannulatous, Mons. Rrok Mirdita and H. Dede Reshat Bardhi, and it was registered at the Tirana District Court. At the October 22, 2018 meeting of the Council of Presidency, full membership of the Evangelical Brotherhood of Albania was approved, making it the fifth religious community of IRCA.

### - Would you like to give a message to society and politics, even if only with this type of cooperation, this institution?

In its joint statements, the Interreligious Council of Albania has often given clear messages for the benefit of society as well as messages to Albanian politics and the international factor, becoming an example of cooperation for the common good, although it consists of five different religious communities.

### -You have taken strong public stances regarding the harsh political climate or other events such as those related to crimes or the country's integration and opening of EU membership talks. How much do you think your voice is heard; are the concerns you raise ever responded to?

As the Interreligious Council of Albania is the voice of five religious communities in the country, the statements published and signed by the five religious leaders are joint and well thought out, and every message they contain is consulted jointly, therefore, the weight of those words is heavy and they take root once said, not only grabbing the headlines but also the attention of official state authorities, especially of the diplomatic corps accredited to our country. I will only focus on two 2018 statements. The first one is the *"Statement of religious communities in Albania about the opening of EU accession negotiations"*, addressed to President Macron and Chancellor Merkel. The second one

angazhimin e përbashkët për dialogun ndërfetar, zhvilluar në konferencën ndërkombëtare me 3 maj 2018 në Tiranë *"Shqipëria, Model i Bashkëjetesës Ndërfetare për Evropën?"*, me mbështetjen e Ambasadës së Austrisë në vendin tonë, organizuar nga 3 universitete themeluar nga 3 komunitete të ndryshme fetare, Universiteti Bedër, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Universiteti "Logos".

Lidhur me pjesëmarrjen tonë aktive në shumë dimensione, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë me dt. 25 tetor 2018 është vlerësuar me çmimin *"De Mellon për të Drejtat e Njeriut"* në Poloni, ku në ceremoninë e zhvilluar ky çmim iu dha krerëve më të lartë të komuniteteve fetare të vendit tonë, me motivacionin *"Për Vëllazëri Ndërfetare në Shqipëri"*.

Ndërkohë Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë po përgatitet të marrë pjesë në Asamblenë e Dhjetë Botërore të Organizatës Ndërkombëtare ***"Religions for Peace"*** (Fetë për Paqen), që do të mbahet në gusht të këtij viti në Lindau të Gjermanisë, ku do të marrin pjesë personalitete të larta fetare nga 100 shtete të ndryshme të botës, si dhe përfaqësues të organizmave të gruas dhe rinisë, në të cilën do të zhvillohen disa seanca dhe panele shkencore rreth temës kryesore të kësaj asambleje *"Kujdesi për të ardhmen tonë të përbashkët"*, si dhe nëntemave të tjera të përcaktuara për t'u trajtuar në këtë tubim të madh botëror. Gjatë zhvillimit të kësaj asambleje, delegatë nga e gjithë bota do të votojnë gjithashtu dhe për organet drejtuese të **"Religions for Peace"**, të nominuar nga këshillat ndërfetarë kombëtarë, të cilët zgjidhen një herë në pesë vite. KNFSH është anëtare me të drejtë vote në **"Religions for Peace"**, e cila është themeluar në 1970 në New York dhe është organizata më e madhe botërore, që operon në fushën e paqes dhe dialogut në të gjithë botën, akredituar dhe njohur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Lidhur me pjesëmarrjen dhe angazhimin tonë në këtë asamble, në emër të KNFSH-së kam qenë prezent në takimin e Berlinit dhe pas disa ditësh do të jemi në Bruksel. Ne do kemi gjithashtu dhe konsultimet tona kombëtare lidhur me rekomandimet dhe propozimet tona, që do të dërgojmë në Asamblenë Botërore në emër të Shqipërisë.

Këto janë disa nga vlerësimet ndërkombëtare, që i bëhen Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

### -Keni kërkuar që partitë të merren vesh për hir të interesave të vendit. Si janë pritur deklaratat tuaja nga partitë?

Ka pasur reagime pozitive nga politikanë të të gjitha kaheve politike. Vlerësimi i fundit ishte edhe ai i Presidentit të Republikës ndaj Këshillit Ndërfetar, ku gjatë një takimi me kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Bujar Spahiu, kreu i shtetit ka theksuar rëndësinë e funksionimit të Këshillit Ndërfetar në Shqipëri, si një instrument, që forcon bashkëjetesën, harmoninë dhe solidaritetin në vendin tonë.

is the "*Statement of religious communities in Albania*" about the joint commitment to interfaith dialogue. On May 3, 2018, the international conference *"Albania - a Model of Interfaith Coexistence for Europe?"* took place in Tirana, with the support of the Austrian Embassy, organised with the collaboration of three universities established by three different religious communities, University College Beder University, the Catholic University "Our Lady of Good Counsel" and University College Logos.

Regarding our active participation in many dimensions, the Interreligious Council of Albania was awarded the "Sergio Vieira De Mello" prize for human rights in Krakow, Poland, on October 25, 2018. At the ceremony, the award was given to the senior leaders of our country's religious communities for *"Interfaith Brotherhood in Albania"*.

Meanwhile, the Interreligious Council of Albania is preparing to participate in the 10th World Assembly of the International Organisation "Religions for Peace", which will be held this August in Lindau, Germany, with the participation of senior religious personalities from 100 different countries, as well as of representatives of women's and youth organisations. It will host several scientific sessions and panels on the assembly's main theme *"Caring for our common future"*, and other sub-themes pre-defined to be addressed at this major world gathering. During this assembly, delegates from around the world will also vote for **"Religions for Peace"** governing bodies, nominated by national interfaith councils and elected every five years. The Interreligious Council of Albania is a voting member of **"Religions for Peace"**, which was established in New York in 19070, and is the world's largest organisation operating in the area of peace and dialogue worldwide, accredited and recognized by the UN.

As for our participation and commitment in this assembly, I attended the Berlin meeting several days ago on behalf of the IRCA and in a few days we will be joining the meeting in Brussels. We will also organize our national consultations on recommendations and proposals, which will then be sent to the World Assembly on behalf of Albania.

### -You have called on the parties to come to an agreement for the sake of the country's interests. How have your statements been received by the parties?

There have been positive reactions from the politicians of all directions. The latest appreciation came from the President of the Republic, who in a meeting with the head of the Muslim Community of Albania, H. Bujar Spahiu, pointed out the importance of the Interreligious Council of Albania as an instrument that strengthens coexistence, harmony and solidarity in our country.

## -A do ishit ju si organizëm të gatshëm të ndërmjetësonit për t'i ulur palët ne bisedime?

Komunitetet fetare besoj se e kanë treguar veten se janë të gatshëm të japin kontributin e tyre në çdo moment të vështirë dhe delikat, që ka kaluar vendi ynë, ku një nga shembujt e veçantë ka qenë edhe gjatë trazirave të 1997. Në ditët e sotme, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ka bërë dhe një deklaratë të përbashkët lidhur me situatën politike në vendin tonë, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në aspektin social, ekonomik dhe në të ardhmen e rinisë sonë, duke krijuar një gjendje të pasigurtë dhe duke cenuar shpresën e një populli të vuajtur, por vital e të fortë përballë sprovave me të cilat është përballur historikisht.

Në këtë deklaratë, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë i bëri thirrje politikës shqiptare për dialog dhe vetëpërmbajtje, si dhe për zgjidhje të konfliktualitetit të tejzgjatur, i cili po thellon dhe më shume varfërinë e shqiptarëve, ikjen e tyre, dobësimin e institucioneve demokratike në vendin tonë, si dhe po dëmton rëndë imazhin e Shqipërisë përpara botës.

KNFSH deklaroi se, ne të gjithë së bashku, duhet të këmbëngulim fort te virtyti i shpresës, që po plagoset dita ditës, duke i bërë thirrje të gjithë faktorit politik të lërë mënjanë dhunën verbale apo fizike, përçmimin e kundërshtarit politik, e të gjejnë medoemos zgjidhje në dobi të të gjithë shoqërisë shqiptare, të atyre nënave dhe baballarëve fisnikë, që ushqyen brezat me dashurinë e shenjtë për këtë tokë, e sidomos të rinisë sonë, e cila meriton një vend me një të ardhme shpresëplotë.

## -Si koordinohen qëndrimet e komuniteteve fetare? Si organizohet puna që të merret konsensusi i të gjithëve për deklaratat dhe qëndrimet që mbani?

Organi më i lartë vendimmarrës i KNFSH-së është Këshilli i Presidencës, i cili përbëhet nga Kryetarët e pesë komuniteteve fetare, ndërsa Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga dy anëtarë për çdo komunitet.

Kryetari i Këshillit të Presidencës, ka një mandat një vjeçar dhe krerët e komuniteteve fetare e kanë këtë detyrë me rotacion. Për vitin 2019 është kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Kryepeshkopi Anastas, ndërsa në detyrën e sekretarit të përgjithshëm jam zgjedhur para 6 muajsh, ku në këtë pozicion koordinoj dhe punët e bashkëpunimin e Këshillit, duke përgatitur dhe draftet, si dhe agjendën e mbledhjeve, takimeve dhe deklaratave të përbashkëta, ku i dërgohet Këshillit të Presidencës, d.m.th. krerëve të pesë komuniteteve dhe pasi bëhen sugjerimet përfundimtare, ajo publikohet në faqen tonë zyrtare www.knfsh.al dhe i dërgohet dhe mediave.

## -Would you as an organisation be ready to mediate talks between parties?

I believe that religious communities have shown they are ready to make their contribution at every difficult and delicate moment that our country has been through. One of the special moments was during the 1997 riots. Recently, the Interreligious Council of Albania has made a statement on the country's political situation, which directly affects both social and economic aspects and the future of our youth, creating an insecure situation and undermining the hopes of a suffering but strong and vital people in face of the trials it has historically encountered.

In this statement, the Interreligious Council of Albania call upon Albanian politics to dialogue and self-restrain as well as to resolve the protracted conflict, which is further deepening Albanians' poverty, their flight from the country and the weakening of the country's democratic institutions, and is seriously damaging the image of Albania in the world.

IRCA has stated that all of us together must firmly insist on the virtue of hope, which is being wounded day by day, calling upon all political factors to leave aside verbal and physical violence and contempt for the political opponent, and to find solutions to the benefit of the entire Albanian society, to the benefit of the noble mothers and fathers who have nurtured generations with the sacred love for this land, and in particular, to the benefit of our youth, who deserve a country with a hopeful future.

## -How are the religious communities' attitudes coordinated? How is work organised in order to get everyone's consensus about the joint statements and stances you take?

The highest decision-making body of IRCA is the Council of Presidency, which is made up of the leaders of five religious communities, while the Executive Board is composed of two members from each community.

The Chairman of the Council of Presidency has a one-year term, which rotates among the leaders of religious communities. For year 2019, chairmanship is held by the Head of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, Archbishop Anastasios, while I was elected Secretary General six months ago. In this position, I coordinate the Council's work and cooperation, preparing drafts and the agenda of joint meetings and statements, which are sent to the Council of Presidency, that is the leaders of five religious communities, and after the final proposals are made, it is published on our official website www.knfsh.al and sent to the media.

## -A ka ndonjëherë qëndrime të ndryshme, për tema të ndryshme, në mbledhjet që ju bëni?

Normalisht që ka tema, ku përfaqësuesit e komuniteteve fetare mund të kenë dhe mendime të ndryshme, lidhur me tema të caktuara. Edhe pse sipas statutit vendimet merren me shumicë votash, të gjitha vendimet e deritanishme janë marrë në unanimitet të plotë.

Në mbledhjen e fundit, zhvilluar më 16 prill 2019, ku u mblodh Këshilli i Presidencës, janë diskutuar p.sh. disa problematika shqetësuese për të gjithë komunitetet fetare, siç janë çështja e pronave dhe moskthimi i tyre nga shteti shqiptar, problemi i objekteve të kultit dhe materialeve arkivore të sekuestruara nga regjimi komunist dhe moskalimi i tyre te pronarët e vërtetë, komunitetet fetare në Shqipëri, si dhe është miratuar gjithashtu themelimi i Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, propozuar në mbledhjen e fundit nga Këshilli Ekzekutiv i KNFSH-së.

## - Krahas konferencave ndërkombëtare dhe aktiviteteve të ndryshme ndërfetare, a ka ndonjë zhvillim praktik, përsa i përket përçimit të kësaj fryme te brezat e rinj?

Krahas konferencave dhe aktiviteteve ndër vite, mund të përmendet bashkëpunimi akademik dhe pedagogjik midis tre teologjive, Departamentit të Shkencave Islame në Universitetin "Bedër", Institutit Teologjik Katolik në Seminarin Ndërdioqezian, Shkodër dhe Akademisë Teologjike Ortodokse, Shën Vlash, Durrës, të cilët kanë hedhur hapa konkrete prej disa vitesh në fushën e dialogut, për t'ia përcjellë këtë frymë edhe brezave të rinj, sidomos teologëve të ardhshëm, një investim me mjaft vlera.

Kështu tashmë pas zhvillimit të seminareve dhe leksioneve të hapura të dialogut ndërfetar dhe shpjegimit teologjik të besimit të secilit me studentët e tre teologjive nga pedagogët e teologjive të ndërsjella, deri tani janë zhvilluar shtatë simpoziume ndërfetare, të organizuara me radhë në tre institucionet arsimore, duke e kthyer këtë organizim në një traditë, që vazhdon me një periodik të caktuar, prej dy herësh në vit, çdo 6 muaj, duke zgjedhur tema të përbashkëta trajtimi.

Simpoziumi i tetë do të zhvillohet me 2 maj, ku ndryshe nga herët tjera këtë radhë nuk do të jenë pedagogët, por vetë studentët ata që do të mbajnë kumtesat në simpoziumin me temë "Sfidat e religjionit në globalizëm".[1]

1. https://gazetamapo.al/zeri-i-lidereve-shpirterore-per-dialog-sa-po-degjohet-nga-politika/

## -Are there ever different attitudes about different issues in your meetings?

Certainly there are issues on which representatives of religious communities have different opinions. Although by statute, decisions are taken by a majority vote, decisions so far have been taken in complete unanimity.

In the last meeting, on April 16, 2019, members of the Council of Presidency discussed some disturbing issues for all religious communities such as the issue of properties and their restitution from the Albanian state, the issue of places of worship and archival material seized by the communist regime and their restitution to the real owners, and religious communities in Albania. The establishment of the Department of Women and the Department of Youth at the Interreligious Council of Albania, which had been proposed in an earlier meeting of the Executive Board of IRCA, was also adopted in this meeting.

## - In addition to international conferences and various interfaith activities, are there any practical applications in terms of conveying this spirit to younger generations?

In addition to conferences and other activities over the years, I can mention the academic and pedagogical cooperation between the three theologies, the Department of Islamic Sciences at University College Beder, the Catholic Theological Institute at the Interdiocesan Seminary in Shkoder, and the Orthodox Theological Academy Saint Vlash, in Durres, which have taken concrete steps in the field of dialogue to pass on this spirit to young generations, especially to future theologians, which is an investment of great value.

Thus, after seminars and open lectures on interfaith dialogue and theological explanations of each faith to students of the three departments by the professors of each theology, seven interfaith symposia have been organised in these three educational institutions, turning this organisation into a tradition taking place on a periodic basis every 6 months and addressing common issues.

The eighth symposium will take place on May 2, and unlike other times, it is the students who will deliver speeches on the theme "Challenges of religion in globalism".

### Koha për reflektim!

## INTERVISTË E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË DR. GENTI KRUJA NË GAZETËN "SI"

Në këtë situatë pandemie dhe pasigurie "kemi nevojë ta ndalim pak turravrapin drejt punëve që s'na mbarojnë kurrë, të qetësohemi dhe t'i bëjmë punët më mirë, të mendojmë më shumë dhe për tjetrin, të mos jemi kaq të pangopur dhe egoistë, ta duam më shumë natyrën dhe burimet e saj që vijnë prej ZOTIT dhe i kemi keqpërdorur, të jemi më pak shpërdorues dhe më afër nevojtarëve".

Mesazhet vijnë nga njerëzit e klerit në Shqipëri, të cilët u bëjnë thirrje edhe politikanëve, që "të kthejnë vëmendjen nga populli, t'i gjenden pranë në këto ditë të vështira nevojtarëve dhe t'i mbështesin më shumë shtresat nevojë, duke pasur parasysh se një pjesë e tyre dhe e deputetëve janë dhe biznesmenë dhe e kanë këtë mundësi."

Në një intervistë për Gazetën "SI", Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, Dr. Genti Kruja shprehet që në këto ditë sprove që po kalon bota, gjithsecili prej nesh, besimtari dhe ateisti, qytetari i thjeshtë dhe politika të bëjnë një reflektim të thellë.

***

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është institucion, i cili është themeluar nga komunitetet tradicionale fetare në Shqipëri më 2007, si një model i bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare në vendin tonë, model i cili po ndiqet edhe nga shtetet perëndimore. Vitin e kaluar KNFSH është ftuar në shumë konferenca dhe tribuna ndërkombëtare në Evropë dhe SHBA për të shpalosur këtë model, si dhe është vlerësuar me një çmim ndërkombëtar për promovimin e harmonisë ndërfetare në tetor 2018.

Aktualisht KNFSH bashkërendohet nga pesë komunitete fetare dhe kryetari i tij është me rotacion për një vit kreu i çdo komuniteti fetar në Shqipëri.

### Time to reflect!

## INTERVIEW OF THE SECRETARY GENERAL OF THE INTERRELIGIOUS COUNCIL OF ALBANIA, DR. GENTI KRUJA, FOR THE NEWSPAPER "SI"

In this situation of pandemic and insecurity, "we need to stop running after things that never end, to calm down and do things better, to think more about the other, not to be so greedy and selfish, and to love nature and its resources, which God has bestowed upon us and which we have misused, to be less wasteful and closer to the needy".

These messages come from the clergy people in Albania, who call on politicians "to turn their attention to the people, to be close to and support the needy in these difficult days, given that some of them and some MPs own businesses and can thus afford to do it".

In an interview for the newspaper "SI", the Secretary General of the Interreligious Council of Albania, Dr. Genti Kruja said that in these days of trials the whole world is going through, each of us, the believer and the atheist, the ordinary citizen and the politician, must reflect deeply.

***

The Albanian Interreligious Council of Albania (IRCA) was established in 2007 by the traditional religious communities in Albania, as a model of interfaith coexistence and harmony in our country, a model that is being followed even by Western countries. Last year, IRCA was invited to several international conferences and meetings in Europe and the USA to unfold this model. In October 2018, it was also awarded an international prize for the promotion of interfaith harmony.

Currently the IRCA is coordinated by five religious communities and is chaired by the leader of each religious community on a one-year rotating basis.

## Gazeta SI: Zoti Kruja, prej javësh vendi është vetizoluar për të parandaluar përhapjen e Covid 19. A keni një mesazh për qytetarët në veçanti si Këshill Ndërfetar?

Të gjitha komunitetet fetare dhe KNFSH i këshillojnë besimtarët e vet, që të zbatojnë rregullat e vendosura nga OBSH dhe qeveria shqiptare, të cilat janë në dobi të ruajtjes nga përhapja e virusit Covid 19.

Në këto ditë sprove gjithashtu, që po kalon mbarë bota, mesazhi ynë në këto kohë të pazakonta, që ndodhemi midis dy pashkëve dhe në vigjilje të muajit të Ramazanit, është që gjithsecili prej nesh, besimtari dhe ateisti, qytetari i thjeshtë dhe politika të bëjnë një reflektim, se çfarë mund të bëjmë më mirë me veten tonë, familjen tonë, vendin tonë.

Gjithsecili ka nevojë për përmirësim dhe ky përmirësim do të sjellë patjetër ndryshim në shoqëri, sepse ne kemi nevojë ta ndalim pak turravrapin drejt punëve që s'na mbarojnë kurrë, të qetësohemi dhe t'i bëjmë punët më mirë, të mendojmë më shumë dhe për tjetrin, të mos jemi kaq të pangopur dhe egoistë, ta duam më shumë natyrën dhe burimet e saj që vijnë prej ZOTIT dhe i kemi keqpërdorur, të jemi më pak shpërdorues dhe më afër nevojtarëve.

Zoti e ka krijuar çdo gjë në shërbim të krijesës së tij më të përsosur, NJERIUT. Zoti është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai patjetër do e largojë këtë sprovë dhe ditë më të mira do të vijnë, sepse ne besojmë, që pas vështirësisë vjen lehtësimi. Le të lutemi më shumë drejt Zotit.

## Gazeta SI: Por ndërkohë çfarë duhet të bëjë shteti?

Shteti dhe politika duhet të investojnë më shumë në shëndetësi, sepse shëndeti është pasuria më e madhe që Zoti i ka dhënë njeriut.

Ndërkohë duhet të ketë një rritje investimesh në shërbimin social dhe shëndetësor në nivelin lokal, rritje të njësive të tyre në lagje dhe fshat, sepse ky shërbim lë për të dëshiruar. Kemi lagje të reja, që nuk kanë as ambulancë, as shkollë dhe shërbime të tjera bazë. Shërbime të tilla dhe mirëqenia e popullit janë në dorën e shtetit.

## Gazeta SI: Pesë komunitetet fetare a po i ndihmojnë shtresat në nevojë? A janë aktivë në këtë aspekt?

KNFSH aktualisht në bashkëpunim dhe me institucione zyrtare shtetërore dhe

## Newspaper SI: Mr Kruja, the country has self-isolated to prevent the spread of Covid 19. Do you have a message for the citizens, especially on behalf of the Interreligious Council?

All the religious communities and IRCA advice their believers to follow the rules set by WHO and the Albanian government, which are useful in preventing the spread of Covid 19.

Our message in these difficult and unusual days for the whole world, while at a time between two Easters and on the eve of the month of Ramadan, is that each of us, the believer and the atheist, the ordinary citizen and the politician, reflect on what we can do better for ourselves, our family and our country.

Everyone needs improvement and this improvement will definitely bring change to society because we need to stop running after things that never end, to calm down and do things better, to think more about the other, not to be greedy or selfish, to love nature and its resources, which God has bestowed upon us and which we have misused, to be less prodigal and closer to the needy.

God has created everything in the service of His most perfect creature, MAN. God is the Creator of everything and He will surely take away this trial and better days will come, because we believe that after every difficulty there is relief. Let us pray more to God.

## Newspaper SI: In the meantime, what should the government do?

The government and politics should invest more in the health sector because health is the greatest asset that God has given man.

Meanwhile, there should be more investments in social and health care services at the local level and an increase in the number of their units in neighbourhoods and villages, as this service leaves much to be desired. There are new neighbourhoods which have neither policlinics, nor schools or other basic services. Such services and the people's well-being is in the hands of the government.

## Newspaper SI: Are the five religious communities helping the needy? Are they active in this respect?

In cooperation with official institutions and international organisations, IRCA has undertaken several initiatives, which consist of humanitarian aid for the needy families,

organizata ndërkombëtare ka ndërmarrë disa nisma, të cilat konsistojnë në ndihma humanitare për familjet në nevojë, sidomos ata me të moshuar dhe jetimë, familje në nevojë të zonës së tërmetit, si dhe mjete spitalore për frontin e parë të luftës kundër virusit, gjë për të cilën jemi në kontakt dhe me Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërkohë të gjitha komunitetet fetare janë aktivë në shpërndarjen e mijëra pakove ndihma humanitare.

### Gazeta SI: Ndërkohë Shkodra po kthehet në një vatër të zgjeruar të infeksionit dhe duket sikur njerëzit aty nuk kanë bashkëpunim me institucionet. A keni folur me përfaqësues të komunitetit fetar në atë qytet se çfarë po ndodh?

Komunitetet fetare ishin të parat që morën masat institucionale në mënyrë të pavarur, menjëherë pas shfaqjes së rasteve të para të të infektuarve me Covid 19, duke mbyllur pa afat objektet e kultit, kishat dhe xhamitë për shërbesa, lutje dhe falje në grupe, duke e vlerësuar karantinën, si mjetin më efikas për parandalimin e përhapjes së këtij virusi.

Në Shkodër ka ndodhur diçka që i takon ekspertëve të flasin më specifikisht se pse ndodhi kjo, por mendoj se edhe boshllëku institucional, i krijuar pas zgjedhjeve lokale në bashki dhe moskoordinimi midis institucioneve për arsye politike, bëri që ndoshta edhe masat zyrtare të mos kishin efektin e duhur. Tashmë jam i bindur se pas këtyre pasojave dhe masave shtesë të marra nga organet kompetente, do ta ulin rrezikun e përhapjes më tej të kësaj situate, duke u ndihmuar edhe nga qytetarët.

### Gazeta SI: A keni një mesazh për politikanët?

Politikanët të kthejnë vëmendjen nga populli, t'i gjenden pranë në këto ditë të vështira nevojtarëve dhe t'i mbështesin më shumë shtresat në nevojë, duke pasur parasysh se një pjesë e tyre dhe e deputetëve janë dhe biznesmenë dhe e kanë këtë mundësi.

### Gazeta SI: Po për te pasurit?

Është koha për solidaritet social dhe humanitar. Askujt nuk i pakësohet pasuria se ndihmon nevojtarët. Atyre që bëjnë diçka të tillë, Zoti do t'i japë begati e mirësi. Le të mos kursehen në nisma të tilla, sepse sot është koha e ndihmës dhe gjendjes pranë nevojtarëve e sidomos të moshuarve.

especially the elderly and orphans, and the needy families in the hardest-hit areas by the earthquake, as well hospital equipment for the front line workers in the fight against the virus, for which we are in touch with the Ministry of Health. Meanwhile, religious communities are actively distributing humanitarian aid packages.

### Newspaper SI: Meanwhile, Shkoder has become a new hotspot for coronavirus cases and it appears that people there do not cooperate with the authorities. Have you talked to representatives of religious communities in the city about what is happening there?

Religious communities were the first to independently take institutional measures shortly after the first Covid 19 cases were detected, indefinitely closing cult buildings, churches and mosques, to services and prayers in groups, considering quarantine the most effective means of preventing the spread of this virus.

As for what has happened in Shkoder, it is up to the experts to say something more specifically about the reasons; however, I think that the institutional gap created after local elections and non-coordination between institutions for political reasons, may have led to the ineffectiveness of the official measures. I am now convinced that additional measures taken by the authorities and the citizens' contribution will reduce the further spread of the virus, with the help of the citizens.

### Newspaper SI: Do you have a message for politicians?

Politicians should turn their attention to the people and stay close to the needy in these difficult days, given that several politicians and MPs own businesses and can actually do it.

### Newspaper SI: What about a message for the rich?

It is time for social and humanitarian solidarity. Giving in charity to the needy does not diminish one's wealth. God will give prosperity and goodness to those who do it. They should not hold back in such initiatives because it is time to help and stay close to the needy, and especially the elderly.

## Gazeta SI: Shumë qytetarë janë në kufijtë e mbijetesës, si mund të ndihmohen ata që tani janë të mbyllur në shtëpi?

Komunitetet fetare prej 30 vitesh të ringritur nga hiri i persekutimit dhe shkatërrimit komunist kanë një kontribut të jashtëzakonshëm në shoqërinë shqiptare dhe përtej saj, sidomos në arsim, ku kanë edukuar qindra mijëra të rinj, si qytetarë të dobishëm të vendit të tyre, por edhe të botës.

Janë pikërisht këto të rinj dhe të reja, pjesë e komuniteteve fetare, që kanë marrë nisma për të ndihmuar sadopak, sidomos familjet, që kanë vetëm të moshuar. Komunitetet fetare kanë databaset më të rregullta në çdo cep të Shqipërisë, ku shërbejnë, jo vetëm me objektet e kultit, por edhe me institucionet arsimore dhe humanitare.

Në këto kohë shumë kisha, xhami dhe teqe janë bërë vendstrehim, jo vetëm për disa familje, që humbën shtëpitë në kohën e tërmetit të nëntorit 2019, por edhe pika shpërndarje të ndihmave humanitare.

Lusim Zotin, që kjo situatë të kalojë sa më shpejt e me sa më pak dëme![2]

## Newspaper SI: Many citizens have been pushed to the brink of survival. How can those locked at home be helped?

Having revived from the ashes of communist persecution and destruction for 30 years, religious communities have made extraordinary contribution to the Albanian society and beyond, especially to education, by educating hundreds of thousands of young people as useful citizens for both their country and the world.

It is these young men and women from religious communities who have taken the initiative to help, especially families with elderly members. Religious communities have structured database all over Albania, where they serve not only with cult buildings but also with educational and humanitarian institutions.

Recently many churches, mosques and tekkes have turned not only into shelters for several families that lost their homes in the November 2019 earthquake but also into aid distribution points.

We pray to God that this situation will pass as soon as possible and with the least possible damage!

2. https://gazetasi.al/kleri-ne-shkoder-ka-mosmarreveshje-politike-njerez-reflektoni/

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë
Aktivitetet e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë = Activities of Interreligious Council of Albania / ed. Genti Kruja. – Tiranë : KNFSh, 2020
122 f. : me foto ; 29.7 x 21 cm.
ISBN 978-9928-4638-1-4

1.Toleranca fetare 2.Marrëdhënie ndërfetare
3.Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë 4.Historia 5.Shqipëri

2 -67(496.5)
061.2(496.5) :2 -67

30 vite
1990
2020
LIRI BESIMI
KNFSH

ISBN 9789928463814

9 789928 463814